Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Studimi i visibilitetit dhe dizajnimi i sistemit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar

Dhjetor 2021

Adresa
10000 Prishtinë
Rruga. Hajdar Dushi, 1B-1
Republika e Kosovës

Hartues:

AXA sh.p.k.

1. Leutrim Gashi
2. Koman Gashi

Data GISconsulting sh.p.k.

1. Dr. Sc. Hazer Dana
2. Dr. Sc. Tomor Çela
3. Luljeta Krasniqi – Çela, Msc. kandidat

Plotësuar, rishikuar dhe përmirësuar:

Dr. Ruzhdi Halili

Ky studim është hartuar në bashkëpunim me Departmentin për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale (DPASER), Ministria e Zhvillimit Rajonal e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

TABELA E SHKURTESAVE:

AKK	AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS
AKK	ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS
ARAC	AUTORITETI RREGULLATIV PËR AVIACION CIVIL
ASK	AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AZHR	AGJENCIONET ZHVILLIMORE RAJONALE
BB	BANKA BOTËRORE
BE	BASHKIMI EVROPIAN
BKK	BUXHETI I KONSOLIDUAR I KOSOVËS
BPV (GDP)	BRUTO PRODUKTI I VENDIT (GROSS DOMESTIC PRODUCT)
CAPI	COMPUTER-ASSISTED PERSONAL INTERVIEËS (INTERVISTË PËRSONALE E NDIHMUAR NGA KOMPJUTERI)
CATI	COMPUTER-ASSISTED TELEPHONE INTERVIEËING (INTERVISTË ETELEFONIKE E NDIHMUAR NGA KOMPJUTERI)
DPASER	DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ANALIZA SOCIO-EKONOMIKE RAJONALE
DZHR	DEPARTAMENTI PËR ZHVILLIM RAJONAL
FMN (IMF)	FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR
GIS	GEOGRAPHICAL INFORMATION SYSTEM (SISTEMI I INFORMACIONEVE GJEOGRAFIKE)
GND	TË ARDHURAT NACIONALE NË DISPOZICION
KPMM	KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE
MFT	MINISTRIA PËR FINANCA DHE TRANSFERE
MAPL	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TE PUSHTETIT LOKAL
MMPH	MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MKRS	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT
ML	MINISTRITË E LINJËS
MTPT	MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE POST -TELEKUMUNIKACIONIT
MZHR	MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL
MZHSERB	MONITORIMI I ZHVILLIMIT SOCIO-EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR
NVM	NDËRMARRJE TË VOGLA DHE TË MESME
OBSH	ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETËSISË
OJQ	ORGANIZATA JOQEVERITARE
OSBE	ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË
RZH	RAJON ZHVILLIMOR
RZHQ	RAJONI ZHVILLIMOR QENDER
RZHJ	RAJONI ZHVILLIMOR JUG
RZHL	RAJONI ZHVILLIMOR LINDJE
RZHP	RAJONI ZHVILLIMOR PERENDIM
RZHV	RAJONI ZHVILLIMOR VERI
SMZHSERB	SISTEMI PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT SOCIO-EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR
ZHRB	ZHVILLIMI RAJONAL I BALANCUAR
ZHEL	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL

Përmbajtja

1. Hyrje 10

1.1. Qëllimi 12

1.2. Metodologjia e punës 14

2. Baza ligjore, strategjitë dhe dokumentet tjera 16

3. Rajonet në Kosovë, përkufizimi dhe karakteristikat e tyre 18

3.1 Rajoni Zhvillimor Qendër 22

3.1.1 Popullsia 22
3.1.2. Relievi dhe ndërtimi gjeologjik 23
3.1.3. Klima 24
3.1.4. Ujërat 24
3.1.5. Tokat dhe Vegjetacioni 24
3.1.6. Arsimi 24
3.1.7. Infrastruktura 25
3.1.8. Ekonomia dhe zhvillimi i biznesit 27
3.1.9. Bujqësia 29
3.1.10. Papunësia dhe punësimi 31
3.1.11. Burimet natyrore 32
3.1.12. Turizmi 32
3.1.13. Qyteti i Prishtinës Qendër Reprezentative dhe Rajonale e Kosovës 32

3. 2. Rajoni Zhvillimor Lindje 34

3.2.1. Popullsia 34
3.2.2. Relievi dhe ndërtimi gjeologjik 35
3.2.3. Klima 36
3.2.4. Ujërat 36
3.2.5. Tokat dhe Vegjetacioni 36
3.2.6. Arsimi 37
3.2.7. Infrastruktura 38
3.2.8. Ekonomia dhe zhvillimi i biznesit 39
3.2.9. Bujqësia 40
3.2.10. Papunësia dhe punësimi 41
3.2.11. Burimet natyrore 42
3.2.12. Turizmi 42
3.2.13. Qyteti i Ferizajit qendër ekonomike e Rajonin Zhvillimor Lindje 43

3. 3 Rajoni Zhvillimor Veri 45

3.3.1. Popullsia 45
3.3.2. Arsimi 46
3.3.3. Infrastruktura 47
3.3.4. Ekonomia dhe bizneset 48
3.3.5. Bujqësia 49
3.3.6. Papunësia dhe punësimi 51
3.3.7. Burimet natyrore 51
3.3.8. Turizmi 52
3.3.9. Qyteti i Mitrovicës Jugore qender e Rajonit Zhvillimor Veri 52

3.4. Rajoni Zhvillimor Perëndim 54

3.4.1. Popullsia 54
3.4.2. Relievi dhe ndërtimi gjeologjik 54
3.4.3. Klima 55
3.4.4. Ujërat 55
3.4.5. Arsimi 56
3.4.6. Infrastruktura 57
3.4.7. Papunësia dhe punësimi 57

3.4.8. Ekonomia dhe zhvillimi i bizneseve 58
3.4.9. Bujqesia 59
3.4.10. Burimet natyrore 61
3.4.11. Turizmi 61
3.4.12. Qyteti i Pejës qender e Rajonit Zhvillior Perëndim 62
3.5.1. Popullsia 63
3.5.2. Relievi dhe ndërtimi gjeologjik 64
3.5.3. Klima 64
3.5.4. Ujerat 64
3.5.5. Tokat dhe Vegjetacioni 64
3.5.6. Arsimi 65
3.5.7. Infrastruktura 66
3.5.8. Ekonomia dhe bizneset 66
3.5.9. Bujqësia 67
3.5.10. Papunësia dhe Punësimi 69
3.5.11. Burimet natyrore 69
3.5.12. Turizmi 70
5.3.13. Qyteti I Prizrenit qender e Rajonit Zhvillimor Jug 70

4. Treguesit e matjes së shkallës së zhvillimit socio-ekonomik rajonal në Kosovë 72

5. SHTOJCA 1 85

SHEMBULL i ANALIZËS SË TREGUESVE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE 85

5.1. DEMOGRAFIA 85

5.2. ARSIMI 97

6. SHTOJCA 2: 106

TERMAT E REFERENCËS PËR DISAJNIMIN E SISTEMIT TË PËRFORMANCËS RAJONALE 106

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Komunat dhe vendbanimet e Rajonit Zhvillimor Qendër. Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021. Vlerësimit për vitin 2020 23
Tabela 2: Statistikat e Arsimit Parauniversitar. Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosove 2020/2021 .. 25
Tabela 3: Niveli i shkollimit në rajonin Qender. Burimi: Agjencioni i Statistikave ë Kosovës, statistikat nga regjistrimi i popullsisë 2011 25
Tabela 4: Rrjeti i rrugëve nacionale e Rajonale 26
Tabela 5: Vlerësimi i përformacës komunale. Të dhënat nga tabela e vlerësimit për vitin 2019. 26
Tabela 6: Numri i bizneseve sipas komunave 27
Tabela 7: Zonat industriale në Rajonin Zhvillimor Qendër 28
Tabela 8: Madhësia e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore ne Rajonin qender (Regjistrimi i Bujqësisë 2014) 29
Tabela 9: Ekonomitë Bujqësore sipas madhësisë së sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore, sipas komunave, Kosovë, (Regjistrimi i Bujqësisë 2014) 29
Tabela 10: Shfrytëzimi i tokave 30
Tabela 11: Fondi i blektorisë sipas komunave, Kosovë, 2014 30
Tabela 12: Popullsia dhe sipërfaqja në Rajonin Zhvillimor Lindje. Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021. Vlerësimi për popullsinë për vitin 2020. 35
Tabela 13: Statistikat e arsimit parauniversitar në Rajonin Zhvillimor Lindje. Burimi: Statistikat e arsimit në Kosove 2020/2021 37
Tabela 14: Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Lindje. Regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës 38
Tabela 15: Rrjeti i rrugëve nacionale e Rajonale në Rajonin Zhvillimor Lindje 38
Tabela 16: Statistikat e infrastrukturës për Rajonin Zhvillimor Lindje sipas Komunave. Burimi: Sistemi i Menaxhimit të përFomrancës së Komunave. Tabela për vitin 2019. 39
Tabela 17: Madhësia e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore ne RZhL (burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, regjistrimi i bujqësisë 2014) 40
Tabela 18: Numri i blegtorisë në Rajonin Zhvillimor Lindje sipas komunave (Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, regjistrimi i bujqësisë 2014) 40
Tabela 19: Popullsia dhe siperfaqja e Rajonit Zhvillimor Veri sipas Komunave 46
Tabela 20: Statistikat e Arsimit parauniversitar në Rajonin Zhvillimor Veri. Burimi: Statistikat e arsimit në Kosove 2020/2021. 46
Tabela 21: Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Veri. Regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës 47
Tabela 22: Infrastruktura lokale në rajonin veri. Burimi: Nga sistemi i menaxhimit te performances se komunave per vitin 2019. 47
Tabela 23: Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre, Rajoni Zhvillimor Veri. Bizneset sipas komunave ARBK 49
Tabela 24: Sipërfaqja e tokës për shfrytëzim dhe sipërfaqja e tokës së shfrytëzuar nga Ekonomitë Bujqësore, Rajoni Zhvillimor Veri. Regjistrimi i Bujqësisë 2014 50
Tabela 25: Fondi blegtoral sipas komunave në Rajonin Zhvillimor Veri 50
Tabela 26: Papunësia dhe vendet e lira të punës në rajonin zhvillimor veri. Burimi APRK: Raporti i punësimit për vitin 2020 51
Tabela 27. Dendësia e popullsisë dhe sipërfaqja në Rajonin Zhvillior Perëndim. Burimi: ASK Vjetari Statistikor 2021. Vlerësimet e popullsisë për 2020 54
Tabela 28: Statistikat e arsimit parauniversitar. Burimi: Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/2021 ... 56
Tabela 29: Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Përëndim. Regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës 56

Tabela 30: Infrastruktura lokale në Rajonin Zhvillimor Perendim Burimi: Nga sistemi i menaxhimit te performances së komunave për vitin 2019. 57
Tabela 31: Papunësia dhe vendet e lira të punës në rajonin zhvillimor perëndim. Burimi: Raporti i APRK 2020 58
Tabela 32: Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre në Rajonin Zhvillimor Perëndim 59
Tabela 33: statistikat e tokave bujqësore në Rajonin Zhvillimor Perëndim 60
Tabela 34: Fondi blegtoral sipas komunave në Rajonin Zhvillimor Perëndim 61
Tabela 35: Popullsia dhe siperfaqja në rajonin Zhvillimor Jug. Statistikat e Popullsisë nga Vjetari statistikor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2021, vlerësimet e popullësisë 2020. 63
Tabela 36: Statistikat e arsimit parauniversitar. Burimi: Statistikat e arsimit në Kosove 2020/2021 65
Tabela 37: Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Jug. Regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës 65
Tabela 38: Infrastruktura në Rajonin Jug sipas komunave. Burimi: Sistemi i Menaxhimit të Përformacës së Komunave. Vlerësimi për vitin 2019 66
Tabela 39: Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre, Rajoni zhvillimor Jug. 67
Tabela 40: Numri i ekonomive familjare dhe sipërfaqet bujqësore në Rajonin Zhvillimor Jug 68
Tabela 41: Fondi blegtoral sipas komunave në Rajonin zhvillimor Jug 69
Tabela 42: Papunësia dhe vendet e lira te punës në Rajonin Zhvillimor Jug për vitin 2020. 69
Tabela 43: Rajonet e Kosovës-Nataliteti, mortaliteti dhe shtimi natyror. Analiza e statistikave të ASK-së sipas vlerësimit të vitit 2020 89
Tabela 44: Popullsia sipas gjinisë në rajonet e Kosovës 92
Tabela 45: Struktura nacionale e popullsisë sipas rajoneve të Kosovës e shperhur në Përqindje 92
Tabela 46: Struktura fetare e popullsisë sipas rajoneve zhvillimore 93
Tabela 47: Aktiviteti ekonomik i popullsisë sipas rajoneve të Kosovës 94
Tabela 48: Veprimtarit ekonomike të popullsisë sipas rajoneve 94
Tabela 49: Numri i personelit administrativ dhe atij ndihmës. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021 103

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Kategorizimi i bizneseve në Rajonin Zhvillimor Qendër 27
Figura 2: Aktivitetet ekonomike në Rajonin Zhvillimor Lindje 39
Figura 3: Papunësia në Rajonin Zhvillimor Lindje, sipas komunave (burimi: Agjencioni për Punësim i Republikës së Kosovës. Raporti për vitin 2020. 41
Figura 4: Numri i popullsisë sipas rajoneve zhvillimore. Analiza e statistikave të ASK-së sipas vlerësimit të vitit 2020. 86
Figura 5: Popullsia urbane dhe rurale sipas rajoneve 87
Figura 6: Numri i vendbanimeve sipas rajoneve zhvillimore 87
Figura 7: Dendësia e popullsisë sipas rajoneve zhvillimore. Analiza e statistikave të ASK-së sipas vlerësimit të vitit 2020. 88
Figura 8: Nataliteti dhe mortaliteti Analiza e statistikave të ASK-së sipas vlerësimit të vitit 2020.....89
Figura 9: Piramida e popullsisë sipas rajoneve zhvillimore 91
Figura 10: Migrimi ndërkombëtar dhe kombëtar sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë në vitin 2019 96
Figure 11: Numri i familjeve sipas rajoneve.....96
Figura 12: Popullsia sipas nivelit të shkollimit dhe rajoneve zhvillimore.....98
Figura 13: Popullsia sipas nivelit të shkollimit dhe rajoneve zhvillimore në %.....99
Figura 14: Objektet Shkollore sipas Rajoneve. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021 100
Figura 15: Numri i fëmijëve në arsimin parafillor sipas rajoneve. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021 101
Figura 16: Numri i nxënësve në arsimin fillorë të mesëm të ulët. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021 102
Figura 17: Numri i nxënësve në arsimin mesëm të lartë Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021 102
Figura 18: Numri i mësimdhënësve sipas rajoneve. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021 103
Figura 19: Numri i fëmijëve moshes deri 6 vjeç në arsimin privat. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021 104
Figura 20: Numri i nxënësve në arsimin privat sipas rajoneve. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021 105

LISTA E HARTAVE

1. Ndarja Rajonale e Republikës së Kosovës
2. Rajoni Zhvillimor Qendër
3. Rajoni Zhvillimor Lindje
4. Rajoni Zhvillimor Veri
5. Rajoni Zhvillimor Përendim
6. Rajoni Zhvillimor Jug

1. Hyrje

Ndarja Rajonale e Kosovës sipas kritereve gjeohapësinore, funksionale dhe sociale-ekonomike ka qenë dhe mbeten përpjekje të parreshtura e shumë autorëve dhe studiuesve, për të qartësuar pëkufizimin thelbësor të bazuar në elementet përcaktuese për diferencimin e tij. Diferencimi i elementeve si kategori komplekse analizon elementet e peizazhit natyror, si bazë fundamentale e hapësirës në transformimin e së cilës, aktivitetet sociale-ekonomike përbëjnë shkallen dhe dinamikën e zhvillimit. Elementet e peizazhit natyror janë vetëm indikator reprezentativ me anë të të cilave bëhet diferencimi rajonal, prandaj, ata përbëjnë vetëm një grup të kritereve gjeografike, ndësa roli shoqëror bëhet gjithnjë e më tepër faktor vendimtar në transformimin e saj. Fizionomia si pamje e individualizuar e kompleksit gjeografik, përcakton elementin e diferencimit rajonal të një hapësire. Rajoni integron të gjitha elementet natyrorë dhe aktivitetet sociale-ekonomike të hapësirës, ndërsa analiza gjeografike është formë e interpetimit e cila përfundon me shpjegimin se cili është korelacioni i këtyre elementeve, apo cili nga ta mbizotron në përcaktimin e fizionomisë së tij. Sa më e lartë të jetë shkalla e zhvillimit të shoqërisë, aq më i transformuar do të jetë edhe rajoni gjeografik. Sipas shumicës së hulumtuesve bashkëkohorë, rajonet janë kategori kryesisht nën ndikimin e elementeve natyrore, por, kur proceset shoqërore kanë një shkallë të lartë zhvillimi, ato marrin pamjen e peizazhit kulturor. Përparsitë e studimit të rajonit gjeografik janë jo vetëm në inventarizimin e fenomeneve dhe proceseve gjeogafike, por edhe në përcaktimin e ekuilibrit, të statistikës, të dinamikës, të kompleksitetit, të funksionalitetit, të paralelizmit, dhe të estetikës së rajonit.

Hapësira e Kosovës me të gjitha elementet gjeografike, është hapësirë e individualizuar dhe specifike. Në territorin e saj kalojnë rrugë të rendësishme që lidhin brendësinë e Evropës së mesme, me Gadishullit Ballkanik, bregdetin e Detit Mesdhe dhe deteve përreth tij. Peizazhi natyror me male të larta për rreth, dhe fusha në mes tyre, tregon diferencat natyrore të rajonalizimit gjeografik, ndërsa shkalla e ulët e zhvillimit tregon për diferencimin shoqëror të saj. Bazuar elementet diferencuese të kompleksitetit gjeografik hapësira gjeografike e Kosovës mund të ndahet në dy njësi Rajonale gjeografike (në rrafshin e Kosovës dhe atë të Dukagjinit).

Nga aspekti administrativ ndraja rajonale e Kosovës ka ekzistuar edhe më herët dhe ka një historik i cili lidhet me zhvillimet sociale-ekonomike e politike të kësaj hapësire gjeografike. Ndarja rajonale kryesisht ka qenë e bazuar në komponentën hapësinord dhe zhvillimet sociale-ekonomike të kohës.

Gjatë periudhën 1974 – 1990, njësitë rajonale gjeografike kan qënë të organizuara në:

- ✓ Rrafshin e Kosovës i cila ka përfshirë: Rajonin erior (Mitrovicë, Leposaviq, Skenderaj dhe Vushtrri), Rajoni i mesëm (Prishtinë, Podujevë, Gllogoc dhe Lipjan), Rajoni jugor (Kamenicë, Viti dhe Gjilan), Rajoni i Ferizajit (Ferizaj dhe Kaqanik).
- ✓ Rrafshin e Dukagjinit i cili ka përfshirë pjesën përendimore (Peja, Istogu, Klina, Deçani, Rahoveci), dhe Rajonin Jugor (Prizreni, Suhareka, Malisheva dhe Gjakova).

Pas viteve të ’90-ta për nevoja statistikore është bërë ndarja e territorit të Kosovës pesë rajone (Rajoni i Prishtinës, Mitrovicës, Gjilanit, Prizrenit dhe Pejës).
Gjatë periudhës kohore 2000-2008, nga aspekti administrativ është ndarë në shtatë rajone (Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Prishtinë, Gjilan dhe Ferizaj).

Zhvillimi rajonal si temë dhe fushë e zhvillimit, nuk është e re në Kosovë, por në aspekt të shfrytëzimit më strukturor të fondeve të BE-së njihet që nga viti 2008. Zhvillimi rajonal i balancuar, nënkupton uljen e dallimeve në aspekt të zhvillimit socio - ekonomik dhe ngritjes

së cilësisë së jetës në rajone zhvillimore. Zhvillimi rajonal i balancuar nuk mund të arrihet pa ngritjen e kapaciteteve të rajoneve në mënyrë që të kenë një konkurrencë të mirëfilltë ndër rajonale. Është e nevojshme të ndërmerren masa për të ngritur konkurrencën ndër rajonale në mënyrë që të arrihen nivele më të larta të produktivitetit, punësimit dhe prosperitetit. Politika e zhvillimit të balancuar rajonal ndërhyn për të korigjuar pabarazitë mes rajoneve të ndryshme të një vendi dhe gjithashtu për ngritjen e standardit të jetesës në një nivel më të lartë me një normë të barabartë.

Për pasqyrimin e një situate sa më reale në aspektin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal në Kosovë, është me rëndësi që të realizohet paraprakisht ky studim vizibiliteti lidhur me monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar. Ky studim do të evidentojë të gjitha temat, fushat, treguesit dhe përcaktojë rrugën përmes së cilës Ministria e Zhvillimit Rajonal (tutje MZHR) do të sigurojë të dhënat e nevojshme për pasqyrtimin e zhvillimeve sociale dhe ekonomike rajonale. Përmes pasqyrimit të saktë të zhvillimeve socio – ekonomike, do të ndikohet edhe në orientimin e politikave strategjike dhe të investimeve të balancuara të ministrive të linjës në rajone zhvillimore. Studimi i vizibilitetit, përveç identifikimit të fushave, treguesve, metodologjisë së mbledhjes së të dhënave, raportimit, do ti ofrojë MZHR-së edhe modelin e sistemit që duhet ndërtojë, si dhe me të gjitha elementet e efikasitetit që duhet ti ketë. Kjo ka të bëjë me dizajnimin apo përshkrimin e sistemit i cili do të ndërtohet nga MZHR dhe shfrytëzohet nga personat kompetent, për monitorimin dhe matjen e performancës rajonale.

Studimi i vizibilitetit dhe dizajnimi i sistemit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar paraqet pikënisje për ndërtimin e sistemit për monitorimin e zhvillimeve sociale dhe ekonomike të rajoneve zhvillimore. Ky sistem do të identifikoj të gjitha fushat relevante të zhvillim social dhe ekonomik mbi bazën rajonale, treguesit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik si dhe përmes këtij sistemi do bëhet monitorimi në afate të rregulluara të zhvillimit ekonomik dhe social në rajone zhvillimore si dhe stimulimi, promovimi dhe menaxhimi i perfomancës rajonale, si synim ky strategjik i MZHR-së.

1.1. Qëllimi

Qëllimi i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është pasqyrimi sa më real i zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë. Për ta realizuar këtë, MZHR duhet të analizoj çështjet që ndërlidhen me zhvillimin socio-ekonomik rajonal në Kosovë duke përfshi çështjet që i tejkalojnë kompetencat e komunave dhe që ato ndërlidhen me nivelin qendror. Zhvillimi socio – ekonomik rajonal i balancuar, në disa aspekte tejkalon kufijtë komunal të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, si dhe nuk ka të bëjë me çështje administrative të organizimit të niveleve të qeverisjes. Zhvillimi socio – ekonomik rajonal i balancuar, nuk kufizohet në nivelin e zhvillimit ekonomik lokal, por e tejkalon atë duke pasqyruar edhe zhvillimin e sektorëve dhe projekteve të zhvilluar në dy e më shumë komuna.

Monitorimi i zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, është një qasje e re, të cilën nuk e kanë zhvilluar më herët institucionet e nivelit qendror. Studimi i këtij vizibiliteti, bëhet me qëllim të krijimit të një pikënisje të ndërtimit të një sistemi, të cilin MZHR do ta menaxhojë, ndërsa në të do të përfshihen si përdorues zyrtar lokal dhe qendror lidhur me përfshirjen e të dhënave. Përmes ndërtimit të një sistemi, me përmbajtje të dhënave të zhvillimeve sociale dhe ekonomike të rajoneve zhvillimore të cilat i promovon MZHR, do të ndikojë në balancimin e investimeve në rajone, si dhe pasqyrimin e saktë të fushave në të cilat kemi stagnim të zhvillimit dhe që duhet të angazhohemi më shumë për progres. Kjo ka për qëllim edhe vënien në pah të pabarazive në aspekte të ndryshme të mirëqenës socio-ekonomike në të gjitha rajonet e Kosovës dhe të pasqyrimit të ndryshimeve me kalimin e kohës, duke i promovuar faktorët ndikues dhe ata që shihen si pengesë.

Me qëllim të elaborimit më të detajuar të përmbajtjes dhe përshkrimit të procesit të zhvillimit të studimit dhe dizajnimit të sistemit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal te balancuar, fillimisht janë përcaktuar disa objektiva. Objektivat që synohet të arrihen përmës realizimit të studimit të vizibilitetit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë dhe dizajnimin e sistemit, janë:

1. Definimi i të gjitha temave/aktiviteteve (sociale dhe ekonomike) që mund të përbëjnë zhvillimet sociale dhe ekonomike rajonale dhe të cilat mund të maten e pasqyrohen në periudha të caktuara nga MZHR.
2. Sigurimi i informacioneve që do të mund të shfrytëzohen në të ardhmen, për realizimin e monitorimit të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar. Cilat janë temat e trajtimit që mund të hynë në kuadër të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, fushat e trajtimit, cilët janë treguesit për matjen e zhvillimeve sociale dhe ekonomike rajonale, realizimin e proceseve për raportimin dhe mbledhjen e të dhënave/metodologjia e punës, akterët që duhet të përfshihen, një përshkrim për ndikimet e pritshme të dokumenteve analitike të publikuara nga MZHR për pasqyrimin e rregullt të monitorimit të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, etj. Të gjitha aktivitetet që do t'i përmbajë studimi dhe që i rekomandohen MZHR-së, do të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe duke respektuar fushë veprimtarinë e institucioneve tjera.
3. Zhvillimin e një sistemi elektronik nga MZHR për matjen e zhvillimeve sociale dhe ekonomike mbi baza rajonale, duke i konkretizuar pastaj ato edhe nëpër njësi (komuna) apo çështje ma konkrete (fusha dhe sektor). Cila duhet të jetë përmbajtja e këtij sistemi, kush mund të jenë përdoruesit dhe numri i tyre, siguria dhe mirëmbajtja, ndryshimet dhe modifikimet, dokumentimi i souftuerit, në çfarë platforme duhet të zhvillohet, etj.

4. Të gjitha elementet që ndërlidhen me sistemin elektronik për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar (performancës rajonale) do të paraqiten në një pjesë të veçantë e cila do të përdoret nga MZHR për kontraktimin e kompanisë që do ta zhvillojë këtë sistem.

Studimi i vizibilitetit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, është hartuar mbi bazën e një metodologjie të punës së hapur dhe të konsultuar në vazhdimësi me përfaqësuesin/njësinë përkatës/e në MZHR.

Gjithashtu, gjatë realizimit të këtij studimi, MZHR, kishte në dispozicion të gjithë dokumentacionin e hartuar dhe publikuar (në vitet 2018, 2019, 2020) që kanë shërbyer si burime të informacionit.

1.2. Metodologjia e punës

Puna në hartimin e këtij dokumenti është realizuar në tri metoda:

1. Hulumtimi i materialeve ekzistuese
2. Analiza
3. Përshkrimi dhe paraqitja e rezultateve

Metoda e hulumtimit – Gjatë hartimit të këtij dokumenti janë bërë hulumtime rreth materialeve të ndryshme që ndërlidhen me fushën e zhvillimit socio-eonomik rajonal. Paraprakisht janë shqyrtuar të gjitha ligjet, rregulloret, strategjitë dhe domentacioni tjetër ekzistues. Kjo me qëllim që ky dokument të jetë në harmoni të plotë me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi. Gjithashtu, ky dokumet është përgatitur në harmoni të plotë edhe me strategjinë.

Studimi mbështetet në të dhënat e fituara nga shfrytëzimi i literaturës së shkruar; gjatë vizitave në terren; të dhënat statistikore në trajtë tabelash dhe grafikësh; ato hartografike (hartat topografike dhe tematike) dhe të imazheve satelitore; të dhëna vektoriale e aerofotografi që paraqesin gjendjen faktike të dukurive dhe proceseve në teren. Gjatë fazës së parë të punës është bërë studimi dhe vlerësimi i dokumentacionit në zyrë, janë mbledhur dhe shqyrtuar të dhënat lidhur me zhvillimet social-ekonomike dhe hapësinore në nivel komune dhe rajoni, të publikuar deri më tani në Kosovë dhe jashtë saj.

Procesi i analizës përfshin përpunimin e të dhënave digjitale, të atyre të përfituara nga skanimi dhe gjeoreferimi, si dhe të dhënave tematike të ndryshme, të domosdoshme për demonstrimin e fakteve dhe zhvillimeve hapësinore. Në këtë studim, shqyrtimi i materialit, analiza dhe interpretimi janë kombinuar në Sistemet e Informacionit Gjeografik (SIGJ). Gjithashtu, është përdorur një SIGJ aplikacion softuerik, për të gjeneruar të dhëna hapsinore nga hartat topografike, tematike, ortofotot dhe imazhet satelitore.

Tabela 1. Qasjet e studimit

Metodat e përdorura	**Materialet bazë**	**Struktura e të dhënave**	**Formatet e të dhënave**	**Aplikacionet e përdorura**	**Mënyrat e paraqitjes**
Anketa dhe intervista	Baza Ligjore Strategjitë Zhvillimore	Alfanumerike	Excel file *.xls	Microsoft Office Excel 2013	Tekstuale
Shfrytëzimi i literaturës	Harta tematike	Raster	Ëorddocument *.doc	Microsoft Office Ëord 2013	Tabelore
Skanimi i dokumentve	Ortofotot; v.2000, v.2004, v. 2012	Vektoriale	*jpg	Paint	Hartografike
Vrojtimit	Imazhet satelitore v.2009,	Tabelare	*bitmap	CSPro 4.1	Grafike
Krahasimit	Fotografi		*tab	MapInfo	Fotografi

Analizës	Harta top.1:25000, v.1979 1:50000, v. 2000, 1:100000, v. 1976 1:300000, v. 1976		*PDF	Vertikal Maper	skematike
SIGJ	Literatura			ArkGIS	
GPS					

SIGJ si metodologji në realizimin e këtij studimi ka ndihmuar shumë, duke bërë strukturimin e të dhënave me komponentë hapësinore, identifikimin hapësinor të veprimtarive sociale dhe ekonomike, matjen e sipërfaqeve, përcaktimin e distancave, krahasimin e të dhënave, përcjelljen e zhvillimeve hapësinore të dukurive, identifikimi e zonave të ndërtuara në hapësira rurale dhe urbane, prezantimin përmes hartave të dukurive hapësinore dhe social-ekonomike, si dhe ka krijuar mbështetje profesionale për të nxjerrë sugjerimet e nevojshme për zhvillimin dhe transformimin hapësinor të vendbanimeve në të ardhmen.

2. Baza ligjore, strategjitë dhe dokumentet tjera

Në Kosovë ekzistojnë politikat zhvillimore në nivel kombëtar, derisa ka mungesë të politikave për zhvillim rajonal. Megjithatë, sipas Strategjsë për Zhvillim Rajonal e aprovuar nga Qeveria e Kosovës për 10 vite (2020-2030), parashihet hartimi i politikave të nevojshme për zhvillim rajonal. Deri më tani ligji dhe rregullorja për bashkëpunim ndër komunal është zbatuar si bazë për bashkërendimin e aktiviteteve për zhvillim rajonal.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Ligjet dhe aktet nënligjore në të cilat ky dokument është i bazuar janë si në vijim:

1. **Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale –** përcakton fuqinë e plotë të autoriteteve lokale për sa i përket interesave lokale. Ky ligj po ashtu përcakton kompetencat të qarta sa i përket organizimit dhe funksionimit të organeve komunale**,** financimit të komunave, marrëdhënieve brenda komunave, bashkëpunimit ndër komunal dhe ndërkufitar si dhe marrëdhënieve ndërmjet komunave dhe nivelit qendror. Ligji për vetëqeverisje lokale liston fushat në të cilat autoritetet lokale kanë kompetenca ekzekutive dhe këto ushtrohen në përputhje me standardet e përcaktuara në ligjin në fuqi. Sipas këtij ligji, komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë dhe krijojnë partneritet me komunat tjera të Republikës së Kosovës, brenda fushës së kompetencave të tyre për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët. Po ashtu, komunat kanë të drejtë të lidhin edhe marrëveshje bashkëpunimi me organet të huaja të vetëqeverisjes lokale.
2. **Ligji Nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal** – rregullon bashkëpunimin ndër-komunal midis komunave të Republikës së Kosovës për nevojat e ushtrimit të kompetencave të tyre vetanake dhe të zgjeruara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligji në fuqi si dhe Kartën Evropiane për vetëqeverisje lokale të Këshillit të Evropës. Po ashtu rregullohet edhe bashkëpunimi i komunave të Republikës së Kosovës në kuadër të binjakëzimit ose formave të tjera të bashkëpunimit brenda kompetencave vetanake dhe të zgjeruara të komunave. Ky ligj parasheh edhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndër-komunal, ku dy ose më shumë komuna kanë të drejtë të lidhin marrëveshje për qëllimet e tyre të përbashkëta në fushën e shërbimeve publike komunale si dhe atë të zhvillimit lokal.
3. **Rregullorja për nxitjen e bashkëpunimit ndër-komunal** – rregullon nxitjen dhe përkrahjen e bashkëpunimit ndër-komunal dhe zhvillimit socio-ekonomik rajonal. Në veçanti, përcakton fushat/kompetencat si dhe kriteret për bashkëpunim përfshirë: zhvillimin socio-ekonomik lokal dhe rajonal, zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës, planifikimi urban dhe rural, mbrojtja e mjedisit, promovimi dhe zhvillimi i turizmit, promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, zhvillimi i infrastrukturës ndër-komunale, si dhe çështje tjera që janë në kompetencë vetanake të komunave.
4. **Rregullorja për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar** – përcakton formën dhe procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në mes të institucioneve të vetëqeverisjes lokale te Republikës së Kosovës me komunat dhe institucionet tjera të vetëqeverisjes lokale jashtë Republikës së Kosovës. Komunat kanë të drejtë të lidhin marrëveshje bashkëpunimi të karakterit administrativ dhe teknik edhe me institucionet tjera të qeverisjes lokale jashtë vendit. Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të lidhet në disa fusha si në zhvillim ekonomik, planifikim urban dhe rural, zhvillim dhe shfrytëzimin e tokës,

mbrojtjen e mjedisit lokal, ndërtimin dhe kontrollin sipas standardeve, ofrimin e arsimit publik, parashkollor, fillor dhe të mesëm, shëndetësinë publike, banimin publik, zhvillimin e infrastrukturës, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe shumë çështje tjera që janë në kompetencë të komunave me legjislacion të zbatueshëm në Kosovë.

5. Rregullorja (QRK) nr.16/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar ne Rregulloren nr.07/2011, Rregulloren nr.14/2017dhe Rregulloren nr.15/2017- kjo rregullore përcakton mandatin e ministrisë së zhvillimit rural.

Legjislacioni aktual nuk rregullon çështjet specifike për zhvillim rural si: zhvillimin rajonal të balancuar, zhvillimin socio-ekonomik rajonal, si dhe nuk ka të paraparë elemente që rregullon kornizën ligjore dhe të politikave për zhvillim rajonal.

3. Rajonet në Kosovë, përkufizimi dhe karakteristikat e tyre

Republika e Kosovës si tërësi gjeografike shtrihet ndërmjet gjerësisë gjeografike veriore $41^0$51'9" - 43,16'10" dhe gjatësisë gjeografike lindore $20^0$37'20"-$21^0$47'37". Ajo përfshinë një siperfaqë prej 10905.25 km2, në të cilën jetojnë 1,798,188 banorë (165 b/km^2)[1]. Pozita e mirë gjeografike, në qendër të Ballkanit, dhe lidhjet e mira me të gjitha shtetet për rreth, mundësojnë qasje në korridore të rëndësishme rajonale e hapësinore. Kjo ka ndikuar që hapësira e Kosovës të ketë makro pozitë specifike, gjë që ka ndihmuar në zhvillimin dinamik të saj gjatë shekullit XX, me theks të veçant në dy dekadat e fundit. Kufizohet me Shqipërinë në jug-perëndim, Malin e Zi në perëndim, veri-lindje me Serbinë dhe me Maqedoninë e Veriut në jug-lindje. Territori i Kosovës ka lartësi mbidetare mesatare prej 800, dhe karakterizohet me forma të ndryshme të relievit, kryesisht forma malore dhe fushore. Pika më e lartë mbi nivelin e Detit është Gjeravica (2565m), ndërsa më e ulta gjendet në Vermicë (325m).

Mikro Pozita gjeografike - shtrirja e rrugëve në konfiguracion të terrenit në mes të lartësisë mbi nivelin e detit 300 deri 900m, dhe me pjerrtësi të terrenit deri në 5˚, ka krijuar parakushte të mira për zhvillimin e vrullshëm të vendbanimeve. Pas përfundimit të hekurudhës që kishte qëllim lidhjen e Prishtinës dhe Selanikut për të krijuar qasje ne Detin Egje (v. 1973), dhe hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë (v.1936), si dhe ndërtimit të rrugëve nacionale krijohen kushte të mira komunikative me qendrat më të mëdha rajonale, me ç'rast fillon edhe zgjerimi i qendrave në brendësi të saj. Rëndësi të veçantë për zhvillimin e vendit në dekaden e fundit kanë rrugët e karakterit ndërkombëtar autoudhët, si ajo Vermicë-Arllat (gjatësi 38 km) edhe Prishtinë-Han i Elezit (gjatësi 65.6km), të cilat mundësojnë komunikimin më të mirë me vendet e rajonit në drejtim të Jug-Përendimit, Jugut dhe Veri-Lindjes. Lidhjet e mira të komunikacionit i kanë mundësuar Vendit qasje me të gjitha qytetet kryesore të rajonit. Qyteti më i afërt është Shkupi është 93km, pastaj Tirana 259km, Podgorica 300km, Sofia 334km dhe Beogradi 524km. Nën ndikimin e pozitës së mirë gjeografike dhe zhvillimit të infrastrukturës rrugore e hekurudhorë, janë zhvilluar qytetet si: Prishtina, Prizreni, Mitrovica, Ferizaj, Gjilani, Podujeva, Peja, Gjakova, etj.

Infrastruktura rrugore – si element shtyes i zhvillimit ekonomik në nivel nacional është plotësuar në masë të madhe gjatë viteve në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Krahasuar me vitin 2005 dallimi është i ndjeshëm, prandaj është me rendësi të thuhet se Kosova si terësi territoriale ka infrastrukturë të zhvilluar në katër nivele (Autoudhë, Rrugë Nacionale, Rrugë Rajonale dhe Rrugë Lokale). Vetëm, në tri kategoritë e para gjatësia e rrugëve është 2378.7km. Nga totali i rrugëve në këto kategori; autoudhët marrin pjesë me 5.77%, rrugët nacionale 31.75% dhe ato Rajonale me 62.48%. Në mungesë të të dhënave dhe rrugët lokale nuk janë trajtuar. *Autoudhët* si pjesë e infrastrukturës rrugore deri ne vitin 2010 kanë munguar, pastaj, në vitin 2011 evidentohet traseja e Autostradës Ibrahim Rugova (Vermicë Arllat) me gjatësi prej 38km, e cila ka ndihmuar në lidhjen e rajoneve dhe rrugëve nacionale e Rajonale të pjesës qendrore dhe jug-përendimore të Kosovës. Zhvillimi i këtij niveli të autoudhëve është duke vazhduar edhe sot. Sipas statistikave në vitin 2020 janë evidentuar gjithësejt 137.2 km gjatësi e autostradave, që i bie se gjatë periudhës 2011 - 2020 kemi rritje të kësaj kategorie të rrugëve për rreth 100 km, (10.1 km /vit). Përkthyer në investime kapitale del se mbi 100 milion euro në vit, janë investuar në këtë kategori të rrugëve. Nga këto rrugë janë prekur tri rajone: rajoni qendër, lindje dhe jug. Ky është tregues se institucionet qendrore janë të fokusuara në zhvillimin e kësaj kategorie të rrugëve të cilat kanë karakter ndërkombëtarë dhe ndihmojnë plotësimin e infrastrukturës rrugore që lidhen me shtetet fqinje, përkatësisht korridoret ekonomike ndërkombëtare, siç është korridori i 8 dhe 10-të. *Rrugët Nacionale* – si pjesë e

[1] Agejncioni I Statistikave të Kosovës. Vjetari Statistikor. Vlerësimet për vitin 2020. Prishtinë 2021.

infrastrukturës rrugore me rolë të rendësishëm në zhvillimin rajonal, ka shënuar ngecje të vazhdueshme gjatë periudhës kohore 2005-2016. Deri në vitin 2016 janë evidentuar gjithsejtë 630.4km gjatësi dhe nuk është evidentuar ndonjë rritje e kësaj kategorie të rrugëve, por është bërë sanimi dhe mirëmbajtja e traseve egzistuese, në disa raste zgjërimi i tyre. Nga viti 2017 deri në vitin 2020 janë është evidentuara se kemi rritje për 124.8 km rrugë të kësaj kategori, rrjedhimisht kjo kategori mbrrinë gjatësi totale prej 755.2km dhe ka shtrirje hapësinore në të gjitha rajonet e Kosovës. *Rrugët Rajonale* – kanë pjesmarrjen më të madhe në kategorizimin e rrugëve me gjithsejtë 1486.3 km, dhe kanë shtrirje hapësinore në të gjitha komunat e Kosovës. Që nga paslufta dhe deri në vitin 2012, investimet në zhvillimin e kësaj kategorie të rrugëve, kanë qenë të koncentruara vetëm në riparimin e tyre. Ndërsa nga viti 2013 deri në vitin 2020 kemi zhvillim të kësaj kategorie të rrugëve për rreth 500 km.

Tabela 2. Infrastruktura rrugore

Gjatesia e rrugëve (km) sipas kategoria dhe viti[2]							
Përshkrimi	**2005**	**%**	**2019**	**%**	**2020**	**%**	**Dallimi 2005 - 2020**
Autoudhë	0	0.00	137.2	5.94	137.2	5.77	137.20
Nacionale	630.4	16.04	665.2	28.78	755.2	31.75	124.80
Rajonale	1294.7	32.94	1509.4	65.29	1486.3	62.48	191.60
Gjithsej	**3930.1**	**48.98**	**2311.7**	**100.00**	**2378.7**	**100.00**	**453.60**

Nga aspekti hapësinorë ndarja administrative e Republikës së Kosovës përcaktohet në katër nivele: Territori i Republikës së Kosovës, komunat administrative, zonat kadastrale dhe parcelat kadastrale. Konfiguracioni i terrenit, fizionomia hapësinore, lidhjet ndërmjet komunave, dhe karakteristikat sociale-ekonomike, imponojnë nevojën e përkufizimit rajonal të hapësirës gjeografike të R. Kosovës.

Prandaj, Ministria e Zhvillimit Rajonal, bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me Rregulloren (QR) Nr. 16/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe bazuar në Planin vjetor të punës për vitin 2019, ka hartuar dokumentin "Profilet e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë". Ky dokument, është dokumenti i parë i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal që pasqyron profilet e zhvillimit socio – ekonomik të rajoneve zhvillimore në Kosovë. Emërtimi "Profilet e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë', përmban në vete të gjitha elementet sociale dhe ekonomike në aspekt të zhvillimit të gjithmbarshëm të rajoneve zhvillimore të Kosovës dhe i cili emërtim rrjedh nga Koncept – Dokumenti për Zhvillim Rajonal i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 13/61 të datës 22.08.2018[3].

Individualiteti gjeografik i rajoneve përcaktohet nga shumë elemente dhe faktorë, përfshirë poziten gjeografike, relievi i ndryshuar përkrah hipsometrisë, diferencat në elementet klimatike në mes pjesëve të ulta dhe atyre malore, hidrografi specifike dhe botë bimore të llojllojshme. Ndryshimet në elementet natyrore janë manifestuar edhe në proceset shoqërore, si rrjedhojë e të cilave është edhe dendësia më e madhe e popullsisë në pjesët fushore dhe kodrinore, ndërsa më e vogël në pjesët malore. Në aspektin funksional, qendrat urbane me veprimtari të shumta

2 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__Transport__Annual%20indicators/tr10.px/Tabela/TabelaVieëLayout1/?rxid=d43a5363-b9e4-4886-83c6-948636c2a711

3 Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, "Profilet e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë", 2019

reprezentative dhe administrative janë fokuset kryesore që integrojnë hapsira të caktuara gjeografike, të cilat marrin rolin e qendrave rajonale.

Zanafilla e zhvillimit rajonal në Kosovë njihet më herët dhe ishte i bazuar në parimin e homogjenitetit dhe uniformitetit gjeografik. Por, në aspekt të shfrytëzimit më strukturor të fondeve të BE-së njihet që nga viti 2008, përmes themelimit të pesë (5) agjencioneve zhvillimore rajonale (AZHR "Qendër", AZHR "Veri", AZHR "Perëndim", AZHR "Jug" dhe AZHR "Lindje", nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës së BE-së në Prishtinë. Që nga kjo përiudhë fillon klasifikimi adminstrativ me komponentë hapësinorë i rajoneve, me qëllim që të krijohet balansimi hapësinor, social-ekonomik e administrativ i tyre.

Duke u bazuar në karakteristikat e shënuara më lartë, Kosova si tërsi gjeografike ndahet në 5 rajone: Rajoni Zhvillomor Qendër, Rajoni Zhvillomor Lindje, Rajoni Zhvillomor Veri, Rajoni Zhvillomor Perëndim dhe Rajoni Zhvillomor Jug.

Tabela 3. Ndarja rajonale

Rajonet e Kosovës							
	Rajonet	**Popullsia**	**% e popullsisë**	**Sip.km²**	**% e territorit**	**Nr. i vendb.**	**%**
1	Rajoni zhvillimor Qendër	517723	29	2215.52	20.32	299	19.96
2	Rajoni zhvillimor Lindje	325971	18	2298.5	21.08	293	19.56
3	Rajoni zhvillimor Veri	224121	12	2051.84	18.81	361	24.1
4	Rajoni zhvillimor Perëndim	323468	18	2324.38	21.31	314	20.96
5	Rajoni zhvillimor Jug	406905	23	2015.01	18.48	231	15.42
	Gjithsej	1798188	100	10905.25	100	1498	100

Nëse analizohet koncentrimi i popullsisë sipas rajoneve në Kosovë (projeksionet e vitit 2020), del se koncentrimi i popullsisë më i madh është në Rajonin Zhvillimor Qender ku jetojnë 29% e popullsisë, i dyti me radhë është Rajoni Zhvillimor Jug me 23% të popullsisë, pasuar nga Rajoni Zhvillimor Lindje me 18% të popullsisë, Rajoni Zhvillimor Perëndim me 18% të popullsisë dhe Rajoni Zhvillimor Veri me 12% të popullsisë.

Bazuar në shtrirjen hapësinore rajoni me sipërfaqe më të madhe është Rajoni Zhvillimor Perëndim me 21.31% e sipërfaqës së përgjithëshme, pastaj vjen Rajoni Zhvillimor Lindje me 21.08%, Rajoni Zhvillimor Qendër me 20.32%, Rajoni Zhvillimor Veri me 18.81% dhe Rajoni Zhvillimor Jug me 18.48%. Ndërsa sa i përket koncentrimit të vendbanimeve, Rajoni me numrin më të madh të vendbanimeve është Rajoni Zhvillimor Veri me 361 vendbanime, pasuar nga Rajoni Zhvillimor Përendim me 314, Rajoni Zhvillimor Qendër me 299, Rajoni Zhvillimor Lindje me 293 dhe Rajoni Zhvillimor Jug me 231 vendbanime.



Harta 1. Ndarja Rajonale e Republikës së Kosovës

3.1 Rajoni Zhvillimor Qendër

Pozita e mirë gjeografike, konfiguracioni relativisht i butë i terenit, lidhjet e mira me shtetet e tjera të Evropës Jugore përmes koridorin e 10-të (pika kufitare Merdar), kryqëzimi i rrugëve kryesore në nivel nacional dhe rajonal përmes Autostradës (Arbër Xhaferi) dhe magjistralës së Pejës e cila e lidhë me autostradën Ibrahim Rugova, pastaj Prishtina si kryeqendër me funksione administrative, sociale-ekonomike e edukative dhe koncentrimi i idustrisë kryesore, bëjnë që ky rajon të veçohet për nga karakteristikat fiziko-gjeografike dhe sociale-ekonomike.

Harta 2. Rajoni Zhvillimor Qender

Në morfologjinë e relievit pjesmarrje më të madhe kanë format kodrinore dhe zënë sipërfaqe prej 1462 km2 ose 66%, ndërsa format fushore kanë shtrirje prej 744 km2 ose 34% të territorit të Rajonit, krahasuar me fushat e rajonin verior i bie të jetë dy herë më e madhe se fushat e tij.

Rajoni Zhvillimor Qendër përbëhet nga 299 vendbanime të shprendara në gjithësej tetë komuna administrative me sipërfaqe prej 2,215.52 km2 apo 20.31% e territorit të Kosovës. Komuna me numër më të madh të vendbanimeve është Podujeva 77 sosh, përcjellë nga Lipjani me 62 dhe Prishtina me 43 vendbanime, ndërsa me numrin më të vogël të vendbanimeve e ka Graqanica me 17 vendbanime (shih tabela 1)

Prishtina si qendër më e madhe urbane me larmi të funksioneve ka rendësi të madhe jo vetëm për rajonin qendër, por për gjithë Kosovësn. Ajo me një numer të madh të aktiviteteve reprezentative dhe veprimtari të larmishme të sektorit terciar dhe kuaternar, bëhet atraktive për të gjitha rajonet.

3.1.1 Popullsia

Karakteristikë tjetër e Rajonit Zhvillimor Qender janë proceset sociale-ekonomike, të cilat janë të lidhura me zhvillimin dinamik të popullsisë, si në aspektin e regjimit demografik, i cili mund të konsiderohet si ekspansiv, po ashtu edhe me shtimin mekanik të popullsisë. Kjo hapësirë gjeografike, dallohet për kah dendësia e madhe e popullsisë prej 236.6 banorë në km2, afërsisht një herë më e madhe se dendësia mesatare e Kosovës. Popullsia prej 517,723 banorëve (29% të tërë popullsisë së Kosovës) e kategorizon hapësirën gjeografike si rajonin me koncentrim më të madh të popullsisë. Komuna me numër më të madh të popullsisë është Prishtina (218.782 banorë), e dyta renditet Podujeva me 82.023 banorë, pastaj Drenasi me 61145 banorë, ndërsa me numrin më të vogël të popullsisë është Graqanica me 12229 banorë. Përkundër që komuna e Prishtinës ka epitetin e qendrës administrative me të gjitha funksionet administrative, reprezentative dhe sociale-ekonomike, ajo renditet e dyta sa i përket dendësisë së popullsisë (418 b/km2. Me dendësi me të madhe është Fushë Kosova (475 b/km2), ndërsa me dendësi më

të vogël është Graqanica me 100 banorë/km2. Aktivitetet sociale-ekonomike dhe administrative të cilat zhvillohen në këtë hapësirë gjeografike, përfshirë funksionin administrative, ekonomik, edukativo-arsimor, Juridik, legjislativ, diplomatik, kulturor e qeverisës në nivel nacional e lokal, ndihmojnë që rajoni të ketë potencial të madh në zhvillimin ekonomik, dhe ofertë të mirë t ë vendeve të punës. Prandaj, mund të konsiderohet si rajoni - bosht zhvillimor në Republikën e Kosovës.

Tabela 1: Komunat dhe vendbanimet e Rajonit Zhvillimor Qendër. Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021. Vlerësimit për vitin 2020

	Komunat	**Popullsia[4]**	**Sipërfaqja km²**	**Dendesia e pop.**
1	Prishtinë	218.782	523.13	418
2	Podujevë	82.023	632.59	130
3	Lipjan	57.928	338.41	170
4	Obiliq	18.218	104.84	174
5	Drenas	61.145	275.63	222
6	Shtime	27.450	134.42	204
7	Fushë Kosovë	39.948	84.09	475
8	Graçanicë	12.229	122.41	100
	Gjithsej	**517723**	**2215.52**	**233.6**

3.1.2. Relievi dhe ndërtimi gjeologjik

Rajoni Zhvillimor Qender në aspektin e strukturës së relievit, diferencohet me pjesën e ultë të fushës, kryesisht në hapësiren e Prishtinës dhe Fushë Kosovës, e cila në aspektin morfotektonik i takon zonës së fundosur të fushës, ndërkaq format kryesore të morfogjenezës janë rezultat i veprimtarive tektonike, pas së cilës kanë pasur ato erozive dhe akumulative të rrjedhave lumore. Pjesët më të larta të relievit i janë nënshtruar erozionit fluvial, të cilat e bëjnë reliev më të coptuar dhe më të llojllojshëm. Relievin e kësaj hapësire e përbëjnë tri formacione kryesore gjeografike: Fusha e Kosovës, hapësira e Gollakut dhe ajo e Drenicës jugore. *Hapësira e Gollakut* shtrihet në pjesën lindore të RZhQ. Diferencohet me reliev të lartë, ku amplituda hipsometrike është në mes 800 deri 1000. Mbizotrojnë formacionet e mesozoikut e më pak ato të paleozoikut. *Fusha e Kosovës* është terësi rajonale, të cilën relievi i ulët, i rrafshët me ngritje të butë, në të dy anët e lumit Sitnica, e bëjën këtë hapësirë individuale dhe specifike në kuadër të Rajonit Qendër. Lartësia mbidetare sillet prej 540 deri 600m. Fusha e Kosovës arrinë gjatësi prej 40km, ndërsa gjerësia e saj është rreth 20km. Lumi Sitnica është elementi kryesor në fizionomin e peisazhit të kësaj fushe. Fusha e Kosovës në ndërtimin gjeologjik paraqet një hapësirë homogjene me formacione të reja si depozitimet ranore dhe rëra argjilore e rrafshinave aluviale të Sitnicës dhe degëve të saj. Ne të dy anët e Sitnicës mbi rrafshinat aluviale janë të përhapura sedimentet liqenore të pliocenit, të cilat përfaqësohen nga argjilat ranore dhe mergele. Pjesë e fushës së këtij Rajoni është edhe ajo e Llapit, e cila krahasuar me atë të Fushës së Kosovës është pak më e lartë. Fusha e Llapit i ka të gjitha tiparet e Fushës së Kosovës, si

[4] Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021. Vlerësimi për vitin 2020

për kah gjeneza dhe proceset që janë shfaqur më vonë, ashtu edhe në ndërtimin litologjik. *Drenica Jugore* ka ndërtim litologjik të llojllojshëm ku mund të hasen gati nga të gjitha moshat gjeologjike. Formacionet e vjetra të paleozoikut dhe kanë shtrirje periferike. Ato janë të përfaqësuara me filite dhe rreshpe të palezoikut të vjetër. Prej sedimenteve të mesozoikut përhapje më të madhe ka jura, por mund të hasen edhe serpentinat, formacionet diabaz-strallor, si dhe formacione të reja të pliocenit që përfaqësohen nga mergelat, argjila, rëra dhe zhavori.

3.1.3. Klima

Hapësira gjeografike e RZhQ, e gjendur në mes të Maleve Kopaunikut në Veri dhe Malit Sharr në jug, e ku gërshetohen shumë elemente klimatike të cilat kanë përcaktuar që klima të jetë transite. Prandaj, themi se klima është kontinentale e karakterizuar me ndikime esdhetare dhe Alpine, ku vera është ngrohtë dhe dimri i ftohtë. Temperatura mesatare brenda vendit luhatet nga +25 °C (verë) në –10 °C (dimër). Kjo zonë është e karakterizuar nga një klime e thatë dhe reshje vjetore afërsisht 600 mm në vit.

3.1.4. Ujërat

Rajoni Zhvillimor Qendër është i varfër me ujra sipërfaqësore. Lumi kryesor i kësaj hapësire gjeografike është Sitnica. Ka rrjedhje kryesisht fushore me meandrra të shumta dhe shtrihet në drejtim veri – jug. Rrjedh nëpër pjesën më të ulët të Fushës së Kosovës deri në grykëderdhje në lumin Ibër. Sitnica është e gjatë 90km. Përbëhët nga rrjedha e Maticës me Sazlinë, lumi i Shtimës, lumi i Prishtinës, lumi Llap (me degët Kaçandoll, Dubnica dhe Batllava), lumi i Graqanicës, lumi Drenica. Në rrjedhen e mesme të Graqanicës në vitin 1966, është ndërtuar liqeni artificial i Badovcit. Ai është i gjerë 150-200 m, dhe i gjatë 3.5 km, me akumulacion prej 26 milionë m^3, që shfrytëzohet për të furnizuar me ujë Prishtinën me rrethinë. Liqeni i Batllavës gjithashtu është element shumë i rendësishëm në fizionominë e Rajonit Zhvillimor Qendër. Liqeni është i gjërë 300m e i gjatë 8 km, me thellësi 30 deri 35 m, në të cilin akumulohen rreth 40 milion m^3.

3.1.5. Tokat dhe Vegjetacioni

Si komponentë e rëndësishme me bazë gjeografike janë edhe tokat e vegjetacioni. Me përdorimin e mjeteve agroteknike bashkëkohore në vazhdimësi është ndikuar në ndrrimin e tërsishëm të përhapjes së tyre, që rrjedhimisht kanë ndikuar në transformimin e hapësirës gjeografike. Në Rajonin Zhvillimor Qender tokat ngjyrë kafe kanë përhapje më të madhe e të cilat biologjikisht janë mjaft aktive dhe më së shumti shfrytëzohen për kultura bujqësore dhe pyje. Ndërsa më pak të përhapura janë tokat smonicës, të cilat dikur ishin toka liqenore. *Pyjet* kanë përhapje më të madhe rreth 40% të sipërfaqës, dhe shtrihen në pjesën periferike të Rajonit. Dominojnë llojet e pyjeve të dushkut dhe ato të bungut, ahut, etj. Ato shtrihen në zonën e Gollakut kah veriu dhe mbrrinë deri te burimi i lumit Llap. Pyjet e tjera gjenden në hapësiren periferike të Drenicës jugore. Të gjitha këto pyje shtrihen në lartësi prej 700 deri 800 m mbi nivelin e detit.

3.1.6. Arsimi

Infrastruktura dhe cilësia e shërbimeve arsimore në Rajonin Zhvillimor Qendër është në nivel mjaft të mirë. Janë ndërtuar dhe riparuar një numër i madh i institucioneve shkollore dhe universitare. Sipas statistikave të arsimit publik 2020-2021 numri i shkollave në Rajonin Zhvillimor Qendër në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 232, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 31. Numri i nxënësve në rajonin zhvillimor qendër në arsimin fillor dhe të mesëm

të ulët është 72.563. Në arsimin e mesëm të lartë janë 22.338 ndërsa nga ta 11454 ose 51.25% janë në shkolla profesionale.[5]

Tabela 2: Statistikat e Arsimit Parauniversitar. Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosove 2020/2021

	Numri i Institucioneve	Nxënës			Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli ndimës
	Publik			Privat	Publik		
Parashkollor/ qerdhe	15	<5 vjec	1793	3103	295	479	1004
		5<6 vjec	6961	1340			
Fillor dhe i mesëm i ulët	232	72563		3386	4732		
I mesëm i Lartë	31	22338		2324	1458		

Një nga faktorët me rëndësi në përcaktimin e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar rajonal është edhe analiza e të dhënave për nivelin e shkollimit të popullatës. Struktura arsimore paraqet një bazë të rëndësishme të resurseve humane me ndikim në zhvillimin socio-ekonomik. Në këtë pjesë është analizuar numri i popullsisë mbi 10 vjeç sipas nivelit të shkollimit. Të dhënat e ofruara në tabelen 3 si më poshtë janë të dhëna janë marrë nga regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Poashtu këto të dhëna mund edhe të rifreskohen me regjistrimin e ri të popullsisë që pritet të realizohet gjatë këtij viti (2021).

Tabela 3: Niveli i shkollimit në rajonin Qender. Burimi: Agjencioni i Statistikave ë Kosovës, statistikat nga regjistrimi i popullsisë 2011.

Niveli i shkollimit në rajonin Qender	Numri i popullatës sipas nivelit të shkollimit	% popullatës sipas nivelit të shkollimit
Diplomë pasuniversitare	5385	1.2
Te diplomuar	40244	9.1
Arsimi i mesëm i lartë	141275	31.8
Arsimi i mesëm i ulët	117336	26.4
Shkollë fillore	63538	14.4
Pa përfunduar shkollimin fillor	38303	8.6
Dine shkrim lexim	22034	4.9
Nuk dinë shkrim lexim	16269	3.6

3.1.7. Infrastruktura

Pozita gjeografike e Rajonit Zhvillimor Qender në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas. Shtrihen pothuajse të gjitha kategoritë e rrugëve, si dhe ky rajon klasifikohet edhe si qendra e rrjetit hekurudhor të Kosovës, ku degëzohen magjistralet hekurudhore që lidhen rajonet tjera, por edhe ato trase hekurudhore që e lidhin me vendet e Rajonit si me Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Republikën e Serbisë.

Si kategori më e rendësishme e infrastrukturës rrugore është ajo e autoudhëve e cila konsiderohet si nyje e komunikacionit rrugor. Më e rëndësishmja është traseja e autoudhës Prishtinë – Lipjan në drejtim të Shkupit e cila këtë rajon e prekë me gjithësejtë 18 km, pastaj

[5] Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. *Statistikat e arsimit në Kosovë* 2020/21, 2021.

ajo Prishtinë – Trudë (15km) në drejtim të Merdarës. Ndërsa rrugët më të rendësishme Rajonale janë: Arllat – Prishtinë, Prishtinë – Mitrovicë, Prishtinë – Llabjan, Trudë – Merdarë, Komoran – Carralevë dhe Komoran – Skenderaj. Këto kategori të rrugëve janë të punuara me standarde të larta dhe kanë mirëmbajtje të rregullt. Kanë shtrirje prej 174 km në drejtim V-J dhe LP.

Tabela 4: Rrjeti i rrugëve nacionale e Rajonale

Përshkrimi	**km**
Rajonale (Arllat - Prishtinë) drejtimi - Prishtinë	27
Autoudhë (Prishtinë - Trudë) drejtimi - Podujevë	15
Autoudhë (Prishtinë - Lypjan) drejtimi - Shkupit	18
Rajonale (Trudë - Merdarë) drejtimi - Podujevës	40
Rajonale (Prishtinë - Babimoc) drejtimi - Mitrovicë	15
Rajonale (Prishtinë - Llabjan) drejtimi - Gjilanit	30
Rajonale (Komoran - Morinë) drejtimi - Skenderaj	17
Rajonale (Komoran - Petreshticë) drejtimi - Carralevë	12
Gjithsej	**174**

Rrugët lokale kanë përfaqësimin më të madh në raport me infrastrukturën rrugore me rreth 60%, të cilat lidhin vendbanimet e Rajonit. *Rrjeti hekurudhor* është rajonal me stacionin kryesor në Fushë Kosovë. Ka shtrirje në drejtim të Veri-Jug dhe Lindje-Perendim, i cili i lidhe Rajonin qendër me rajonet tjera. Shtrirja e hekurudhës në drejtim Veri-Jug është e karakterit ndërkombëtar, sepse përmes Rajonit verior lidhet me Evropën e mesme dhe atë jugore, kurse përmes Rajonit lindorë lidhet Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë. Kjo linjë hekurudhore është një binarësh me gjatësi prej 188 km. Vetëm komuna e Shtimes si pjesë e këtij Rajoni nuk ka qasje në rrjetin hekurudhor. Gjendja e rrjetit hekurudhor nuk është e mirë dhe investimet për rehabilitimin e tij janë shumë të vogla. Kryesisht janë në nivel të mirëmbajtjes selektive. Përdoret për bartjen e udhëtarëve dhe mallrave.

Me rendësi të veçant për RZhQ është hapësira e aeroportit ndërkombëtar "Adem Jashari" i cili shtrihet në vendbanimin Sllatinë të komunës së FushëKosovës. Distanca nga kryeqyteti është 20 km. Në RZhQ qarkullimi vjetor i udhëtarëve ishte rreth 35000, ndërsa i mallrave ishte rreth 300 mijë/ton. Trendi i përdorimit të hekurudhave për transport të udhëtarëve gjatë vitit 2020 shenon rënje rreth 42%, ndërsa transporti i mallrave për 26%. Linjë funksionale e hekurudhave në këtë rajon është vetem ajo e drejtimit të Shkupit. Sistemi i ujësiellsit dhe kanalizimeve – Numri i vendbanimeve të përfshira ne sistemin e ujit të pishëm për këtë rajon arrin rreth 70%, në sistemin për trajtim e ujërave të zeza është rreth 25%.

Sa i përket infrastrukturës së rrugëve lokale pasisja me ndriqim e tyre, përfshirja në sistemin e ujit te pijshëm dhe kalanizimit informatat e hollësioshme janë të ofmruara në Tabelalen 5 në vijim.

Tabela 5: Vlerësimi i përformacës komunale. Të dhënat nga tabela e vlerësimit për vitin 2019.

Komuna	Rruget lokale të shtruara ne komuna ne %	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore	Ekonomitë familjare, instuticionet publike dhe njësitë biznesore	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik %

		të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	të përfshira në sistemin e kanalizimit në %	
Prishtinë	50.24	91,00	0,00	29.14
Podujevë	71.96	58,15	78,48	7.91
Lipjan	53.19	40,28	97,35	17.43
Obiliq	51.26	93,84	82,89	38.04
Drenas	74.47	63,68	77,00	8.55
Shtime	86.50	67,00	64,69	24.42
Fushë Kosovë	100	96.83	98,80	74.61
Graçanicë	51.35	43,50	64,29	40.94

3.1.8. Ekonomia dhe zhvillimi i biznesit

Profilet e bizneseve me të theksuara në Rajonin Zhvillimor Qendër janë ato të bizneseve individuale duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe ortakëritë e përgjithshme. Sektorët me të zhvilluar janë tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërtimi, dhe shërbimet. Rajoni Zhvillimor Qendër e ka numrin më të madh të koncentrimit të bizneseve për arsye se në këtë rajon është kryeqyteti i Kosovës dhe shumica e bizneseve vendore dhe të huaja janë të përqendruara në kryeqendër. Në Rajonin Zhvillimor Qendër janë të regjistruara 68,133 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; biznese individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri te përgjithshme, shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin qendër me një numër prej 45,626 duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 17,667 dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 1,822 biznese.[6]

Figura 1: Kategorizimi i bizneseve në Rajonin Zhvillimor Qendër



Komuna me numrin më të madh të bizneseve është Prishtina (65%), pasuar nga Lipjani (12%), Obiliqi (8%), Podujeva (7%), Drenasi (3%), ndërsa numrin më të vogël të bizneseve të regjistuara në këtë rajon e kanë komuna e Shtimës, Fushë Kosovës dhe Gaqanicës me nga 2%.

Tabela 6: Numri i bizneseve sipas komunave

Rajoni Zhvillimor Qendër

[6] Të dhënat sipas ARBK-së për numrin e bizneseve në vitin 2018.

Nr.	**Komunat**	**Nr. Bizneseve**	**%**
1	Prishtinë	43977	65
2	Podujevë	4878	7
3	Lipjan	8410	12
4	Obiliq	5110	8
5	Drenas	1907	3
6	Shtime	1132	2
7	Fushë Kosovë	1074	2
8	Graçanicë	1645	2
	Gjithsej	68133	100

Zonat ekonomike/biznesore në këtë rajon janë: Parku i Biznesit në Drenas i cili është shpall zonë ekonomike me vendim të Qeverisë së Kosovës me datë 18.08.2010. Parku shtrihet në kilometrin e 22-të përgjat magjistrales Prishtinë – Pejë, në fshatin Koreticë e Epërme. Parku ofron një vend ideal me infrastrukturë fizike dhe shërbime kualitative. Ka një sipërfaqe prej 24 ha i cili ofron lokacione të madhësive të ndryshme për biznese, kryesisht për sektorë të prodhimit dhe shërbimeve. Janë të vendosur rreth 41 biznese (Tabela 7). Çdo ngastër ka qasje direkte në rrugët kryesore të Parkut si dhe ka kyçje individuale në rrjetin kryesor të parkut me kanalizim, ujë, telefoni, internet, etj.

Tabela 7: Zonat industriale në Rajonin Zhvillimor Qendër[7]

Lokacioni	Përshkrimi	Dist. nga Prishtina km	Sipërfaqe Ha	Nr. Bizneseve
Korroticë e Epërme, Drenas	Parku i Biznesit	22	24	41
Qylagë, Lypjan	Parku Industrial	27	56	No data
Shtime	Parku Teknologjik	30	10.7	11
Lypjan, afer QMI-së	Zona Ekonomike	13.5	No data	No data
Babush, Ferizaj	Zona Ekonomike	25	No data	No data

Parku Industrial në Qylagë Lipjan është krijuar në vitin 2016, me një sipërfaqe prej 56 ha. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së bashku me komunën e Lipjanit ka filluar investimin në rregullimin e infrastrukturës fizike në këtë zonë ekonomike - faza e parë. Planifikohet që edhe në vitet vijuese MTI të vazhdojë me bashkë investim dhe finalizim të infrastrukturës fizike në mënyrë që të krijojohen kushte më të mira për biznese. Ky park industrial është në fazat fillestare të investimeve infrastrukturore dhe ka një numër të vogël të bizneseve në këtë park industrial. Parku Teknologjik në Shtime është krijuar në vitin 2013, me një sipërfaqe prej 10.70 ha. Parku Teknologjik në Shtime gjendet në kilometrin e dytë në rrugën magjistrale Shtime-Ferizaj (M-25.3). Parku Teknologjik gjendet afër qytetit, pran magjistrales, në një udhëkryq në mes të Shkupit - Prishtinës dhe Tiranës. Ky Park teknologjik ka Infrastrukturën fizike (rrugë, ujësjellës, kanalizim, kanalizim atmosferik, trotuare dhe ndriçim). Në këtë park teknologjik ofrohet lirim nga taksa për leje ndërtimore dhe taksa komunale për aktivitetin afarist, hapësirë në dispozicion varësisht nga kërkesa e bizneseve, janë të vendosura 11 biznese të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznesore. Gjithashtu janë edhe Zona Ekonomike ne Lipjan afër QMI-së, Zona Ekonomike në Babush. Përpos infrastrukturës në disa zona industriale sfidë mbetet edhe tërheqja e investimeve duke pasë parasysh një sërë procedurash për të siguruar një hapësirë në zonat industriale gjë e cila demotivon investitorët potencial. Është e rëndësishme të rishikohen

[7] Informatat e pwrditwsuara nga "*Analiza për funksionimin e zonave ekonomike në Kosovë*" hartuar nga Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale, Ministria e Zhvillimit Rajonal, 2019.

dhe të rivlerësohen politikat, procedurat dhe mbështetja e ofruar për investitorët vendor dhe të huaj duke u bazuar në praktikat më të mira në rajon.

3.1.9. Bujqësia

Rajoni Zhvillimor Qendër ka fond të konsiderueshëm të tokave bujqësore prej 93476 hektar apo 18.25% e totalit të tokave bujqësore në nivel të Kosovës. Në këtë rajon sipërfaqe më të madhe të tokave të shfrytëzuara ka Podujeva (24807 hekta), pastaj Lipjani (18547 ha), Gllogoci (15126 ha), Prishtina (12976 ha), ndërsa më së paku ka Fushëkosova (4714 ha) (Tabela 8).

Tabela 8: Madhësia e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore ne Rajonin qender (Regjistrimi i Bujqësisë 2014)

Përshkrimi	Siperfaqe e shfrytëzuar e tokes bujqësore - Gjithsej	Më shumë se 0 dhe më pak se 0,5	Nga 0,5 deri në më pak se 1	Nga 1 deri në më pak se 2	Nga 2 deri në më pak se 5	Nga 5 deri në më pak se 10	Nga 10 deri në më pak se 20	Nga 20 në më pak se 30	30 e më shumë	Total	%
Njësia matëse	(ha)	(ha)	(ha)	(ha)	(ha)	(ha)	(ha)	(ha)	(ha)	(ha)	
Fushe Kosove	4714	124	237	560	1074	747	711	219	1042	4714	5.04
Gllogoc	15126	385	902	2362	4670	2614	1611	632	1950	15126	16.18
Gracanice	5659	57	191	624	1611	1347	688	264	876	5659	6.05
Lipjan	18547	364	804	1996	4246	3154	2714	1590	3679	18547	19.84
Obiliq	5519	115	217	632	1403	990	726	551	885	5519	5.90
Podujeve	24807	584	1281	2865	6053	4617	3497	1941	3970	24807	26.54
Prishtine	12976	184	388	951	2449	2046	2082	1718	3158	12976	13.88
Shtime	6128	166	339	795	1603	1203	684	454	884	6128	6.56
Total	93476	1980	4360	10785	23109	16717	12714	7369	16443	93476	100.00
%	100.00	2.12	4.66	11.54	24.72	17.88	13.60	7.88	17.59	100.00	

RZhQ karakterizohet edhe me numër të madh të ekonomive bujqësore. Me 63103 (48.29%) ekonomi bujqësore sa ka në total renditet si rajoni më numë më të madh të ekonomive bujqësore në Kosovë. Në këtë rajon komuna e Prishtnës prinë me 35145 EB, ndërsa e dyta është Podujeve me 9123 EB. Komuna me numër më të vogël të ekonomive bujqesore është Fushëkosova me 1760 sosh (Tabela 9).

Tabela 9: Ekonomitë Bujqësore sipas madhësisë së sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore, sipas komunave, Kosovë, (Regjistrimi i Bujqësisë 2014)[8]

	Siperfaqe e shfrytëzuar e tokes bujqësore - Gjithsej		Më shumë se 0 dhe më pak se 0,5 (ha)	Nga 0,5 deri në më pak se 1 (ha)	Nga 1 deri në më pak se 2 (ha)	Nga 2 deri në më pak se 5 (ha)	Nga 5 deri në më pak se 10 (ha)	Nga 10 deri në më pak se 20 (ha)	Nga 20 në më pak se 30 (ha)	30 e më shumë (ha)

8 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__02%20Agriculture__Agricultural%20Household%20Survey/aeb01.px/?rxid=eae1fd74-f027-4e2f-b865-c90c9b58d820

	Nr. EB	%	Nr. EB	Nr. EB	Nr. EB	Nr. EB	Nr. EB	Nr. EB	Nr. EB	Nr. EB
Prishtine	35145	52.89	7718	6446	8125	8232	2804	1104	376	340
Fushe Kosove	1760	2.79	463	350	410	353	108	56	9	11
Gllogoc	6516	10.33	1429	1272	1685	1557	393	120	26	34
Lipjan	6143	9.73	1358	1177	1430	1383	465	198	65	67
Obiliq	1928	3.06	466	314	448	462	145	55	24	14
Podujeve	9123	14.46	2196	1804	2050	1983	679	256	82	73
Shtime	2488	3.94	628	497	573	533	173	48	19	17
Total	63103		14258	11860	14721	14503	4767	1837	601	556
%	100.00		22.59	18.79	23.33	22.98	7.55	2.91	0.95	0.88

Hapsira bujqësore i ekspozohet aktiviteteve sociale-ekonomike në masë të madhe, shpeshherë në mënyrë të pa kontrolluar, ku si pasojë ka degradimin e tokave, dhe shkatërrimin e tyre duke ndryshuar destinimin. Rajoni Zhvillimor Qendër, si në të gjithë Kosovën, i është nënshtruara degradimit të thellë, si pjesë e një procesi të pakontrolluar të ndërtimeve pa leje. Rrjedhimisht kjo ka ndikuar që të kemi humbjen e tokës bujqësore, dhe shënëderrimin e saj në destinime të tjera. Pjesmarrjen më të madhe e kanë arat me rreth 43%, pastaj livadhet dhe kullotat (34.18%), tokat pyjore (13.70%), kulturat shumëvjeqare dhe pemët me nga 1%, tokat bujqësore të pa përdorura me 3.25%, kopshtet 0.23%, ndërsa më të ulten e kanë fidanishtet dhe vreshtat me nga 0.02% (Tabela 10).

Tabela 10: Shfrytëzimi i tokave[9]

Përshkrimi	Toka e punueshme – arat/ha	Kopshte/ha	Livadhet dhe kullotat (përfshirë tokën e përbashkët) /ha	Kulturat shumëvjeçare/ ha	Pemët/ha	Vreshtat/ha	Fidanishtet/ha	Toka bujqësore e papërdorur/ha	Toka pyjore /ha	Toka jobujqësore/h a
Prishtinë	55123	278	48379	1493	1422	35	36	4754	22832	4233
Fushe Kosove	3278	10	1398	28	27	0	0	85	191	255
Gllogoc	8182	62	6692	190	185	0	0	530	4200	769
Gracanice	4990	11	616	42	38	1	3	90	135	258
Obiliq	3414	9	2047	49	49	0	0	190	328	226
Podujeve	12317	82	12087	320	307	0	0	1060	5255	916
Shtime	3686	20	2357	65	65	0	0	138	1566	298
Lipjan	10305	39	8091	112	94	13	5	360	1790	852
Total	95357	510	75732	2299	2186	49	44	7207	30360	7808
%	43.04	0.23	34.18	1.04	0.99	0.02	0.02	3.25	13.70	3.52

Blegtoria si indikator i rendësishëm në zhvillimin ekonomik zë vend të veçant në kategorizimin e RZhQ, prandaj fondi prej 53605 krer gjedhe sa ka gjithësejtë e kategorizon Rajonin si njëri nga më të rendësishmit për zhvillimin e këtij sektori. Nese e vendosim në raport me numrin e gjedheve në nivel vendi, del se rreth 20.8% e numrit total të gjedheve janë nga RZhQ.

Tabela 11: Fondi i blektorisë sipas komunave, Kosovë, 2014

9 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata 02%20Agriculture Agriculture%20census%202014 2%20Land%20Use/Tabela%202_3.px/Tabela/TabelaVieëLayout1/?rxid=dfb5b2e3-9873-45ce-80ef-50cb0eb7a8da

	Gjedhe gjithsej	Buallica	Dele	Dhi	Derra	Kuaj, gomare	Shpeze	Kafshë të tjera	Koshere bletësh	Total	%
Fushë Kosovë	2266	-	1167	28	-	-	35784	-	1540	40785	5.38
Gllogoc	12062	9	5787	1807	-	10	110304	197	3594	133770	17.65
Graçanicë	908	-	851	266	5631	10	39090	176	1375	48307	6.38
Lipjan	9987	-	4414	1085	339	130	100550	-	2940	119445	15.76
Obiliq	2629	-	1189	87	982	21	37563	-	1590	44061	5.81
Podujevë	14624	8	7528	630	-	65	149468	128	5084	177535	23.43
Prishtinë	7266		5733	1275	307	11	95112	142	6535	116381	15.36
Shtime	3863	-	1430	424	-	87	69957	-	1698	77459	10.22
Total	53605	17	28099	5602	7259	334	637828	643	24356	757743	100.00
%	7.07	0.00	3.71	0.74	0.96	0.04	84.17	0.08	3.21	100.00	

3.1.10. Papunësia dhe punësimi

Rajoni Zhvillimor Qendër ka potencialin më të madh ekonomik për ofrimin e vendeve të punës, marrë parasysh koncentrimin e institucioneve shtetërore, përfaqësive dhe organizatave të huaja, si dhe përfaqësitë e kompanive biznesore vendore dhe ndërkombëtare. Megjithatë edhe Rajoni Zhvillimor Qendër ballafaqohet me papunësinë. Sipas të dhënave nga Agjensioni i Punësimit, raporti 2020, numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në Rajonin Zhvillimor Qendër është 45095 ndërsa oferta e punës 2320 pra këtu shihet një raport dhe diferencë e madhe e ofertës dhe kërkesës për punë, edhe pse duhet pasë parasysh faktin se këto të dhëna nuk pasqyrojnë realitetin në terren, pjesa më e madhe e fuqisë punëtore nuk drejtohen të zyrat e punësimit për regjistrim.

Grafiku 2. Papunësia sipas komunave në Rajonin Zhvillimor Qender, Burimi Agjencioni për Punësim i Republikës së Kosovës. Raporti 2021



Norma mesatare e papunësisë: Sipas Anketës së fuqisë punëtore ka të dhëna për papunësinë sipas moshës, arsimit, kohëzgjatjes, metodave të kërkimit, përvojës së mëparshme të punës, aktivitetit ekonomik, profesionit, pastaj të dhëna për popullsinë joaktive sipas moshës dhe arsimimit, mirëpo këto të dhëna janë vetëm në nivel të përgjithshëm, prandaj të dhënat për nivelin e papunësinë ne nivel lokal dhe rajonal nuk mund të gjenerohen. Mungesa e të dhënave

zyrtare për normën mesatare të papunësisë, në nivel lokal dhe rajonal, e gjithashtu edhe statistikat lokale dhe rajonale për GDP-në te cilat janë tregues esencialë për llogaritjen e nivelit të zhvillimit rajonal dhe disbalancit në mes të rajoneve është sfide e cila duhet të adresohet në të ardhmen.[10]

3.1.11. Burimet natyrore

Rajoni zhvillimor qendër është i pasur me burime natyrore liqeje dhe lumenj. Liqejtë kryesorë artificialë në rajonin zhvillimor qendër janë Liqeni i Batllavës (Podujevë) me madhësi 3.27 km2 dhe Liqeni i Badovcit (Prishtinë) 2.57 km2. Këta dy liqene përdoren kryesisht për ujë të pijshëm, por edhe për ujitje. Rajoni zhvillimor qendër është i pasur me resurse minerale, veçanërisht me linjit dhe feronikel, por ka edhe rezerva të plumbit, zinkut, etj. Ekzistimi i resurseve minerale paraqet një mundësi të mirë për zhvillimin e industrisë minerale dhe energjetike. Komuna e Obiliqit njihet të jetë e pasur me resurse natyrore të cilat edhe e bëjnë të jetë zonë e favorshme ekonomike, resurset e mëdha të qymyrit eksploatohen dhe përdoren për prodhimin e energjisë elektrike në termocentralet e Kosovës A dhe B. Në komunën e Podujevës ekziston edhe një miniere e ajo është miniera e Drazhnjës e cila gjendët në fshatin Herticë. Kjo miniere është e pasur me plumb, argjend, ari e zink. Në minierën e nikelit „Çikatovë e Vjetër“ ekzistojnë dy vendburime (trupa mineral): „Dushkaja“ dhe „Suka“. Rezervat gjeologjike në dy minierat (Gllavicë dhe Çikatovë) janë vlerësuar të jenë rreth 13 Mt me përbërje mesatare të nikelit 1.31% dhe të kobaltit 0.06%.17. [11]

3.1.12. Turizmi

Në Rajonin Zhvillimor Qendër më së shumti janë të zhvilluara turizmi urban dhe kulturor kjo për shkak se në këtë rajon është kryeqyteti dhe tërheqë vizitorë nga vende të ndryshme. Muzeu Etnologjik, kompleksi i banimit "Emin Gjiku" gjendet në bërthamën e vjetër të qytetit të Prishtinës, monumenti i Neëborn-it dhe ideja e ngjyrosjes çdo 17 shkurt, bënë që për çdo vit ky monument të jetë atraksion për turistët, të cilët e vlerësojnë idenë e ndërrimit të ngjyrave të këtij objekti. Muzeu i Kosovës i cili përmban më shumë se 50,000 eksponate të ndryshme është themeluar në vitin 1949-të, ndërsa ndërtesa e tij me stil të arkitekturës austro- hungareze daton që nga viti 1989, Galeria e Arteve te Kosovës. Prishtina ka mbi 30 pika të tjera turistike. Komuna e Podujevës ka hapësira të përshtatshme për turizëm. Liqeni i Batllavës është atraksion për vizitorë. 66 % e territorit të Komunës së Podujevës e përfshijnë malet ku paraqesin një atraksion tjetër për t'u vizituar dhe i përshtatshëm për alpinizëm. Ulpiana është një monument i trashëgimisë kulturore me vlera të mëdha historike në afërsi të Graçanicës, një qytet i themeluar në fillim të shekullit II. Gërmimet arkeologjike kanë dhënë gjurmë të jetës para romake dhe dëshmojnë se Ulpiana është një vazhdimësi e një vendbanimi ilir dhe se kulmin e zhvillimit ekonomik e kulturor ky qytet e kishte arritur në fund të shek. III dhe fillim të shek. IV. Të gjitha këto e bëjnë Ulpianën një nga pikat turistike më të preferuara në Kosovë. Në këtë rajon ka edhe pika të tjera turistike të trashëgimisë kulturore fetare si xhamia dhe kisha të ndryshme.[12]

3.1.13. Qyteti i Prishtinës Qendër Reprezentative dhe Rajonale e Kosovës

Qyteti i Prishtinës është ndër qendrat urbane më e vjetra dhe kryeqytet i Republikës së Kosovës. Shtrihet në luginat e lumenjëve Prishtevkë dhe Velllusha, në zonën në mes të fushëgropës së Kosovës dhe masivit të Gollakut. Qyteti është zhvilluar në udhëkryqin e rrugëve nacionale dhe

[10] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020-2030*, Prishtinë 2020.
[11] Po aty.
[12] Po aty.

ndërkombëtare të cilat e lidhin me shtetet fqinje dhe brendësinë e Gadishullit Ballkani. Në drejtimin verior, përmes Mitrovicës dhe magjistralës së Ibrit lidhet me pjesën qendrore të Evropës qendrore dhe jugore, përmes Autostradës "Arbër Xhaferi" merr drejtimin jugor të komunikimit me Shkupin dhe Selanikun, kah përendimi drejt Pejës lidhet me Malin e Zi dhe krijon qasje në Detin Adriatik, ndërsa pas ndërtimit të Autostradës "Ibrahim Rugova" lidhet me Shqipërinë dhe Malin e Zi, duke krijuar qasje dydrejtimshe në Detin Adriatik. Pozita e mirë gjeografike i ka mundësuar që të ketë funksion të rendësishëm tregëtar, zejtar, politik, administrativ, edukative-arsimor, kulturorë e reprezentativ. Përqendrimi i pothuajse të gjitha funksioneve administrative-politike, kulturore-arsimore e shendetësore, sociale-ekonomike e reprezentative, e shnëderrojnë Prishtinën në qendër reprezentative jo vetëm të këtij Rajoni por të tërë Republikës së Kosovës. Zhvillimi i qytetit është i lidhur me funksionet të cilat i ka ushtruar në të kaluarën dhe sot. Si qendër urbane i ka të zhvilluara të gjitha funksionet terciare e kuaternare të shkallës më të lartë. Ka Selinë e Akademisës së Shkencës dhe Arteve; është qendër Universitare me fakultete, shkolla të mesme, fillore e ato të arsimit parafillor. Ka parlamentin, qeverinë e selitë e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare e diplomatike, arkivin, Muzeun e bibloteken kombëtare, Qendrën Klinike Universitare, bankën qendrore dhe një numër të të madh të bankave komerciale e mikrofinanciare; agjencinë e statistikave, kadastrit, mjedisit, minierave e mineraleve, etj,. Zejtaria e llojllojshme, tregëtia e specializuar, rrjeti i konsoliduar i gastronomisë, dhe komunikacioni i dendur i kanë dhënë ritmin dhe dinamiken e qendrës urbane me kompetenca të larta funksionale, e cila po ecën drejt fazës së shnëderrimit në zonë Metropolitane.

Prishtina në fillim të shekullit XX ka pasur 12000 banorë (v.1901), ndërsa me regjistrimin e popullsisë ne vitin 1981 del se rritet rreth 9 herë (109208 banorë). Në vitin 2011 pa pasur 211755 banorë apo rreth 11 herë më shumë. Ndërsa sipas vlersimit të popullsisë (v. 2020) ajo ka 218.782 banorë.

3. 2. Rajoni Zhvillimor Lindje

Rajoni Zhvillimor Lindje paraqitet si individualitet gjeografik jo vetëm për pozitën jugore, por edhe për morfologjinë, morfotektonikën, ndërtimin gjeologjik dhe elementet e larmishme klimatike që mbizotrojnë në këtë rajon. Nga aspekti administrativ, në pjesën veri-lindore kufizohet më RZhQ, ndërsa në pjesën jug-lindore mbyllet me kufirin e republikës së Maqedonisë së Veriut. Nga aspekti gjeografik kufiri me Maqedoninë është më tepër natyror dhe e përcaktojnë Malet e Sharrit dhe kompleksi malor i Karadakut. Për dallim nga RZhQ që shtrihej në drejtim Veri-Jug, RZhL ka shtrirje më tepër lindje-përendim e cila nga skaji më përendimor i komunës së Shtërpcës deri tek skajim më lindor i komunës së Kamenicës mbrrinë gjatësi deri në 90 km. Pozita gjeografike, konfiguracioni i terrenit kryesisht kodrinoro-malor (përjashtuar luginën e lumit Morava me reliev më të butë) dhe predispozita natyrore e Moravës i bënë të mundur lidhjen e mirë me Kosovën Lindore (luginën e Preshevës). Ndërsa me pjesën qendrore e përendimore lidhet përmes Grykës së Kaqanikut, Luginës së Lumit Lepenc dhe FushëKosovës që sot mundësohet nga shtrirja e Autostradës "Arbër Xhaferi" dhe del në autostradën Ibrahim Rugova. Në të njëjten vijë kalon edhe vija hekurudhore e cila Rajonit i jep veçoritë e një hapësire komunikative dhe funksionale.



Harta 3. Rajoni Zhvillimor Lindje

Rajoni Zhvillimor Lindje përbëhet nga 293 vendbanime të shprendara në gjithësejtë 11 komuna administrative me sipërfaqe prej 2298.5 km2 apo 21.08 % e territorit të Kosovës. Komuna me sipërfaqen më të madhe është Kamenica (416.61 km2), Gjilani ka sipërfaqe prej 391.84 km2 dhe Ferizaj si qendër ekonomike më e madhe e rajonit radhitet e treta me 344.51km2, ndërsa komuna me sipërfaqen më të vogël është Kllokoti me 23.39km2.

3.2.1. Popullsia

Rajoni Zhvillimor Lindje diferencohet me popullsisë më të vogël së Rajoni Zhvillimor Qendër dhe është e lidhur ngushtë me relievin si faktor natyror, ku në pjesët më të larta shtrihen pyjet dhe kullotat ndësa në pjesët e ulëta sipërfaqet e hapura agrare në të cilat është i koncentrua edhe numri më i madh i popullsisë. Karakteristikë tjetër e këtij rajoni janë proceset sociale-ekonomike, të lidhura me zhvillimin dinamik të popullsisë, i cili konsiderohet të jetë mjaft i lartë. Kjo hapësirë gjeografike, dallohet për kah dendësia e madhe e popullsisë prej 120 banorë në km2, apo pak më e vogël se dendësia mesatare e Kosovës, dhe afërsisht një herë më e vogël se dendësia mesatare e RZhQ. Popullsia prej 325,971 banorëve (18% e popullsisë së Kosovës), apo rreth 200,000 banorë më pak se RZhQ, e kategorizon hapësirën gjeografike si rajonin e

tretë për nga koncentrimi i popullsisë. Ky numër më i vogël i popullsisë në krahasim me Rajonin qendër mund të shpjegohet me shkallën e ulët të zhvillimit ekonomik. Komuna me numër më të madh të popullsisë është Ferizaji (106.286 banorë), e dyta renditet Gjilani me 77.145 banorë, pastaj Vitia me 47.896 banorë, Kaqaniku (34.672 banorë), ndërsa komunat e tjera si pjesë e këtij rajoni kanë popullsi të vogël (nën 10000 banorë). Me numrin më të vogël të popullsisë është Parteshi (1.699 banorë). Dendësinë më të madhe të popullsisë e ka Ferizaj (308 b/km2), pastaj Gjilani (197 b/km2), ndërsa me dendësi më të vogël është Shtërpca me 27 banorë/km2. Aktivitetet administrative dhe sociale-ekonomike janë vetëm të nivelit lokal. Funksionet administrative, ekonomike, edukativo-arsimor në të gjitha nivelet, ndihmojnë që rajoni të ketë potencial të madh në zhvillimin ekonomik, dhe ofertë të mirë për vendeve të punës.

Tabela 12: Popullsia dhe sipërfaqja në Rajonin Zhvillimor Lindje. Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021. Vlerësimi për popullsinë për vitin 2020.

Rajoni zhvillimor Lindje				
	Komunat	**Popullsia**	**Sipërfaqja km²**	**Dendesia e pop.**
1	Gjilan	77.145	391.84	197
2	Ferizaj	106.286	344.61	308
3	Viti	47.896	269.69	177
4	Kamenicë	27.948	416.61	67
5	Novobërdë	7.158	203.98	35
6	Kaçanik	34.672	211.28	164
7	Hani i Elezit	10.090	83.11	121
8	Shtërpcë	6.621	247.7	27
9	Ranillug	3.737	77.62	48
10	Kllokot	2.719	23.39	116
11	Partesh	1.699	28.67	59
	Gjithsej	**325971**	**2298.5**	141.8

3.2.2. Relievi dhe ndërtimi gjeologjik

Në morfologjinë e relievit të Rajonit Zhvillimor Lindje pjesmarrje më të madhe kanë format kodrinore-malore me lartësi në mes 500 deri 1000m mbi nivelin e detit. *Zona e Gollakut* shtrihet në veri, Karadaku i Shkupit në jug, dhe pjesa e ulët e luginës së Moravës së Binçes në mes tyre, me lartësi mbidetare në mes 600 dhe 700m. Në anën tjetër RZhL është i hapur me Fushën e Kosovës, ndërsa në pjesën jugore e mbyllë mali i Sharrit, ndërsa prej rrafshit të Dukagjinit e ndanë Mali i Nerodimës. Gollaku zë pjesën veriore të Rajonit, dhe në strukturën e releiveit dallohet me majen e Zhegovcit (1070m), Velegllava (1181m), Kitka (1154m), dhe Rrafshi (1163m). Në mes të këtyre pikave të larta, relievi fillon të bie në drejtim të Moravës së Binçes, ku distanca në mes të tyre dhe luginave të lumenjëve ndahet më distancë vertikale prej 600-700m. Karakteistikë e veçantë e Rajonit janë edhe format e shumta të erozionit në pjesën e epërme dhe të sedimentit të tyre në pjesën e ulët të fushës. *Karadaku i Shkupit* karakterizohet me të gjitha tiparet e relievit kodrionoro-malor dhe shtrihet në mes të luginës së Moravës së Bnçës, në veri, dhe Moravicës në jug. Pjesa më e madhe e tij shtrihet në Maqedoninë e Veriut, ndësa vetëm një pjesë e vogël e prekë këtë Rajonin lindor. Ai shtrihet në një zonë të ngushtë në mes të Grykës së Kaqanikut në lumin Lepencë deri tek Gryka e Konçulit në Moravë, me gjatësi prej 48km. Pikat më të larta të kësaj hapësire janë: Maja Kopilaça (1490 m), Cërrni Vërr (1219m), Topan (1178m), etj. Në aspektin gjeologjik përfaqësohet kryesisht me shkëmbinjë të

Gnejsit të moshës parakembriane. Paleozoiku poashtu ka një shtrirje mjaft të madhe dhe përfaqësohet nga filitet, rreshpet sercite dhe graniti. Zona e ulët e Fushës së Moravës paraqitet si element tjetër në fizionominë e relievit të këtij Rajoni dhe shtrihet në mes 450 dhe 500 m të lartësisë mbidetare. Në pjesën e ulët të fushës së Moravës mbizotrojnë sedimentet e reja dhe sedimentet liqenore të neogjenit. Në një zonë të ngushtë rreth luginës së Moravës janë të pranishme konglomeratet, rëra dhe zalli i plesitocenit.

3.2.3. Klima

Për shkak të pozitës gjeogafike dhe orografisë së relievit, të rrethuar nga malet në pjesën jugore e veri-lindore, si dhe luginës së lumit Lepenc e cila hapet në drejtim të Fushës së Kosovës Rajoni lindor difeencohet prej Rajonit qendror. Klima është e ndryshueshme kontinentale, por në pjesët malore ka elementet e veta dhe karakterizohet si klimë e ndryshueshme malore, ku vera është ngrohtë dhe dimri i ftohtë. Temperatura mesatare brenda vitit luhatet nga +21 °C (korrik - verë) në –2.1°C (janar - dimër)13. Kjo zonë është e karakterizuar nga një klime e thatë dhe reshje vjetore afërsisht 590 mm në vit. Ndryshimet e vogla të temperaturave mesatare mujore, vjetore dhe ampliturdat e tyre në qytetet kyesore të Rajonit (Gjilan, Ferizaj, Kamenicë e Shterbcë), janë më tepër si pasoj e pozitës së tyre gjeografike. Temperatura më të larta mesatare vjetore ka Gjilani (10.4), ndërsa më të vogël Ferizaj (10.2), kjo si pasojë e relievit më të ngritur që e pengon depetimin e erërave veriore. Deficiti i reshjeve është veçori tjetër e këtij Rajoni. Sasia e reshjeve nga pjesa fushore në drejtim të viseve malore shkon duke u rritur. Derisa në pjesën e Gjilani sasia e reshjeve është në vlera minimale (580mm), Ferizaj (673mm), në drejtim të Kamenicës ajo shenon rritje të lehtë në 590mm, ndërsa në drejtim të Karadakut të Shkupit ato rriten për rreth 1.4 herë, përkatësisht në 830mm dhe në pjesët malore të Sharrit (rreth 1020mm).

3.2.4. Ujërat

Predispozitat relievore dhe hidrografike janë dy elementet qenësore gjeografike në përcaktimin e këtij Rajoni. Kjo hapësirë dallohet me pjesën e epërme të pellgut të Moravës dhe degëve të saj, i cili përfshinë sipërfaqe prej 1156km2. Kështu përcaktohet si elementi kryesor gjeogafik i pjesës së mesme të Rajonit, pëkatësisht komunës së Gjilanit. Për dallim nga pjesa qendrore dhe VP e Rajonit e cila diferencohet me deficit të ujrave sipërfaqësore, pjesa jugore e Rajonit lindor është me e pasur me rrjedha ujore. Lepenci është rrjedha kryesore e kësaj hapësire gjeografike, dhe i vetmi lumë në Kosovë që i takon pellgut të Detit Egje. Buron në Oshlak (2212m) në Malet e Sharrit. Dega kryesore e Lepencit është Nerodimja e cila dallohet jo vetëm për kah gjatësia (41 km) por edhe për kah prurjet e mëdha. Pëveç tjera rendësia e ujrave të pjesës jugore të rajonit mund të shikohet edhe nga këndi energjetik dhe ujitjen e tokave. Potenciali energjetik i Lepencit në prujet mesatare llogaritet në 23 MË, dhe mund të shfrytëzohet në Grykën e Kaçanikut. Por kjo tashmë është e pa mundur sepse një pjesë e konsiderueshme përgjatë shtratit të lumit Lepenc është ndërtuar autoudha Arbër Xhaferi, si dhe është e vendosur traseja e hekurudhës Prishtinë-Shkup. Prandaj rendësia më e madhe e ujrave të këtij Rajoni është përqendruar në ujitjen e tokave. Ndërtimi i sistemit akumulues të Firajës në Lepenc, Rajoni ka hyrë në rrjetin e sistemit Ibër-Lepenc për ujitjen e tokave në Fushën e Kosovës.

3.2.5. Tokat dhe Vegjetacioni

Përdorimi i tokave në pjesën qendrore dhe Veri-Perëndim të rajonit diferencohen me pedologji homogjene në një kategori dhe njësi të vogla kategorizimi. Mbizotrojnë tokat ngjyrë kafe të

13 Vjetari Hidrometeorologjik i Kosovës, 2019

lesivuara dhe toka ngjyrë kafe në gelqerorë dhe dolomite, e më pak toka fluviale dhe smonica. Të gjitha këto i takojnë tokave pjellore dhe më pak pjellore. Ndërsa në jug-perendim kryesisht pjesën malore shtrihen tokat skeletore ngjyrë gështenje në rrespe kristaline. Këto formacione dhe tokat e tipit ngjyrë gështenje përfshinë pjesët e malit Sharr dhe Koxha Ballkanin. Në pjesën e ulët të Fushës së Kosovës shtrirje të madhe kanë tokat aluviale dhe smonica. *Pyjet*, në kategoritë e tokave të pa përpunuara pyjet me 42.2% janë elemente diferencuese të pjesës qendrore, veri-lindje dhe jugore të Rajonit. Sipërfaqet me pyje kanë shtrirje më të madhe në Karadakun e Shkupit. Janë pyje me zhvillim mesatar dhe të tipit të shkurreve. Prej llojeve të tyre mbizotrojnë valanidhi, shpardhi dhe qarri, ndërsa me pak shfaqet cirona. Kullotat shtrihen në 14.1% të sipërfaqeve apo tri herë më të vogla se pyjet. Ato gjenden në pjesët më të larta të relievit. Së bashku me livadhet zënë rreth 18% të sipërfaqës së kësaj hapësire gjeografike dhe bëjnë bazën kryesore ushqyese të blegtorisë. Ndërsa në hapësiren e pellgut të Lepencit shtrihet një brez relativisht i gjërë i pyjeve. Konsiderohet se pyjet dhe shkurret mbulojnë rreth 47% të këtij pellgu. Më pak sipërfaqe janë me kullota dhe livadhe me rreth 28% të sipëfaqeve. Shumë më pak hasen arat dhe kopshtet. Afërsisht gjysma e pjesës së epërme të Lepencit është me pyje halore, ndërsa pjesa tjetër me kullota dhe tokë joproduktive. Në lartësi mes 1500 – 1600 të lartësisë mbi nivelin e detit shtrihen pishat, ndërsa në pjesët e tjera hasen shkurret dhe pyjet e ahut.

3.2.6. Arsimi

Infrastruktura dhe cilësia e shërbimeve arsimore në Rajonin Zhvillimor Lindje është në nivel mjaft të mirë. Janë ndërtuar dhe riparuar një numër i madh i institucioneve shkollore dhe universitare. Sipas statistikave të arsimit publik 2020-2021 numri i shkollave në Rajonin Zhvillimor Lindje në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 170, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 28. Numri i nxënësve në RZHL në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 40,790. Numri i nxënësve ne arsimin e mesëm të lartë është 15,105 nga ta 7486 ose 49.56% janë në shkollat profesionale.

Tabela 13: Statistikat e arsimit parauniversitar në Rajonin Zhvillimor Lindje. Burimi: Statistikat e arsimit në Kosove 2020/2021

	Numri i Institucioneve	Nxënës			Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli ndimës
	Publik			Privat	Publik		
Parashkollor/ qerdhe	9	0<5 vjec	697	696	96	334	441
		5<6 vjec	3935	215			
Fillor dhe i mesëm i ulët	170	40790		602	3606		
I mesëm i lartë	28	15105		158	1044		

Një nga faktorët me rëndësi në përcaktimin e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar rajonal është edhe analiza e të dhënave për nivelin e shkollimit të popullatës. Struktura arsimore paraqet një bazë të rëndësishme të resurseve humane me ndikim në zhvillimin socio-ekonomik. Në këtë pjesë është analizuar numri i popullsisë mbi 10 vjeç sipas nivelit të shkollimit. Të dhënat e ofruara në Tabelen 14 si më poshtë janë të dhëna janë marrë nga regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Tabela 14: Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Lindje. Regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës

Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Lindje	Numri i popullatës sipas nivelit të shkollimit	% popullatës sipas nivelit të shkollimit
Diplomë pasuniversitare	1210	0.9
Te diplomuar	19059	6
Arsimi i mesëm i lartë	91808	29.1
Arsimi i mesëm i ulët	96589	30.5
Shkollë fillore	49234	15.5
Pa përfunduar shkollimin fillor	28747	9.1
Dine shkrim lexim	16781	5.2
Nuk dinë shkrim lexim	11966	3.7

3.2.7. Infrastruktura

Pozita gjeografike e Rajonit Zhvillimor Lindje në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas. Shtrihen pothuajse të gjitha kategoritë e rrugëve. Gjithashtu në pjesën qendrore dhe jug-perëndim të Rajonit shtrihet e ashtuquajtua magjistralja hekurudhore e Adriatikut. Si kategori më e rendësishme e infrastrukturës rrugore është ajo e autoudhëve e cila konsiderohet si nyje e komunikacionit rrugor. Me e rendësishmja është traseja e autoudhës (Prishtinë – Lipjan – Han i Elezit) në drejtim të Shkupit e cila këtë rajon e prek me gjithësejt 40 km, pastaj rruga Rajonale Prishtinë - Llabjan - Gjilan – Konçul, drejtimi - Bujanovcit (43km), rruga Rajonale Gjilan – Muqibabë (15.5km) drejtimi i Preshevës, rruga Rajonale Gjilan - Kamenicë (27km), rruga Rajonale Rajonale Gjilan – Feizaj (34km), rruga Rajonale Doganaj – Glloboqicë (23km) dhe rruga Rajonale Viti – Ferizaj (21.6km) (Tabela 15).

Tabela 15: Rrjeti i rrugëve nacionale e Rajonale në Rajonin Zhvillimor Lindje

Përshkrimi	**km**
Autoudhë (Lypjan Han i Elezit) drejtimi - Shkupit	40
Rajonale (Llabjan - Gjilan - Konçul) drejtimi - Bujanovcit	43
Rajonale (Gjilan - Muqibabë) drejtimi - Preshevës	15.5
Rajonale (Gjilan - Kamenicë)	27
Rajonale (Gjilan - Feizaj)	34
Rajonale (Doganaj - Glloboqicë)	23
Rajonale Viti - Feizaj)	21.6
Gjithsej	**182.5**

Rrugët lokale kanë përfaqësimin me të madh në raport me infrastrukturën rrugore me rreth 60%, të cilat lidhin vendbanimet e Rajonit. Rrjeti hekurudhor është i karakterit ndërkombëtar, i cili i lidhe Rajonin qendër me rajonet tjera. Shtrirja e hekurudhës në drejtim veri-jug është e karakterit ndërkombëtar, sepse përmes Rajonit verior lidhet me Evropën e mesme, ndërsa përmes Rajonit lindorë lidhet Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë. Kjo linjë hekurudhore është një binarësh, dhe Rajonin e përshkon me gjatësi prej 40 km. Gjendja e rrjetit hekurudhor nuk është e mirë dhe investimet për rehabilitimin e tij janë shumë të vogla. Kryesisht janë në nivel të mirëmbajtjes selektive. Përdoret për bartjen e udhëtarëve dhe mallrave.

Informatat për rrugët lokale, pasisja me ndriqim e tyre, përfshirja në sistemin e ujit te pijshëm dhe kalanizimit informatat e hollësioshme janë të ofmruara në Tabelalen 16 në vijim.

Tabela 16: Statistikat e infrastrukturës për Rajonin Zhvillimor Lindje sipas Komunave. Burimi: Sistemi i Menaxhimit të përFomrancës së Komunave. Tabela për vitin 2019.

Komuna	Rruget lokale të shtruara ne komuna ne %	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Ekonomitë familjare, instuticionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit në %	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik %
Gjilan	72,00	99,22	76,57	47,10
Ferizaj	74,25	94,99	92,37	52,97
Viti	77,66	53,29	54,12	52,64
Kamenicë	52,45	45,16	28,07	17,18
Novobërdë	54,23	68,86	86,11	8,52
Kaçanik	81,57	69,48	69,48	13,45
Hani i Elezit	100,00	91,09	93,55	90,37
Shtërpcë	92,37	100,00	97,79	55,56
Ranillug	73,52	100,00	76,78	40,71
Kllokot	93,39	0,00	93,33	90,00
Partesh	56,72	29,12	29,12	85,65

3.2.8. Ekonomia dhe zhvillimi i biznesit

Aktivitetet ekonomike të shprendara në rajonin Lindje janë kryesisht bizneset individuale, por kemi numër të konsiderueshëm edhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e ortakëri të përgjithshme. Sektorët më të zhvilluar janë tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërtimi, dhe shërbimet. Rajoni Zhvillimor Lindje radhitet i dyti për nga koncentrimi i bizneseve për arsye se në këtë rajon bejnë pjesë dy qendrat e mëdha të Kosovës. Në Rajonin Zhvillimor Lindje janë të regjistruara 18.24% e bizneseve të regjistruara në Kosovë.

Figura 2: Aktivitetet ekonomike në Rajonin Zhvillimor Lindje



Komuna me numrin më të madh të bizneseve është Ferizaj (36.22%), pasuar nga Gjilani (29.76%), Vitia (11.89%), Kaçaniku (8.92%), Kamenica (8.54%), ndërsa numrin më të vogël të bizneseve të regjistuara në këtë rajon e kanë komuna e Shtërpcës (2.47%), Novobërda (1.07 %) dhe Ranillugu me (0.82%) (Figura 2).[14]

3.2.9. Bujqësia

Shfrytëzimi i Tokës - si indikator i rendësishëm në zhvillimin ekonomik, ka rendësi të madhe për vlerësimin e mundësive të zhvillimit të degës së bujqësisë. Rajoni Zhvillimor Lindje ka fond të konsiderueshëm të tokave bujqësore prej 214,094 hektarë apo 14.05% e totalit të tokave bujqësore në nivel të Kosovës. Në këtë rajon sipërfaqe më të madhe të tokave të shfrytëzuara ka Gjilani (36.5%), pastaj Ferizaj (32.95%), Vitia (8.46%), Kamenica (8.45%), ndërsa më së paku kanë Novobërda, Hani i Elezit, Shtërrbca, Ranillugu, Parteshi e Kllokote me më pak se 5% të sipërfaqeve.

Tabela 17: Madhësia e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore ne RZhL (burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, regjistrimi i bujqësisë 2014)

Komuna	Nr. ekonomive bujqësore	%	Siperfaqja (ha)	%
Novoberde	1267	2.22	6441	3.00
FERIZAJ	22180	38.94	70544	32.95
Hani i Elezit	656	1.15	2582	1.20
Kacanik	2908	5.11	10157	4.74
Shterpce	1355	2.38	4806	2.24
GJILAN	18663	32.77	78281	36.5
Kamenice	3069	5.39	18110	8.45
Kllokot	511	0.9	1567	0.73
Partesh	505	0.89	1129	0.52
Ranillug	826	1.45	2345	1.09
Viti	5014	8.8	18132	8.46
Total	56954	100	214094	100.0

Rajoni Zhvillimor Lindje karakterizohet edhe me numër të madh të ekonomive bujqësore. Me 56,954 ekonomi bujqësore sa ka në total, renditet si rajoni i dytë më numër më të madh të ekonomive bujqësore në Kosovë. Në këtë rajon komuna e Ferizajit prin me 38.94%, ndërsa e dyta është Gjilani me 32.77%. Komuna e tjera janë me numër më të vogël të ekonomive bujqësore me më pak se 5.5% (Tabela 17).

Blegtoria si indikator i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik zë vend të veçantë në kategorizimin e RZhL, prandaj fondi prej 45,092 krerë gjedhe sa ka gjithësejt e kategorizon Rajonin si njëri nga më të rendësishmit për zhvillimin e këtij sektori. Nëse e vendosim në raport me numrin e gjedheve në nivel vendi, del se rreth 17.66% e numrit total të gjedheve janë nga RZhL (Tablela 17).

Tabela 18: Numri i blegtorisë në Rajonin Zhvillimor Lindje sipas komunave (Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, regjistrimi i bujqësisë 2014)

Komunat	**Gjedhe**	%	**Buallica**	**Dele**	**Dhi**	**Derra**	**Kuaj, gomare**	**Shpeze**	**Kafshë të tjera**	**Koshere bletësh**

[14] Të dhënat sipas ARBK-së për numrin e bizneseve në vitin 2018.

							dhe mushka			
Ferizaj	9762	21.65	11	11403	637	-	169	160867	134	4941
Gjilan	7148	15.85	k	9340	2225	1389	73	234579	239	3490
Hani i Elezit	1374	3.05	-	896	157	-	85	4377	-	725
Kaçanik	6048	13.41	6	4586	1123	-	257	25279	k	2062
Kamenicë	7078	15.70	23	5980	1134	723	26	54677	191	4373
Kllokot	342	0.76	-	363	98	2359	3	11245	k	230
Novobërdë	2733	6.06	-	2823	2093	3786	17	48151	101	2181
Partesh	320	0.71	-	189	105	2626	21	13932	k	90
Ranillug	522	1.16	k	718	421	2309	5	18737	241	897
Shtërpcë	1560	3.46	-	1555	459	764	134	13132	k	1625
Viti	8205	18.20	24	15403	1539	284	162	134873	336	2692
Total	45092	100.00	64	53256	9991	14240	952	719849	1242	23306

3.2.10. Papunësia dhe punësimi

Resurset njerzore në Rajonin Zhvillimor Lindje paraqesin një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Sfida ekonomike me të cilën ballafaqohet ky rajon është papunësia. Fenomeni i papunësisë më së shumti është i shfaqur tek të rinjtë. Kërkesa e përgjithshme për punë në masë të madhe e tejkalon mundësitë që ofrohen nga tregu i punës. Pra konsiderohet se mundësitë për punësim janë të limituara, sidomos tek të rinjtë pas diplomimit. Duke e pasë parasyshë numrin e madh të të rinjve të diplomuar do të ishte e nevojshme që komunat të zhvillojnë programe vjetore për realizimin e praktikës profesionale nga të rinjtë. Sipas të dhënave nga agjencia e punësimit (raporti 2020), numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në rajonin lindje është 30,155 punëkërkues, ndërsa oferta e punës 2359. Numri më i lartë i punëkërkuesve është në komunën e Ferizajit 8,847 dhe vijon me komunën e Ferizajit 6,811, Vitinë 4,001, Kamenica, 2,308, Kacanik, 1,988, Shtërpce, 1,935, Novobërdë, 1,342, Kllokot 977, dhe Ranillug 921 dhe Partesh 411 (Figura 3). [15]

Figura 3: Papunësia në Rajonin Zhvillimor Lindje, sipas komunave (burimi: Agjencioni për Punësim i Republikës së Kosovës. Raporti për vitin 2020**.**



[15] Agjencioni për Punësim i Republikës së Kosovës, *Punësimi dhe aftësimi profesional 2020*, 2021.

3.2.11. Burimet natyrore

Burimet natyrore paraqesin një faktor mjaft të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Rajoni zhvillimor lindje posedon liqene dhe lumenj përmes të cilëve mund të krijoj kushte për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike. Ky rajon karakterizohet me kapacitet të kënaqshëm të ujit dhe burimeve të tjera natyrore. Lumenjtë më të mëdhenj në Rajon janë: Lepenci, Nerodime dhe Morava e Binçës. Gjithashtu ky rajon është i pasur edhe me minerale dhe xehe si: plumbi, zinku, argjendi, ari, bakri, kromi, hekuri, magnezi, linjiti, guri dekorativ, mermeri, kaolini, graniti, rërë kuarci, argjilë. Në këtë rajon dallohet miniera Artanës që ka përqindje të lartë të këtyre mineraleve dhe xeheve. Vendburimi më i rëndësishëm Mn, sipas të dhënave të kompleksit Trepça gjendet në zonën e minierës ekzistuese të Artanës ku përmes tjetërsimit të Pb-Zn është formuar mineralizimi i Mn-Fe. Resurset e vlerësuara të manganit në këtë vendburim janë rreth 5 milionë ton xehe, me përmbajtje rreth 22 % Mn. Valorizimi i xehes së Mn nga ky lokacion duhet të paraprihet me shqyrtimet teknike të gjendjes dhe mundësive të qasjes në minierën e mbyllur të Mn, si dhe kërkimet programore të mundësisë dhe efekteve të koncentrimit të Mn nga xehja në koncentrat, me metoda të flotacionit dhe me metoda të koncentrimit magnetik. [16]

3.2.12. Turizmi

Rajoni zhvillimor lindje ka potenciale të mëdha për turizëm rural dimëror dhe rehabilitues. Ndër potencialet turistike në rajonin lindje që vlejnë të ceken janë: qendra e skijimit në Brezovicë, banja termominerale në Kllokot, Kështjella e Novobërdës, etj. Objekte me vlerë që nga lashtësia dhe mjaft tërheqëse për t'u vizituar mund të përmendim: kisha Dardane në malet midis fshatrave Komogllavë- Sojevë dhe fshati i vjetër, ujësjellësi i kohës Iliro- Romake në fshatin Komogllavë, tumat (varrezat) Ilire në fshatin Varosh, mulliri i Nikës ende në funksion që nga viti 1321 dhe bifurkacioni i lumit Nerodime si fenomen i rrallë natyror. Ky rajon ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit dimëror, bazuar kjo në një traditë të hershme e cila lidhet drejtpërdrejtë me kushtet e favorshme topografike dhe ato klimatike për zhvillimin e këtij lloj turizmi. Malet e mëdha të mbuluara me borë deri në 280 ditë në vit dhe afërsia me komunikacionin rrugor me shtetet fqinje e bëjnë rajonin lindje mjaft të favorizuar për turizëm. Zona më e vlefshme turistike në rajonin lindje është Brezovica e cila është pjesë e parkut kombëtar të Sharrit. Vargu i maleve të Brezovicës shtrihet në sipërfaqe prej 39,000 hektarë, me një terren të lartë malor alpin dhe pyje. Qendra e skijimit në Brezovicë, në malet e Sharrit gjendet mes 1,700m dhe 2,500m lartësi mbidetare. Parku kombëtar i Sharrit karakterizohet me bukuri dhe vlera të veçanta natyrore (biologjike, biogjeografike, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike dhe klimatike) që kanë rendësi të po-saçme rekreative turistike. Në Komunën e Kamenicës për aktivitetet dhe investimet për zhvillimin e turizmit gjatë stinës së dimrit, potencial relevant janë fshatrat për rreth majës së Kikës, Gmicës, Kranidellit me rrethinë, ku japin mundësi të arsyeshme për investime në objekte hoteliere, për qendër të skijimit, po ashtu edhe turizëm veror. Këto vende bëjnë pjesë në viset malore, të cilat kanë bukuri të rralla natyrore. Këto hapësira ka mundësi të shfrytëzohen gjatë stinës së verës dhe dimrit për zhvillimin e sporteve në ecje, kampingje malore, si dhe forma të ndryshme të rehabilitimit. Natyra e Hanit të Elezit është shumë unike me dy masivet malore të Sharrit dhe Karadakut, të cilat mbyllin çdo horizont. Luginat e lumit Dinca dhe Lac, janë gjithashtu atraksione të veçanta turistike në këtë Komunë. Vlerave natyrore në Komunën e Hanit të Elezit si potencial për turizëm iu shtohen edhe vlerat kulturore të vjetra dhe të reja si Kompleksi i varrezave të

[16] Ministria e Zhvillimit *Rajonal, Profilet e rajoneve Zhvillimore në Kosovë*, Prishtinë, tetor 2019. Burimi http://kryeministri-ks.net/ëp-content/uploads/docs/Strategjia_Minerare_e_Republikes_se_Kosoves_2012-2025.pdf

dëshmorëve në Pustenik, i rregulluar dhe mirëmbajtur i cili gërshetohet me natyrën dhe Sharrit i shton mundësitë për zhvillimin e turizmit. Në këtë Komunë si pjesë e listës së trashigimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmenden Lagjja e Bravëve në Pustenik, Lagjja e Dacëve në Pustenik, Kompleksi i shtëpive në Lagjën Bushët e Poshtëm, xhamia e Vjetër në Han të Elezit, xhamia në Krivenik etj. Mundësi për ndërtimin e pishinave për kultivimin e peshkut ka në vendet e rrafshta, sidomos rreth lumenjve si në Hogosht, Shipashnicë, Kriva Rekë. Në komunën e Ranillugut vende atraktive për zhvillimin e turizmit të natyrës janë pyjet malore, pisha e bardhë me një sipërfaqe prej rreth 270 hektarë, që ndodhet në periferi të Ranillugut dhe mund të përdoret për rekreacion natyror, turizmi i banjave shëndetësore dhe turizmit rekreativ. Në fshatin Ropotovå ka kushte të mira për ecje, çiklizëm dhe motoçiklizmit, gjithashtu edhe për kalërim. Komuna e Gjilanit ka potenciale të trashegimisë natyrore sikurse peisazhet e maleve të Karadakut, peisazhet e pyjeve të Zhegovcit, Sllubicës me relief kodrinoro-malor dhe një bote bimore dhe shtazore të begat-shme. Në këtë reajon janë të njohura banjat termale të Uglarit, Mireshit dhe Dunavit. Festivali kulturor multidimensional “ Flaka e Janarit”, i cili fillon me 11 Janar në Gjilan me ndezjen simbolike të flakadanit dhe përfundon me 31 Janar i njohur me aktivitete të ndryshme kulturore. Muzeu i qytetit të Gjilanit i cili njihet ndryshe edhe si objekti i “Kajmekamllakut”, gjendet në qendër të qytetit, i ndërtuar në shekullin XIX, një objekt mjaft atraktiv për tu vizituar. Nekropoli i tumave Ilire në Llashticë i cili gjendet në verilindje të qytetit të Gjilanit është një monument atraktiv me vlera historike. Ndër objektet e tjera me vlere historike është kalaja e Pogragjës, kisha në Lisockë, kalaja e Mireshit, kalaja e Pidiqit, kalaja e Përlepnicës, kisha e Shën Anës në Dunavë të epër, kisha e Shën Nikollës në lagjen Varosh Fshatrat Bozhevc, Rajanovc, Kormnjan Domorovc, kanë shumëllojshmëri të pasur të florës dhe faunës ka kushte të mira për ekskursione, eko - rekreative, rural, gjueti dhe format e tjera të turizmit natyror. Tërheqjet turistike në Komunën e Ranillugut të cilat ne mund të specifikojmë janë ngjarje kulturore dhe sportive si "lojrat e Vidovdanit" në Ropotovë dhe lojërat në ditën e 1 Majit. Ky rajon ofron mundësi të shkëlqyeshme të turizmit si: skijimit, eko-turizmin, lëshime me parashutë nga lartësitë malore, çiklizmin malor, ngjitjen në shkëmbinj, alpinizëm, kalërim etj.[17]

3.2.13. Qyteti i Ferizajit qendër ekonomike e Rajonin Zhvillimor Lindje

Ferizaij si qender urbane shtrihet në pjesën jugore të Fushës së Kosovës. Në afërsi të tij kalon lumi i Nerodimës, degë e rendësishme e Lepencit, e cila në literaturen gjeografike veçohet për bifurkacionit si fenomen i rrallë gjeografik. Si lokalitet është relativisht i ri dhe egzistimin e tij e ka të lidhur me rrugën e karavaneve, të cilat lidhnin Shkodrën me Kosovën e Shkupin. Si lokalitet bëhet i njohur me ndërtimin e hanit të Feriz Shahsivarit, i cili në vitin 1836 kishte pozitë të rendësishme “Ami Bue”. Me ndërtimin e hekurudhës në vitin 1873 fillon zhvillimin e tij të hovshëm. Ferizaj ndonëse ka arkitekturë me elemente orjentale, ndërtimi i

[17] Ministria e Zhvillimit *Rajonal, Profilet e rajoneve Zhvillimore në Kosovë*, Prishtinë, tetor 2019

më vonshëm me rrugë të dejta dhe të gjata, me ndërtesa bashkëkohore dhe sheshe të gjëra, gjithnjë e më tepër po merr elemente të urbanizimit të kohës. Vija hekurudhore e ndanë qytetin në dy pjesë, në verior dhe jugor. Sot qyteti është i përfshirë nga një valë e ndëtimeve pa plan të cilat e kan dëmtuar seriozisht fizionominë e qytetit.

Deri në Luften e Dytë Botrore Ferizaji nuk ka pasur asnjë objekt industrial. Më vonë bëhet bërthamë e zhvillimit të industrisë. Në saje të lëndëve të para që ofron bujqësia, kryesisht është zhvilluar industria ushqimore (vajit, margarinës dhe biskotave), ndërsa sipërfaqet me pyje kan ndikuar në zhvillimin e industrisë së Drurit. Krahas këtyre është zhvilluar edhe industria metalike (industria e tubave) dhe elektro-industrisë (ajo e ujitjeve).

Funsionet e shumta që i ka Ferizaji janë atraktive për Rajonin Zhvillimor Lindje. Prej funksioneve terciare duhet të përmendet ai i komunikacionit, pastaj atë të tregëtisë e prej atyre kuaternare diferencohet për funksion të lartë shkollor (publik dhe privat). Profili i llojllojshëm shkollor, duke filluar me atë parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë e deri tek ai universitar, ka ndikuar në gravitimin e nxënësve dhe studentëve jo vetëm të komunës së Ferizajit por edhe të komunave për rreth. Ferizaji njihet edhe si qendër e madhe shendetësore, tregëtare, administrative dhe kukturore e egjionit lindor. Sot është zhvilluar knaqëshëm edhe kultivimi i luleve dhe drunjëve dekorative. Vend të rëndësishëm në ekonominë e qytetit ka edhe gastronomia. Atraksionet tuistike janë evidente në pjesën periferike të qytetit, përkatësisht tek Bifurkacioni i Neredimës dhe në Jezerc.

3. 3 Rajoni Zhvillimor Veri

Rajoni Zhvillimor Veri, shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Kosovës, në mes maleve të Kopaunikut në lindje dhe Rogoznës dhe Moknës në përendim. Kufirin verior të Rajonit e mbyllë kufiri shtetror i Republikës së Serbisë, ndërsa kufiri përendimor ndahet me komunat: Istog dhe Klinë. Kufirin jugor e mbyllin komuant: Gllogoc dhe Obiliq, atë lindor komuna e Podujevës. Në morfologjinë e relievit mbizotrojnë viset kodrinore në të dy anët e lumit Ibër, më pak pjesët e ngritura malore në anët e Kopaunikut, Rogoznës dhe Moknës. RZHV ka shtrirje me tepër të imponuar nga format relievore në drejtim veri-jug. Kontrastet relievore theksohen në mes të luginës së lumit Ibër dhe majave të maleve, ku diferenca në mes të luginës së lumit dhe Majës së Panqiqit është 1500m. Është hapësirë gjeografike ku nga aspekti gjelologjik marrinë pjesë gati të gjitha moshat gjeologjike. Formacionet më të vjetra parakembriane janë të shtrira në periferi, ku marrinë pjesë formacionet e rreshpeve argjilore, ranorëve, dhe konglomerateve. Shtrirje të gjërë kanë edhe formacionet e mesozoikut (masat e serpentintinit të Jurës, por mbizotrojnë flishet e kretakut të epërm). Përhapje relativisht të madhe kanë edhe fomacionet e miocenit, ku me formacionet vullkanike të kësaj hapësire gjeografike janë të lidhura edhe xehet e plumbit dhe zingut. Përbëhet nga shtatë komuna administative me gjithësejt një sipërfaqe prej 2051.84 km2 apo 18.81% të tërë teritorit të Kosovës.



Harta 4. Rajoni Zhvillimor Veri

3.3.1. Popullsia

Rajoni Zhvillimor Veri diferencohet me popullsinë më të vogël së rajoni lindje dhe është e lidhur ngushtë me relievin si faktor natyror, ku në pjesët më të larta shtrihen pyjet dhe kullotat ndësa në pjesët e ulta rreth luginës së lumit Ibër, në të cilat është i koncentruar edhe numri më i madh i popullsisë. Karakteristikë tjetër e këtij Rajoni janë proceset sociale-ekonomike, të lidhura me zhvillimin e industrisë, sidomos në qytetin e Mitrovicës, Zubin Potokut dhe Leposaviq. Kjo hapësirë gjeografike, dallohet për kah dendësia mesatare e popullsisë prej 109 banorë në km2, apo një herë më e vogël se dendësia mesatare e Kosovës, dhe afërsisht sa dendësia mesatare e RZh Lindje. Gjithsejtë ka 224121 banorë (12% e pop. së Kosovë), apo rreth 100000 banorë më pak se RZhL dhe e kategorizonë hapësirën gjeografike si rajonin e tretë për nga koncentrimi i popullsisë.

Ky numër më i vogël i popullsisë në krahasim me Rajonin Zhvillimor Qendër mund të shpjegohet me shkallën e ulët të zhvillimit ekonomik. Komuna me numër më të madh të popullsisë është Mitrovica Jugore (69331 banorë), e dyta renditet Vushtrria me 62.926 banorë, pastaj Skenderaj me 52.714 banorë, Leposaviqi (13.202 banorë), Mitrovica Veriore (11.994 banorë), ndërsa komunat e tjera si pjesë e këtij Rajoni kanë popullsi më të vogël (nën 10000 banorë). Me numrin më të vogël të popullsisë është Zveqani (7.290 banorë) dhe Zubin Potoku

(6.664 banorë). Dendësia e banorëve në rajonin zhvillimor veri është 109 banorë në një km^2. Komuna e Leposaviqit është ndër komunat që përfshinë sipërfaqen më të madhe të rajonit veri me një sipërfaqe prej 539.05 km^2, pastaj vijon komuna e Skënderajt me sipërfaqe prej 374.37km^2 dhe e treta me radhë është komuna e Vushtrrisë me 344.85km^2. Pastaj vijojnë Zubin Potoku me 334.38 km^2, Mitrovica Jugore 331.18 km^2 Zveçani 123.01 km^2 dhe Mitrovica Veriore 5 km^2. Ky rajon ka rreth 361 vendbanime apo 24.09 % të vendbanimeve të Kosovës nga shtatë komunat përbërëse të tij. Komuna me më së shumti vendbanime është komuna e Leposaviqit me 72, gjithashtu është komuna me sipërfaqen më të madhe në rajonin veri. Ndërsa komuna me numrin më të vogël të vendbanimeve e ka komuna e Mitrovicës Veriore me 3 vendbanime dhe është komuna me sipërfaqen më të vogël në Rajonin Zhvillimor Veri (Tabela 19).

Tabela 19: Popullsia dhe siperfaqja e Rajonit Zhvillimor Veri sipas Komunave

Rajoni zhvillimor Veri				
	Komunat	**Popullsia**	**Sipërfaqja km²**	**Dendesia e pop.**
1	Mitrovica jugore	69.331	331.18	209
2	Mitrovica Veriore	11.994	5	2399
3	Zveçan	7.290	123.01	59
4	Zubin Potok	6.664	334.38	20
5	Skenderaj	52.714	374.37	146
6	Vushtrri	62.926	344.85	182
7	Leposaviq	13.202	539.05	24
	Gjithsej	**224121**	**2051.84**	109

Të dhënat për shfrytëzimin e tokave në Rajonin Zhvillimor Veri janë të mangëta sepse ka mungesë të të dhënave për komunat Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveqan.

3.3.2. Arsimi

Sipas statistikave të arsimit publik 2020-2021 numri i shkollave në Rajonin Zhvillimor Veri në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 118, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 13. Numri i nxënësve në Rajonin Zhvillimor Veri në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 26605. Numri i nxënësve ne arsimin e mesëm të lartë është 8627 nga ta 4730 ose 54.83 % janë në shkollat profesionale. Duhet cekur se mungojnë statistikat për vendbanimet e banuara me shumicë serbe.

Tabela 20: Statistikat e Arsimit parauniversitar në Rajonin Zhvillimor Veri. Burimi: Statistikat e arsimit në Kosove 2020/2021.

	Numri i Institucioneve	Nxënës			Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli ndimës
	Publik			Privat	Publik		
Parashkollor/ qerdhe	3	<5 vjec	441	223	65	254	434
		5<6 vjec	2417	125			
Fillor dhe i mesëm i ulët	118	26605		96	1918		
I mesëm i Lartë	13	8627		41	582		

Një nga faktorët me rëndësi në përcaktimin e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar rajonal është edhe analiza e të dhënave për nivelin e shkollimit të popullatës. Struktura arsimore paraqet një bazë të rëndësishme të resurseve humane me ndikim në zhvillimin socio-ekonomik.

Në këtë pjesë është analizuar numri i popullsisë mbi 10 vjeç sipas nivelit të shkollimit. Të dhënat e ofruara në Tabelen 21 si më poshtë janë të dhëna janë marrë nga regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Poashtu këto të dhëna mund edhe të rifreskohen me regjistrimin e ri të popullsisë që pritet të realizohet gjatë këtij viti (2021).

Tabela 21: Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Veri. Regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës

Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Veri	Numri i popullatës sipas nivelit të shkollimit	% popullatës sipas nivelit të shkollimit
Diplomë pasuniversitare	824	0.6
Te diplomuar	9727	5.6
Arsimi i mesëm i lartë	53688	31.1
Arsimi i mesëm i ulët	51011	29.5
Shkollë fillore	26861	15.5
Pa përfunduar shkollimin fillor	15396	8.9
Dine shkrim lexim	9605	5.5
Nuk dinë shkrim lexim	5791	3.3

3.3.3. Infrastruktura

Kur flasim për Rajonin Zhvillimor Veri, mund të themi se infrastruktura rrugore rajonale dhe ajo lokale janë në një nivel mesatar zhvillimor në krahasim me rajonet tjera, edhe pse investimet në infrastrukturë në përgjithësi janë në rritje e sipër. Magjistralja në këtë rajon kalon në perëndim të qytetit, përgjatë lumit Ibër dhe Liqenit të Gazivodës deri në Malin e Zi dhe në Detin Adriatik, ndërsa autostrada Prishtinë-Mitrovicë është në ndërtim e sipër. Sa i përket infrastrukturës së rrugëve lokale rajoni zhvillimor veri qëndron në një përqindje të lartë të zhvillimit, bazuar kjo në statistikat e performancës rajonale të vitit 2019, ku Komuna e cila kryeson më rrugët e shtruara lokale është Komuna e Mitrovicës Veriore me 100% pastaj Vushtrria me 91.82 dhe Zveçanit poashut me 91.82%, pastaj komuna e Mitrovices Jugore me 91.80%, Skenderaji me 78 %. Ndërsa në nivel më të ulët qëndrojnë Zubin Potoku me 34.33% dhe Leposaviqi me 28.38%. Statistikat e detajura per paisjen me ndriqim te rrugëve lokale, përfshirjen ne sistemin e ujit te pijshëm dhe kalanizimieve janë të ofmruara në Tabelalen 22 në vijim[18].

Tabela 22: Infrastruktura lokale në rajonin veri. Burimi: Nga sistemi i menaxhimit te performances se komunave per vitin 2019.

Komuna	Rruget lokale të shtruara ne komuna ne %	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Ekonomitë familjare, instuticionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit në %	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik %
Mitrovica Veriore	100.00	33.33	//	81.08
Mitrovica Jugore	91.80	99.24	69.95	68.57
Skënderaj	78.00	60.75	60.72	3.40
Vushtrri	91.82	70.68	94.26	32.49

[18] Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal. Te dhënat janë nxjerrur nga version tabelar i të dhenave të detajuara për vlerësimin e komunave për vitin 2019.

Leposaviq	29.38	83.81	81.75	//
Zubin Potok	34.33	///	//	4.66
Zveqan	91.82	67.40	63.89	32.49

Linja hekurudhore veri-jug midis Beogradit dhe Prishtinës kalon nëpër Mitrovicë për në Shkup dhe nëpërmjet Selanikut deri në Detin Mesdhe. Rajoni zhvillimor i veriut nuk ka një gjendje te kënaqshme me rrjetin e telekomunikacionit dhe ekziston një shërbim rajonal i ndarë postar, sipas ndarjes etnike të rajonit. Ekzistojnë ofrues të shërbimeve të telefonisë fikse si PTK-ja etj. Furnizimi me energji elektrike vjen nga termocentralet në Obiliq. Një pjesë e rajonit të veriut furnizohet me energji elektrike nga Novi Pazari i Serbisë. Hidrocentrali në Liqenin e Gazivodës ka kapacitet të vogël, i cili furnizon konsumatorët në kohë kritike të konsumit.

3.3.4. Ekonomia dhe bizneset

Rajoni Zhvillimor Veri dhe qyteti më i madh i rajonit - Mitrovica është e njohur për minierat e saj dhe industrinë metalurgjike, duke qenë punëdhënësi kryesor në rajon. Mitrovica është e pasur me minerale në veçanti me linjit, metale si plumb, zink, fe-rronikel, magnezium, etj. Gjendja e tanishme teknologjike e këtyre xeheroreve, tani për tani nuk lejon eksploatimin efektiv të xeheve, ndërsa kapacitetet e ndërtuara përpunuese, po ashtu, kanë një degjenerim teknologjik. Eksploatimi i këtyre xeheve varet nga interesi i investitorëve strategjik. Janë mbi 16,000 kompani të regjistruara në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skënderaj, por këto dominohen kryesisht nga tregtia e jo nga prodhimi, me dyqane të vogla, të cilat kryesisht shesin mallra të importuara. Sektori i prodhimit është i pazhvilluar për shkak të faktorëve të tillë si ekonomia informale, norma shumë të larta interesi të kredive nga bankat komer-ciale, nuk ka sistem të kredive për aktivitetet e bizneseve fillestare, etj. Rajoni zhvillimor veriut ka mjaft hapësirë për ndërtimin e objekteve industriale dhe parqeve të biznesit, por shumica e tyre janë në pronësi të Trepçës dhe janë subjekt i procesit të privatizimit të kësaj kompanie. Parqet operative të biznesit në rajon janë si vijon: Parku i biznesit në Mitrovicë, Parku i biznesit në Dolane komuna e Zveqanit, Parku i biznesit në Vushtrri. Parku i biznesit në Skënderaj nuk është funksionalizuar dhe në vitin 2018 është marrë iniciativë e re për zhvendosjen dhe funksionalizimin e tij. Parku i biznesit në Mitrovicë, është krijuar në vitin 2012, me sipërfaqe prej 3.5 hektarë. Parku i biznesit ishte iniciativa e parë në Kosovë nga komuna e Mitrovicës e përkrahur nga MTI-së e cilësuar si pilot projekt për një zonë biznesi për prodhues. Implementimi i saj ishte model për thithjen e donacioneve dhe inkurajim për biznese. Për këtë qëllim, komuna ka ndarë 3.5 hektar tokë me qëllim të implementimit të projektit " Parku i Biznesit" nga i cili kanë përfituar gjithsej 22 biznese. Parku industrial në Frashër-Mitrovicë, është krijuar në vitin 2014 me sipërfaqe prej 48 hektarë. Në këtë zonë është investuar në rregullimin infrastrukturës fizike, prej tyre 10 hektarë janë rrafshuar dhe rregulluar për shpallje. 7 kontrata janë nënshkruar për të filluar investimet. Parku industrial në Frashër është zhvilluar në fazat I, II, III & e IV , kurse tani është duke u punuar në fazën e V-të. Zonat industriale janë mundësi e mirë për investitorët të zhvillojnë bizneset e tyre dhe kushtet e biznesit në këto zona janë të favorshme. Zonat industriale janë një ndër stimuluesit më të mirë të ekonomisë në rajonin veri. Komuna e Mitrovicës ka 1,540 parcela pronë komunale, në sipërfaqe prej 56,819,776 m247. Pasuria e Komunës Skënderaj ka 799,79.5548 hektarë pronë komunale.

Në Rajonin Zhvillimor Veri janë të regjistruara 17,626 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet: biznese individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjith-shme, shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin veri me një numër prej 15,432 biznese duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 1,732 biznese dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 332 biznese. Në Komunën

e Mitrovicës Jugore sipas tabelës së më poshtme sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 6,407 biznese, duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 739, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 148 biznese. Komuna e Vushtrrisë ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 4,244 biznese. Në Komunën e Vushtrrisë, sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 3,746 biznese, duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 444, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 44 biznese. Komuna e Vushtrrisë ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 4,244 biznese. Në Komunën e Skënderajt, sipas tabelës së mëposhtme, sek-tori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 2,312 biznese, duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 193, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 46 biznese. Komuna e Skënderajt ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 2,560 biznese. Ndërsa komuna me numrin më të vogël të bizneseve në rajonin lindje e ka komuna e Mitrovicës Veriore me një numër të përgjithshëm të bizneseve 612, biznese individuale 488, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara 124. [19]

Tabela 23: Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre, Rajoni Zhvillimor Veri. Bizneset sipas komunave ARBK

Komunat	Biznes Individual	Kompani e Huaj	Kooperativa bujqësore	Ndërmarrje publike	Ndërmarrje Shoqërore	Ndërmerrje tjera nën jurisdiksionine AKM-së	Ortakëri	Ortakëri e Përgjithshme	Shoqëri Aksionare	Shoqëri me përgjegjësi i të kufizuara	Total
Mitrovicë Jugore	6407	14	1	/	/	/	/	148	65	739	7376
Mitrovicë e Veriut	488		/	/	2	/	/			124	612
Zubin Potok	554	2	1	/	/	/	/	19	2	42	620
Zveçan	730	1	1	1	/	/	2	14	8	67	824
Skënderaj	2312	1	6	/	/	/		46	2	193	2560
Vushtrri	3746	5	2	/	/	/		44	2	444	4244
Leposaviq	1195		2	1	/	/	3	61	5	123	1390
Gjithsej	15432	23	13	2	2	/	5	332	84	1732	17626

3.3.5. Bujqësia

Potencialet për zhvillimin e prodhimit bujqësor i të gjitha llojeve në rajonin veri janë të larta. Tokat mjaft pjellore, kullosat, relievi kodrinoro – malor, e bëjnë këtë rajon mjaft të larmishëm për të pasur një industri bujqësore mjaft të zhvilluar. Toka bujqësore në rajonin veri përbëhet nga kopshte, pemishte, vreshta, serat, livadhet, kullotat, dhe toka tjera mjaft të dendura në relievin e tyre. Aktivitetet bujqësore në këto zona janë të ndryshme dhe përfshijnë kultivimin e varieteteve të ndryshme të drithërave, frutave dhe perimeve, duke përfshirë edhe vreshta, ndërsa nga blegtoria lloje të ndryshme të kafshëve dhe zogjve shfrytëzohen për nevojat e të ushqyerit dhe furnizimit me qumësht dhe produktet tjera të industrisë së mishit dhe tregjet e tyre, duke përfshirë edhe përpunimin e peshkut. Duke marrë parasysh konfigurimin malor të rajonit dhe pasurinë natyrore në pyjet dhe livadhet, rajoni zhvillimor perëndimor është i njohur tradicionalisht edhe për bletarinë dhe përpunimin e mjaltit, dhe industrinë e përpunimit të mishit, e cila në vitet e fundit po zhvillohet më tej. Vizioni i përgjithshëm për bujqësinë dhe

[19] Të dhënat sipas ARBK-së për numrin e bizneseve në vitin 2018.

zhvillimin rural në këtë rajon është që të arrihet një kontribut i ekuilibruar në mirëqenien ekonomike, mjedisore, sociale dhe kulturore partneritetet midis sektorit privat, qeverisë qendrore/lokale dhe komuniteteve brenda kontekstit zhvillimor të rajonit. Kur flitet për tokë pjellore mund të përmendim tokën e butë buzë të Ibrit e Sitnicës. Aty kultivohet gruri, misri, tërshëra, thekra, elbi, pjepri, shalqiri, speci, lakra, trangulli, jonxha etj. Komuna e Vushtrrisë, një tjetër rajon me bujqësi mjaft të zhvilluar, ku shumica e tokave janë të pjerrta, janë mirë të shfrytëzuara për kullota dhe prodhimtari bujqësore. Vushtrria është prodhuesi më i madh i patates në Kosovë. Aty gjendët edhe fabrika më e madhe e përpunimit të patates. Kjo Komunë posedon një sipërfaqe prej 17,505.59 hektarë të shfrytëzuar të tokës bujqësore nga të cilat rreth 7,000 hektarë janë nën sistemin e ujitjes.

Tabela 24: Sipërfaqja e tokës për shfrytëzim dhe sipërfaqja e tokës së shfrytëzuar nga Ekonomitë Bujqësore, Rajoni Zhvillimor Veri. Regjistrimi i Bujqësisë 2014[20]

Rajoni Zhvillimor Qender	Sipërfaqja e tokës - Gjithsej		Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	
	Nr. ekonomive bujqësore	Siperfaqja (ha)	Nr. ekonomive bujqësore	Siperfaqja (ha)
Leposaviq	/	/	/	/
Mitrovice	2803	13278	2786	10942
Mitrovice e veriut	/	/	/	/
Skenderaj	6232	27559	6205	19701
Vushtrri	6232	20829	6199	17506
Zubin Potok	/	/	/	/
Zveçan	/	/	/	/
Gjithsej	**15267**	**61667**	**15190**	**48149**

Blegtoria si indikator i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik zë vend të veçantë në kategorizimin e aktivtteteve ekonomike, por, në RZhV, fondi prej 31414 krerë gjedhe sa ka gjithësejt, e kategorizon rajonin si më pak të rendësishmit për zhvillimin e këtij sektori.

Tabela 25: Fondi blegtoral sipas komunave në Rajonin Zhvillimor Veri[21]

Komunat	Gjedhe	Buallica	Dele	Dhi	Derra	Kuaj, gomare dhe mushka	Shpeze	Kafshë të tjera	Koshere bletësh
Mitrovicë	6215	-	5651	718	k	50	63732	k	4295
Mitrovicë e Veriut	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Zveçan	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Zubin Potok	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Skënderaj	14199	k	4341	673	k	3	107819	187	6576
Vushtrri	11000	k	3636	532	395	56	158712	k	5415
Leposaviq	/	/	/	/	/	/	/	/	/

20https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__02%20Agriculture__Agricultural%20Household%20Survey/aeb01.px/?rxid=eae1fd74-f027-4e2f-b865-c90c9b58d820

21 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__02%20Agriculture__Agricultural%20Household%20Survey/aeb01.px/?rxid=eae1fd74-f027-4e2f-b865-c90c9b58d820

Gjithsej	**31414**	**0**	**13628**	**1923**	**395**	**109**	**330263**	**187**	**16286**

3.3.6. Papunësia dhe punësimi

Rajoni Zhvillimor Veri ka potencial të mjaftueshëm për ofrimin e fuqisë punëtore. Papunësia është një element ekzistues dhe i shpërfaqur nënivel të konsiderueshëm në këtë rajon. Në bazë të statistikave të raportit të punësimit për vitin 2020 numri i përgjithshëm i punëkërkuesve në rajonin veri është 29948, ndërsa oferta e punës është 2176, ku dhe shohim një diferencë të madhe ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë, gjithmonë duke pasur parasysh që të dhënat nuk e pasqyrojnë realitetin në terren. Por të dhenat nuk janë të plota pasi që shumë punëkërkues nuk drejtohen në zyrat e punësimit që të jenë të evidentuara si shifra. Nga Tabela e mëposhtme nr. 26 shohim se komuna e Mitrovicës Jugore ka numrin më të madh të punëkërkuesve prej 7828 dhe një ofertë të vogël pune prej 604 vendeve të lira. Vijon Komuna e Vushtrrisë më 7049 punëkërkues dhe 732 vende të lira pune. Komuna e Skënderajt me 4777 punëkërkues dhe 451 mundësi punësimi, duke vijuar me Komunat me numrin më të vogël të punëkërkuesve si: Komunën e Leposaviqit 3189 punëkërkues, Zubin Potokut me 1738 punëkërkues dhe Zveçanit me 1853 punëkërkues. Rajoni Zhvillimor Veri ka një potencial të madh njerëzor për tregun e punës duke përfshi këtu një fuqi punëtore mjaft të re dhe të kualifikuar.

Tabela 26: Papunësia dhe vendet e lira të punës në rajonin zhvillimor veri. Burimi APRK: Raporti i punësimit për vitin 2020

Komuna	Papunësia (numri i punëkërkuesve)	Vendet e Lira të Punës të rregullta	Vendet e lira PATP
Mitrovicë Jugore	7828	287	317
Skënderaj	4777	153	298
Vushtrri	7049	411	321
Mitrovica Veriore	3514	39	104
Leposaviq	3189	4	100
Zveçan	1853	7	48
Zubin Potok	1738	66	66
Gjithsej	29948	922	1254

3.3.7. Burimet natyrore

Rajoni Zhvillimor Veri ka resurse minerale nëntokësore, rezerva pyjore, toka pjellore dhe burime të pasura me ujë. Rajoni Zhvillimor i Veri është shumë i pasur me burime ujore, duke i theksuar këtu lumenjtë, Ibër dhe Sitnicë dhe liqeni më i madh artificial i Ujmanit në Zubin Potok, një nga rezervuarët më të mëdha të ujit të këtij lloji në Evropë. Komuna e Skënderajit ka pasuri nëntokësore të cilat janë një poten-cial i madh ekonomik i kësaj zone si: gurë gëlqeror dhe argjilë i kualitetit të lartë për përpunimin e materialeve ndërtimore. Fshatrat e Bajzës dhe Syriganës janë të pasura me plumb dhe zink. Në fshatrat Polac dhe Prekaz të komunës së Skënderajit janë zbuluar rezerva të thëngjillit deri në 7 milion ton në thellësi prej 10 -15 m, një pasuri e madhe e cila ende qëndron në pritje të investimeve kapitale në këtë zonë. Duke u bazuar në faktin se miniera e Feronikelit nuk është larg nga territori i komunës së Skënderajit, sipas disa të dhënave ka shenja se edhe në fshatrat e komunës së Skenderajit siç janë: Qirez, Baks, Prellovc etj, ka xehe nëntokësore, por që duhet të bëhet një hulumtim shkencor i saktë.[22]

[22] Ministria e Zhvillimit *Rajonal, Profilet e rajoneve Zhvillimore në Kosovë*, Prishtinë, tetor 2019

Zona e Mitrovicës është mjaft e pasur me kullosa, ara, pyje dhe sipërfaqe malore. Potencial i madh i kësaj treve është edhe vet hidrografia e saj e pasur me lumenj, liqene me potenciale të mëdha të ujërave ku një pamje piktoreske japin degëzimet e lumit Ibër në ato të lumenjve: të Sinices, Lushtës, Trepçës dhe Bistricës. Trepça është një burim i çmuar natyror i gjithë Kosovës e cila posedon një potencial të madh të zhvillimit ekonomik të rajonit përkatësisht dhe tërë Republikës së Kosovës. Miniera Trepça ka një infrastrukturë të mirë sipas modelit bashkëkohor të minierave nëntokësore, i ka tri puse servili dhe të ajrosjes Është e zhvilluar në 12 horizonte, kurse ndërmjet tri horizonteve të fundit janë zhvilluar rampat që mundësojnë aplikimin e mekanizimit ba-shkëkohor në përgatitje dhe në shfrytëzim të xehes. Miniera me infrastrukturën e vetë si dhe me metodat bashkëkohore të mbushjes, ka kapacitetin e shfrytëzimit të xehes prej 500,000 deri në 650,000 ton xehe në vit. Miniera e Stantërgut me vendburimet që e rrethojnë, ka rezerva prej rreth 35 Mt, ose shprehur përmes sasisë të metaleve në xehe, 1,349,579 ton plumb, 1,080,504 ton zink dhe 2,280,224 kg argjend dhe aktualisht paraqet një nga potencialet më të rëndësishme të xeheve sulfite të Pb dhe Zn në rajon.[23]

3.3.8. Turizmi

Rajoni Zhvillimor Veri ka potenciale për zhvillimin e turizmit. Malet e larta si Mokra, Gora, Shala e Bajgores, Çyçavica me natyrën e tyre të bukur paraqesin potencial të madh për zhvillimin e ekoturizmit dhe turizmit dimëror. Lugina e Ibrit mund të përdoret për rekreacione të ndryshme dhe aktivitete sportive. Liqeni i Ujmanit është tërheqëse për vizitorët gjatë periudhës së verës. Llojet e turizmit që mund të zhvillohen në rajonin e Shalës janë: turizmi malor, turizmi kulturor, turizmi rural dhe eko-turizmi. Turizmi malor-bjeshkët e Bajgores. Një lloj potenciali turistik që ka Shala, janë minierat e dala jashtë funksionit në Trepçë , të cilat janë pika interesante për zhvillimin e turizmit. Muzeu i kristaleve është i themeluar në vitin 1964 në të cilin janë të vendosura mbi 1300 eksponentë të llojeve të ndryshëm të kristaleve duke e shndërruar muzeun në një objekt me rendësi të madhe kombëtare për Kosovën si në aspekt të vlerave po ashtu edhe në aspektin turistik. Vushtrria është një ndër qytetet më të lashta të Kosovës, e cila në periudhën romake përmendet si qendër tregtare me emrin Vicianum. Në Komunën e Skenderajt janë kullat historike komplekset memoriale dhe atraksione turistike te cilat vizitohen nga shume turistë vendas dhe të huaj.[24]

3.3.9. Qyteti i Mitrovicës Jugore qender e Rajonit Zhvillimor Veri

Shtrihet në fushën aluviale të lumenjve: Ibër, Sitnicë, Lushtë dhe Trepça, si dhe në shpatet e k odrave që e rrethojnë. Pozita gjeografike është e volitshme për shkak të relievit. Qyteti kufizohet nga shpatet e Kreshbardhës (Kopaonikut), Rogoznës, Mok nës dhe Qyqavicës. Territori i kësaj komune kufizohet me komunën e Zveçanit (në pjesën veriore), me k omunën e Besianës (në pjesën lindore), me komunën e Vushtrrisë (në pjesën jugore), komunën e Skenderajit (në pjesën perëndimore) dhe me komunën e Zubin Potokut (në pjesën veriperëndimore). Në drejtim të Sitnicës lidhet me Rrafshin e Kosovës. Qytetin, nga ana jugore e ndanë prej bazenit të Kos-ovës kodrina tufoide e Bajrit (520 m). I tërë territori i rrethinës së Mitrovicës ka një pozitë të rëndësishme, sidomos për komunikacionin transitor. Mitrovica shtrihet në shkallën 42,53° të gjerësisë gjeografike ver iore dhe në atë 25, 52° të gjerësisë gjeografike lindore si dhe në lartësinë mbidetare 508-510 m. Pozita strategjike dhe sidomos ajo gjeografike në mes dy lumenjve të rëndësishëm, Ibrit e Sitnicës, ka bërë që territori i Mitrovicës të popullohet qysh në parahistori. Motiv ekonomike për themelimin e vendbanimeve dhe për përqendrimin e popullsisë në këtë trevë, para së gjithash, kanë qenë blegtoria, bujqësia, gjuetia e më pas edhe xehetaria në fillim e zhvilluar në masë modeste për t'u bërë më vonë një ndër

[23] Po aty.
[24] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020-2030*, Prishtinë 2020.

shkaqet kryesore të depërtimit romak dhe pushtuesve sllavë, osmanë etj, në këtë anë. Në Kosovë dhe rajon Mitrovica është e njohur për pasuritë e begatshme natyrore, kryesisht me metalet e Plumbit dhe Zinkut. Ekonomia e tërë në Mitrovicë është zhvilluar përreth industrisë së minierave dhe nxjerrjes dhe përpunimit të metaleve. Të dhënat e shfrytëzimit të tokës në Komunën e Mitrovicës, tregon që toka për bujqësi dhe livadhe përfaqëson 50.29% të sipërfaqes së përgjithshme. Kjo trevë, sikurse pjesët tjera të Gadishullit Ilir, në lashtësi kanë qenë e banuar me banorë ilirë, përkatësisht fisin dardan.[25]

[25] Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, *Profilet e Komunave të Republikës së Kosovës*, 2017

3.4. Rajoni Zhvillimor Perëndim

Sipërfaqja e rajonit përbëhet nga gjashtë komuna: Istog, Klinë, Pejë, Junik, Deçan dhe Gjakovë me gjithsej 314 vendbanime të përfshira në rajon. Me një sipërfaqe të përgjithshme prej 2,324.38 km2 ky rajon mbulon rreth 21.31 % të sipërfaqes së Kosovës. Kufizohet me Malin e zi në veriperëndim, ndërsa ne jug perëndim kufizohet me Shqipërinë, në pjesën verilindore me rajonin ekonomik veri, dhe juglindje me rajonin ekonomik jug. Rajoni Perëndimor është i mbuluar kryesisht nga Rrafshi i Dukagjinit që kufizohet nga malet e larta të Alpeve Shqiptare. [26]

Harta 5. Rajoni Zhvillimor Perëndim

3.4.1. Popullsia

Me një popullsi të përgjithshme prej 323,468 banorë apo 18% të popullsisë së Kosovës. Rajoni zhvillimor perëndim përfshin 314 vendbanime apo 20.96 % të vendbanimeve të Kosovës. Dendësia e popullsisë është 139 banorë për km në rajonin perëndim. Ndërsa komunat me popullsinë më të dendur në rajonin perëndim janë Peja me 98.601banorë apo 164 banorë për km, pastaj Gjakova me 94.334 banorë apo 161 banore në një km². Deçani me 41,181 banorë apo me 145 banorë në një km². Komunat me shtrirje më të gjerë në rajonin perëndim janë Peja me 602.63 km² apo 25.92% e territorit të rajonit perëndim, pastaj është Gjakova me 586.62 km² apo 25.23 % të teritorit të rajonit perëndim dhe Istogu me 454.36 km² apo 19.54 % të teritorit të rajonit perëndim.[27]

Tabela 27. Dendësia e popullsisë dhe sipërfaqja në Rajonin Zhvillior Perëndim. Burimi: ASK Vjetari Statistikor 2021. Vlerësimet e popullsisë për 2020.

Rajoni zhvillimor Perëndim				
	Komunat	**Popullsia**	**Sipërfaqja km²**	**Dendesia e pop.**
1	Deçan	42.480	293.97	145
2	Gjakovë	94.334	586.62	161
3	Istog	41.181	454.36	91
4	Junik	6.383	77.78	82
5	Klinë	40.489	309.02	131
6	Pejë	98.601	602.63	164
	Gjithsej	**323468**	**2324.38**	**139**

3.4.2. Relievi dhe ndërtimi gjeologjik

[26] Po aty.
[27] Agjencioni I Statistikave të Kosovës, *Vjetari Statistikor 2021*, Vlerësimet e popullsisë për 2020

Rajoni Zhvillimor Perëndim mbulohet kryesisht nga Rrafshi i Dukagjinit që kufizohet me malet e larta të Alpeve Shqiptare. Territori i Bjeshkëve të Nemuna paraqet një nga zonat më të rëndësishme për sa i përket peizazhit natyror dhe i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret për t'u konsideruar për t'u mbrojtur si Park Kombëtar. Sipërfaqja e propozuar e parkut është 38,000 ha (GZK11/86). Me ngritjen e këtij parku në Rajonin Perëndimor do të ketë përfitime si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social/rekreativ.

Pjesa e territorit të Bjeshkëve të Nemuna, e cila propozohet si Park Kombëtar, është e veçantë për nga karakteristikat dhe vlerat e saj natyrore dhe si e tillë duhet të vihet nën kujdes dhe mbrojtje të veçantë. Bukuritë natyrore dhe vlerat ekologjike të këtij territori, veçanërisht të Grykës së Rugovës, zënë një vend të rëndësishëm në vlerësimet krahasuese të peizazheve, atraktivitetit të zonave specifike natyrore.

Në masivin e Bjeshkëve të Nemuna, përveç majës së Gjeravicës me lartësi mbidetare 2656 m (maja më e lartë në Kosovë) dallohen këto majat e rëndësishme:

- Maja e Rupes (Maja e Rupës) 2,501 m
- Maja e Qenit (Maja e Qenit) 2,405 m
- Maja e Strellcit (Maja e Strellcit) 2,377 m
- Rrasa e Zogut (Maja e Rrasës së Zogut) 2,305 m
- Maja e Marjashit (Maja e Marjashit) 2.530 m

3.4.3. Klima

Karakteristikat klimatike të Rajonit Perëndimor janë pothuajse të njëjta si në të gjithë territorin e Rrafshit të Dukagjinit. Kosova Perëndimore ka një klimë kontinentale të ndikuar nga klima mesdhetare. Temperaturat relativisht të larta me një vlerë mesatare vjetore mbi 11°C, gushti dhe korriku janë muajt më të nxehtë me temperaturë 21,7°C dhe 21,68°C dhe janari muaji më i ftohtë me temperaturë 0,5°C. Lagështia mesatare e ajrit gjatë një viti është 70,2%, me ç'rast një rritje e lagështisë është dukshëm më e lartë nga stina e verës në stinën e dimrit për 17,5% sesa ulja e lagështisë nga dimri në verë.

Në këtë rajon mesatarja vjetore e motit me vranësira është 58%. Gjatë vitit, frekuenca e ditëve pa re është 60,5 ditë (16,6%), ndërsa frekuenca e ditëve me re është 119,3 ditë (32,6%). Zgjatja mesatare e zënies së diellit për shkak të ndikimeve ortografike është më e vogël se mesatarja në Kosovë dhe është 1.972 orë, nga të cilat 293,6 orë ose 72,1% e diellit në vit në korrik.

Sasia e reshjeve në këtë rajon është ndër më të mëdhatë në Kosova. Në pjesët e ulëta është 724.6 lit/m², në zonat malore të Bjeshkët e Nemuna sasia mesatare e reshjeve arrin më shumë se 1.300 lit/m².

Frekuenca e erës është …./ 398 0/00/, ndërsa frekuenca e erërave perëndimore (Ë) dhe jugperëndimore (JP) është 122 0/00/ dhe 113 0/00/ dhe frekuenca më e ulët është ajo e erërat lindore /E/ me 55 0/00/.

3.4.4. Ujërat

Rajoni Zhvillimor Perëndim është i njohur për dendësinë e lartë të lumenjve. Kosova ka katër pellgje kryesore kulluese, kryesi i të cilave është burimi i lumit Drini i Bardhë, i cili fillon në fshatin Radac të komunës së Pejës dhe mbulon pothuajse të gjithë rajonin që derdhet në detin Adriatik. Lumenjtë e mbetur të rajonit derdhen në lumin Drini i Bardhë duke përfshirë Bistricën e Pejës që fillon në rrëzë të Kodrës së Plakut, një nga majat e Alpeve Shqiptare në lartësinë

1900 m mbi nivelin e detit dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi afër fshatit Zajm rreth 378 m mbi nivelin e detit.

Rajoni Zhvillimor Perëndim ka disa liqene malore si liqenet në malin e Gjeravicës (Figura 2) dhe në malet e Rugovës. Liqeni artificial i Radoniqit që gjendet në komunën e Gjakovës me një sipërfaqe prej rreth 130 km² përmban rreth 113,000,000 m³ ujë (esk gj. Mje 06-07).

Mirusha – Rajoni i Mirushës në jug dhe lindje të rajonit është ndër zonat më të bukura dhe më interesante të Kosovës. Kjo është regjistruar përmes diversitetit biologjik të këtij rajoni. Ky rajon ka një sipërfaqe prej 63.21 km2. Lartësia mbi nivelin e detit të zonës varion nga 340–1006 m. Lumi Mirusha është një nga lumenjtë më të bukur të Kosovës. Në pjesën e fundit të tij, përroi kalon nëpër një grykë, e cila njihet si Kanioni i lumit Mirusha. Parku natyror i Mirushës ndodhet në të dy anët e lumit Mirusha nga fillimi i kanionit deri në vendin ku derdhet në lumin Drini i Bardhë.[28]

3.4.5. Arsimi

Sipas statistikave të arsimit publik 2020/2021 numri i shkollave në Rajonin Zhvillimor Perëndim në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 137, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 20. Numri i nxënësve në Rajonin Zhvillimor Perëndim në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 23266. Numri i nxënësve ne arsimin e mesëm të lartë është 10455 nga ta 6279 ose 60.06% janë në shkollat profesionale.

Tabela 28: Statistikat e arsimit parauniversitar. Burimi: Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/2021

	Numri i Institucioneve	Nxënës			Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli ndimës
	Publik			Privat	Publik		
Parashkollor/ qerdhe	12	0<5 vjec	850	476	115	269	552
		5<6 vjec	2980	192			
Fillor dhe i mesëm i ulët	137	23266		292	3041		
I mesëm i Lartë	20	10455		543	972		

Një nga faktorët me rëndësi në përcaktimin e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar rajonal është edhe analiza e të dhënave për nivelin e shkollimit të popullatës. Struktura arsimore paraqet një bazë të rëndësishme të resurseve humane me ndikim në zhvillimin socio-ekonomik. Në këtë pjesë është analizuar numri i popullsisë mbi 10 vjeç sipas nivelit të shkollimit për Rajonin Zhvillimor Perëndim. Të dhënat e ofruara në tabelen 29 si më poshtë janë të dhëna janë marrë nga regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Poashtu këto të dhëna mund edhe të rifreskohen me regjistrimin e ri të popullsisë që pritet të realizohet gjatë këtij viti (2021).

Tabela 29: Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Përëndim. Regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës

Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Perëndim	Numri i popullatës sipas nivelit të shkollimit	% popullatës sipas nivelit të shkollimit
Diplomë pasuniversitare	1490	0.6
Te diplomuar	20584	7.9

[28] Qendra Rajonale Perëndim, *Strategjia për Rajonin Perendim 2010-2013*.

Arsimi i mesëm i lartë	75505	29.1
Arsimi i mesëm i ulët	93950	36.2
Shkollë fillore	44964	17.3
Pa përfunduar shkollimin fillor	2544	1
Dine shkrim lexim	14774	5.7
Nuk dinë shkrim lexim	5791	2.2

3.4.6. Infrastruktura

Infrastruktura në Rajonin Zhvillimor Perëndim është relativisht e zhvilluar. Ky rajon është pikë lidhëse e Kosovës duke u kufizuar me Shqipërinë (Gjakova dhe Juniku), me Malin e Zi (Deçani dhe Peja), dhe me Serbinë (Komuna e Istogut).Vitet e fundit është investuar shumë në rrugët lokale, ujësjellës, kanalizim, sistemin energjetik dhe ndriçim publik[29].

Sa i përket infrastrukturës së rrugëve lokale Rajoni Zhvillimor Perëndim qëndron në një shkallë që varion nga lloji i infrastruktures, por përgjithësisht të mirë bazuar kjo në statistikat e performancës rajonale të vitit 2019. Kur është fjala për rrugët lokale Komuna e cila kryeson më rrugët e shtruara lokale është Komuna e Junikut me 100% pastaj Gjakova me 84.9 Peja me 77.94%. Ndërsa në nivel më të ulët qendrojnë Deçani me 63.33 %, Istogu me 62.12 dhe Klina me 59.35%. Statistikat e detajura per paisjen me ndriqim te rrugëve lokale, përfshirjen ne sistemin e ujit te pijshëm dhe kalanizimieve janë të ofmruara në Tabelalen 30 në vijim.[30]

Tabela 30: Infrastruktura lokale në Rajonin Zhvillimor Perendim Burimi: Nga sistemi i menaxhimit te performances së komunave për vitin 2019.

Komuna	Rruget lokale të shtruara ne komuna ne %	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Ekonomitë familjare, instuticionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit në %	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik %
Pejë	77,94	100,00	63,89	33,47
Istog	62,12	99,07	81,97	4,61
Deçan	63,33	100,00	83,86	12,35
Junik	100,00	100,00	100,00	68,93
Klinë	59,36	80,44	85,48	4,67
Gjakovë	84,09	100,00	74,74	31,61

3.4.7. Papunësia dhe punësimi

Resurset njerëzore dhe tregu i punës në Rajonin Zhvillimor Perëndim paraqesin, gjithashtu një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Në rajonin perëndim kemi një numër prej 28228 punëkërkuesve dhe një ofertë tregu prej 2108 vendeve të lira të punës bazuar kjo në statistikat e nxjerra nga raporti i punësimit për vitin 2020. Raporti mes ofertës dhe kërkesës ka një diferencë mjaft të madhe për shkak të problematikes së mungesës së qasjes dhe regjistrimit të punëkërkuesve në zyrat e punësimit. Në rajonin perëndim, komuna me numrin

[29] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Profilet e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë*, tetor 2019.
[30] Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Të dhënat nga raporti i detajuar tabelar për përformancën e komunave për vitin 2019.

më të madh të punëkërkuesve është Komuna e Pejës me një numër prej 10139 ndërsa me një ofertë prej 665 vendeve të lira. Komuna e dytë është Komuna e Gjakovës me një numër të punëkërkuesve prej 9537 dhe një ofertë për vende të lira puna prej 752 dhe Komuna e Klinës me një numër të punëkërkuesve prej 3076 dhe një ofertë prej 226 vendeve të lira për punë. Vijojnë Komuna e Deçanit me 2023 punëkërkues dhe Komuna Istog me 3012 punëkërkues. Komuna me numrin më të vogël të punëkërkuesve është Komuna e Junikut e 441 punëkërkues dhe 39 vende të lira pune[31].

Tabela 31: Papunësia dhe vendet e lira të punës në rajonin zhvillimor perëndim. Burimi: Raporti i APRK 2020

Komuna	**Papunësia Numri i punëkërkuesve**	**Vende e Lira të punës të rregullta**	**Vendet e Lira MATP**
Pejë	10139	196	469
Istog	3012	26	315
Deçan	2023	31	54
Junik	441	17	22
Klinë	3076	59	167
Gjakovë	9537	236	516
Gjithsej	28228	565	1543

3.4.8. Ekonomia dhe zhvillimi i bizneseve[32]

Në Rajonin Zhvillimor Perëndim fushat me potencialin më të lartë për zhvillim janë: bujqësia, përpunimi i drurit, teknologjia informative dhe telekomunikimit, ndërtimtaria, prodhimi i komponentëve për automjete, energjia, tekstili dhe turizmi, si fusha me potencialin më të lartë për zhvillim. Në lidhshmëri me të lartcekurat, si nënfusha apo industri me potencial mjaft të mirë për zhvillim të menjëhershëm janë: industria e përpunimit të ushqimeve nga produktet bujqësore dhe ajo e përpunimit të mishit. Industria e nxjerrjes dhe përpunimit të gurëve dekorativ, format e ndryshme të përpunimit të drurit dhe industria e konstruksioneve metalike. Duke e shikuar nga aspekti rajonal, pothuaj të gjitha këto fusha apo industri përfshihen në planet zhvillimore komunale dhe urbane të komunave të rajonit perëndimor, si dhe në dokumente tjera të niveleve komunale dhe rajonale. Rajoni zhvillimor perëndimor ka potenciale të mëdha dhe kushte mjaft të favorshme për biznese, duke pasur parasysh faktorë të rëndësishëm si: fuqinë punëtore të arsimuar mirë, konkurruese, burime të lakmueshme natyrore (minierat, bujqësia), taksa të ulëta dhe një sistem transparent. Në Rajonin Zhvillimor Perëndim janë themeluar zonat ekonomike si: Parku Industrial në Gjakovë, "Zona Ekonomike Amerikane" po ashtu në komunën e Gjakovës, zona ekonomike industriale në Pejë. Zona Ekonomike Amerikane synon të tërheqë investitorë të huaj kryesisht biznese Amerikane dhe të jetë bazë për investime strategjike. Zona ekonomike Amerikane është themeluar vitin 2018 dhe pritet të jetë një stimulim i jashtëzakonshëm për ekonominë e rajonit perëndim. Kjo zonë përfshinë një sipërfaqe prej 500 hektarë dhe ka për synim tërheqjen e investitorëve dhe bizneseve amerikane. Komuna Pejës në planin e saj zhvillimor të Komunës ka paraparë të zhvillojë zonën e lirë ekonomike, bazuar ne Ligjin per Zonat Ekonomike ka në pronësi të saj 547 hektarë 46 ari e 71m² . Sipas shënimeve sipërfaqja më e madhe është në pjesët e zonës rurale dhe kodrinoro - malore. Komuna e Istogut ka 1540 parcela (pronë komunale), në

[31]Agjencioni i Punësimit i Republikës së Kosovës, *Punësimi dhe Aftësimi Profesional për vitin 2020*, Prishtinë 2021.
[32] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Profilet e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë*, tetor 2019.

sipërfaqe prej 56,819,776 m²63. Në komunën e Deçanit, numri i parcelave komunale është 716, sipërfaqja tokësore e parcelave komunale është 32.789.07 hektare.

Në Rajonin Zhvillimor Perëndim janë të regjistruara 25,894 biznese. Ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; biznese Individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri të përgjithshme, shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin Perëndim me një numër prej 22,325 duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 2,975 dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 430 biznese. Në Komunën e Pejës, sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 8,220 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 1,308 pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 214 biznese. Komuna e Pejës ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 9,789 biznese. Në Komunën e Gjakovës, sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 6,954 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 837, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 125 biznese. Komuna e Gjakovës ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 7,977 biznese. Në Komunën e Istogut sipas tabelës së mëposhtme sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 2,563 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 367, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 29 biznese. Komuna e Istogut ka një numër te përgjithshëm të bizneseve prej 2,985 biznese. Ndërsa komuna me numrin më të vogël të bizneseve në rajonin perëndim e ka komuna e Junikut me një numër të përgjithshëm të bizneseve 5, nga ato biznese individuale jane 4, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara 1.[33]

Tabela 32: Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre në Rajonin Zhvillimor Perëndim

Komunat	Biznes individual	Kompani e huaj	Kooperativa bujqësore	Ndërrmarje publike	Ndërrmarje shoqërore	Ndërrmarje tjera nën juridiksion të AKM-së	Ortakëri	Ortakëri e përgjithëshme	Shoqëri aksionare	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	Total
Deçan	2,134	2	2	/	/	/	/	22	4	199	2,363
Gjakovë	6,954	9	8	1	/	1	4	125	38	837	7,977
Istog	2,563	3	13	/	/	/	/	29	10	367	2,985
Junik	4	/	/	/	/	/	/	/	/	1	5
Klinë	2,450	2	8	/	1	/	2	40	9	263	2,775
Pejë	8,220	20	5	1	/	/	5	214	16	1,308	9,789
Gjithsej	**22,325**	**36**	**36**	**2**	**1**	**1**	**11**	**430**	**77**	**2,975**	**25,894**

3.4.9. Bujqesia

Rajoni Zhvillimor Perëndim i Kosovës vlerësohet të ketë rreth 89,346,75 hektarë tokë të shfrytëzuar bujqësore në gjashtë komunat e saj dhe 37,376.21 tokë të punueshme, pastaj 50,434 livadhe dhe kullota, pastaj 12, 729.67 tokë pyjore. Statistikat e hollesishme shihni në Tabelen 33.

[33] Të dhënat sipas ARBK-së për numrin e bizneseve në vitin 2018.

Tabela 33: statistikat e tokave bujqësore në Rajonin Zhvillimor Perëndim[34]

KOMUNAT	Sipërfaqja e shfrytezuar e tokës bujqësore/ Sipërfaqja ha	Tokë e punueshme-Arat/Siperfaqja ha	Kopshte	Livadhet dhe kullotat/Sipërfaqja ha	Tokë bujqësore e papërdorur Sipërfaqja ha	Toka pyjore/Sipërfaqja ha	Toka jobujqësore/Sipërfaqja ha
Pejë	21,024.91	7,141.92	54.51	13,496.83	1,039.14	2,070.93	688.04
Istog	20,653.91	9,091.08	50.51	11,124.83	426.64	1,761.64	601.33
Deçan	10,043.88	2,901.94	29.86	7,003.17	71.25	860.13	472.31
Junik	1,298.16	604.86	3.49	636.16	104.28	528.33	62.59
Klinë	14,947.55	10,214.33	34.41	4,461.54	375.58	2,753.88	681.93
Gjakovë	21,378.34	7,422.08	41.35	13,711.47	1,137.85	4,754.76	788.55
GJITHSEJ	**89,346.75**	**37,376.21**	**214.13**	**50,434**	**3,154.74**	**12,729.67**	**3,294.75**

Aktivitetet bujqësore në këto zona janë të ndryshme dhe përfshijnë kultivimin e varieteteve të ndryshme të drithërave, frutave dhe perimeve, duke përfshirë edhe vreshtat, ndërsa në blegtori lloje të ndryshme të kafshëve dhe zogjve janë edukuar për nevojat e produkteve të industrisë së qumështit dhe mishit dhe tregjeve të tyre. Duke marrë parasysh konfigurimin malor të rajonit dhe pasurinë natyrore në pyje dhe livadhe kapacitetet e mjaftueshme në blegtori, rajoni perëndimor është i njohur tradicionalisht edhe për kultivimin e bletarisë dhe nxjerrjen e mjaltit, si dhe industrinë e përpunimit të mishit, cila në vitet e fundit po zhvillohet dukshem. Ekziston gjithashtu një potencial i madh në arborikulturë, e cila po rritet dhe është një nga furnizuesit kryesorë të tregut të Kosovës me mollë. Pemishte ekzistuese në Istog dhe zona të reja sipërfaqësore në pjesën e Gjakovës, Pejës, Deçanit dhe Klinës tregojnë se ky rajon është në zhvillim e sipër të këtij sektori, duke zëvendësuar produktet e eksportit. Në kontrast me rajonet e tjera, rajoni perëndimor dhe komunat e tij janë në një situatë më të mirë në lidhje me ujitjen e tokës bujqësore. Sipas raportit të Agjencisë për mbrojtjen e mjedisit, në Rajonin Zhvillimor Perëndim 22,685 hektarë janë nën sistemin e ujitjes nën menaxhimin e KIR-it "Drini i Bardhë" dhe RIC "Radoniqi-Dukagjini", që është dukshëm më shumë se në rajone të tjera. Megjithatë, në krahasim me sipërfaqen e tokave bujqësore në rajon, zgjerimi dhe modernizimi i këtij rrjeti duhet të mbetet prioritet. Kushtet e volitshme klimatike, dhe relievi i përshtatshëm bëjnë që në rajonin Komunës së Klinës të jenë kushtet optimalë për zhvillimin e bujqësisë. Ky rajon është i njohur për kultivimin e drithërave të bardha, pemëve, perimeve dhe kultivimi i gjedheve. Bletaria po ashtu është mjaft e zhvilluar në këtë rajon.[35]

Blegtoria si indikator i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik zë vend të veçantë në kategorizimin e RZhP, prandaj fondi prej 74952 krerë gjedhe sa ka gjithsejt e kategorizon rajonin si njëri nga më të rendësishmit për zhvillimin e këtij sektori. Nëse e vendosim në raport me numrin e gjedheve në nivel vendi, del se rreth 26% e numrit total të gjedheve janë nga RZhP (Tabelen 34).

[34] Ministria e Zhvillimit Rajonal. *Profilet e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë*. 2019 marrë nga https://ëëë.mbpzhrks.net/repository/docs/REGJISTRIMI_I_BUJQËSISË_NË_REPUBLIKËN_E_KOSOVËS_2014__Rezultatet_Perfundimtare.pdf

[35] Ministria e Zhvillimit Rajonal. *Profilet e Rajoneve Zhvillimore në Kosovë.* 2019

Tabela 34: Fondi blegtoral sipas komunave në Rajonin Zhvillimor Perëndim

Komunat	Gjedhe	Buallica	Dele	Dhi	Derra	Kuaj, gomare dhe mushka	Shpeze	Kafshë të tjera	Koshere bletësh
Deçan	11367	k	3139	216	36	167	29080	k	4366
Gjakovë	17982	k	7322	468	5218	215	262570	130	6355
Istog	15817	k	10055	1153	607	115	75610	98	5420
Junik	1113	-	1000	23	-	10	2740	-	910
Klinë	10474	k	2345	606	4160	56	75240	178	3724
Pejë	18199	17	8599	1420	829	196	90317	k	7223
Gjithsej	**74952**	**17**	**32460**	**3886**	**10850**	**759**	**535557**	**406**	**27998**

3.4.10. Burimet natyrore

Rajoni Zhvillimor Perëndim është i pasur me burime natyrore, vendndodhja gjeografike, toka pjellore dhe kushtet klimatike, veçanërisht në rrafshin e Dukagjinit janë ideale për zhvillimin e hortikulturës, prodhimit të frutave, bletarisë si dhe tokave të punueshme bujqësore. Sipërfaqja e tokës së punueshme paraqet një potencial të madh për zhvillimin e bujqësisë. Rajoni zhvillimor perëndim ka një numër te konsideru-eshëm te liqeneve si; liqeni i Radoniqit dhe Erenikut në Komunën e Gjakovës, dy liqenet natyrale te Gjeravicës në Junik, liqeni i Liqenatit dhe liqeni i Drelajve në komunën Pejë si dhe Liqeni i pafund, Liqeni leqe leqe dhe Liqeni i Gjorvices në Deçan. Pasuritë e tjera ujore të këtij rajoni janë numri i madh i lumenjve si: Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, lumi Klina, lumi Mirusha, lumi i Istogut, lumi i Erenikut, lumi i Lloqanit etj. Parku kombëtar i "Bjeshkëve të Nemuna" është një ndër pasuritë më të mëdha të rajonit perëndim. Shtrihet në 5 komunat e rajonit perëndim. Përveç kësaj, ka edhe rezerva të linjitit në komunën e Istogut, me një sipërfaqe prej 100 km² dhe me një trashësi prej 30-50 metrash dhe deri në 230 metra thellësi. Gjithashtu ka një sipërfaqe të konsiderueshme pyjesh dhe kullosash që paraqet një potencial të madh për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Komuna Klinës ka resurse natyrore minerale dhe jo mine-rale si: rezerva të linjitit 2 miliardë ton, të xehes së boksitit 2 milionë ton, të argjilës 6.5 milionë ton, të rërës dhe zhavorrit 3.5 milion ton. Përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha në pjesën jugore dhe jug-perëndim të Klinës janë ujëvarat, një bukuri e rrallë natyrore me një botë bimore dhe shtazore shumë të pasur. Ky kompleks përfshinë një sipërfaqe prej 200 hektarë dhe është një zonë e mbrojtur –rezervat me mundësi të mira për zhvillimin e turizmit.[36]

3.4.11. Turizmi

Rajoni Zhvillimor Perëndim ka turizmin si një nga fushat me potencial për zhvillim dhe gjenerim të vendeve të reja të punës në rajonin perëndimor të Kosovës. Degët e turizmit të identifikuara janë turizmi malor me elemente sportive dhe rekreative, kryesisht në Pejë, Deçan, Junik, Gjakovë dhe Istog. Turizmi eksplorues i shpellave (speleologji) është i zhvilluar në Pejë, Gjakovë Deçan dhe Klinë; turizmi shëndetësor dhe i mirëqenies duke filluar nga ujërat termo-minerale në Istog dhe vende të tjera të përshtatshme për zhvillimin e qendrave të rehabilitimit në të gjithë rajonin; ujin, tokën, malin dhe sportet ajrore dhe aktivitetet rekreative për të cilat rajoni perëndimor ofron kushtet më të përshtatshme; agro-turizmi në vende me peizazhe të pasura dhe jetë aktive rurale; dhe gjithashtu ajo me një rëndësi të veçantë, turizmi kulturor dhe trashëgimia. Pavarësisht nga ky potencial për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimit të shërbimeve

[36] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Profilet e Rajoneve në Kosovë*, Prishtinë, Tetor 2019.

të mikpritjes së duhur, të cilat do të mbështesin dhe pasurojnë ofertën turistike, ajo që është arritur deri tani është ende larg realizimit të potencialit të plotë të këtij sektori.[37]

3.4.12. Qyteti i Pejës qender e Rajonit Zhvillior Perëndim[38]

Peja shtrihet në skajin veriperëndimorë të luginës së pëlleshme të Dukagjinit, para grykës piktoreske, nën shpatet e Alpeve shqiptare. Shtrihet në luginën e Lumëbardhit rrethuar me Alpet Shqiptare. Në pjesën veriore kufizohet me shtetin e Malit të zi, në pjesën veriperëndimore me Istogun, në pjesën jugore me Klinën e Deçanin. Klima malore e regjionit të Rugovës karakterizohet me verën e nxehtë e dimrin e ftohtë dhe të gjatë. Është e rëndësishme prania e bollshme e ujit. Reshjet vjetore mesatare janë 1000mm. Pjesa më e madhe e këtyre reshjeve bie në dimër në formë dëbore, por edhe shiut. Dimri i ftohtë dhe i përshtatshëm favorizon zhvillimin e turizmit dimëror, ski, ngjitje dhe atë stacionar. Motivin më të bukur dhe njëherit të veçantë paraqet Gr yka e Rugovës dhe fusha rreth shtratit të Lumëbardhit të Pejës përmes të cilit kalon r ruga e asfaltuar 24 km që të dërgon prej Pejës nëpër Çakor për në Mal të zi. Hapësira rreth shtratit të Lumëbardhit k a pamje grykore në gjatësi prej 20 km, ndërsa pjesa më e bukur e tij, Gryka e Rugovës është e gjatë afër 10 k m. Ajo është e thellë afër 1000m, ashtu që është e klasifikuar në rendin e kanjoneve më të thella në vend dhe në Evropë. Zonë e veçantë në komunën e Pejës e cila është edhe nën mbrojtjen e UNESCO është ”Patriarkana” e Pejës” “Gryka e Rugovës” dhe” Radavci”.

Territori i Pejës ka qenë gjatë historisë së vet, së pari pjesë e Dardanisë Ilire, pastaj në kuadër të Romës, Bizantit, Mesjetë e Serbisë, e më vonë e perandorisë Turke. Për historinë antike të Pejës, rëndësi të madhe ka pasur vendbanimi antik në lokalitetin “Gradina”, që padyshim paraqet vazhdimësinë e vendbanimit të mëparshëm Dardan. Është zbuluar edhe një numër objektesh arkeologjike që na shtynë të konstatojmë se këtu duhet të ketë qenë një qendër administrative municipiale e tërë Rrafshit të Dukagjinit. Në Pejë gjithashtu gjendet edhe terminali doganor apo pika doganore.

Komuna e Pejës njihet e pasur me kullosa verore të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë dhe të turizmit, rrafshit fushorë në juglindje, të pasur me tokë pjellore për zhvillimin e bujqësisë. Krahas sektorëve tjerë ekonomik, kontributi i turizmit dhe agrobiznesit në zhvillimin ekonomik të komunës së Pejës konsiderohet strategjik, përmbajtjesor dhe i prekshëm. Nga 603 km2, po thuaj gjysma e territorit është zonë malore-Rugova, e pasur më pyje e kullosa dhe e përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë.

[37] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020-2030*, Prishtinë 2020.
[38] Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, *Profilet e Komunave të Republikës së Kosovës*, 2017

3.5. Rajoni Zhvillimor Jug

Rajoni Zhvillimor Jug mbulon rreth 2,015.01 km, 18.4 % të sipërfaqes së Kosovës (10,905.25 km^2) 66. Me popullsi prej 409,449 apo 23 % të popullsisë së përgjithshme të Kosovës, dendësia e popullsisë është 202 banorë për km katror në rajonin jug. Ndërsa komunat me popullsinë më të dendur në rajonin jug janë; komuna Mamushë, me popullsi të përgjithshme prej 5874 dhe dendësi prej 537 banorë në 1 km2 pastaj vijon komuna e Prizrenit me 310 banorë në një km^2. Komuna e tretë me radhë është komuna e Rahovecit me 206 në një km^2. Komuna Malishevë ka dendësinë prej 186 banorë ne një km^2 , komuna Suharekë 161 banorë në një km^2 dhe Dragashi 78 ne 1 km^2 . Në rajonin jug, komuna me shtrirjen më të madhe është komuna e Prizrenit me 626.86km^2, komuna e Dragashit me 433.85 km^2 dhe komuna e Suharekës me 361.04 km^2.

Harta 6: Rajoni Zhvillimor Jug

3.5.1. Popullsia

Rajoni zhvillimor jug ka një popullsi që mund të karakterizohet si relativisht e re. Në Rajonin Jug janë 152,368 banorë nën moshën 19 vjeçare. Komuna me numrin më të madh të të rinjëve nën 19 vjeç është komuna e Prizrenit me një numër prej 67,145 apo 35% e popullatës së komunës së Prizrenit. Pastaj vijon komuna Malishevë me një numër prej 24,961 banorë apo 42,80 % e popullsisë së përgjithshme të komunës Malishevë që është komuna me përqindjen më të lartë të popullsisë më të re të rajonit jug. Pastaj kemi Suharekën me 23,875 banorë të moshës nën 19 vjeç apo 39.62 % e popullsisë së komunës. Sa i përket strukturës etnike, rajoni zhvillimor jug karakterizohet si rajon me popullsi të ndryshme etnike. Shumicë janë shqiptarët me 335,075 banorë, Boshnjaket me 21,037 banorë, Turqit me 14,427, RAE 5,835, Serbet 380 dhe të tjerë 10,315. Shtimin më të madh natyror në rajonin jug e ka komuna e Prizrenit me një numër prej 2,210 banorë duke vijuar me Malishevën 945 banorë. Rajoni zhvillimor jug është i përfaqësuar me numër më të madh të femrave prej 254,148 ndërsa meshkuj 190,97.

Tabela 35: Popullsia dhe siperfaqja në rajonin Zhvillimor Jug. Statistikat e Popullsisë nga Vjetari statistikor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2021, vlerësimet e popullësisë 2020.

Rajoni zhvillimor Jug				
	Komunat	**Popullsia**	**Sipërfaqja km^2**	**Dendesia e pop.**
1	Prizren	194581	626.86	310
2	Suharekë	58194	361.04	161
3	Rahovec	57047	275.9	206
4	Malishevë	57261	306.42	186
5	Dragash	33948	433.85	78
6	Mamushë	5874	10.94	537
	Gjithsej	**406905**	**2015.01**	202

3.5.2. Relievi dhe ndërtimi gjeologjik

Rajoni Zhvillimor Jug shtrihet në pjesën jugperëndimore të Kosovës. Kufizohet me Shqipërinë në perëndim, me IRJ Maqedoninë në juglindje, me komunën e Gjakovës në veriperëndim, me Shtimen në verilindje dhe me Shtërpcen në lindje. Rajoni ka një sipërfaqe totale prej 2031 km2 18,66% e territorit të Kosovës dhe përbëhet nga 6 komuna: Prizreni, Dragashi, Suhareka, Malisheva, Rahoveci dhe Mamusha, të cilat dallojnë dukshëm në madhësi - nga më e madhja prej 640 km2 (Prizren.) tek më e vogla prej 12.5 km2 (Mamushë) me katër komunat e mbetura me madhësi mesatare (280-430 km2) për Kosovën.

Topografia është e përzier dhe përfshinë male të larta, kodra, lugina dhe fusha. Lartësia e tokës varion nga rreth 400 deri në 2.750 metra nëpër zonat malore (majat e maleve të Sharrit). Në male ka toka të gjera pyjore dhe disa kullota natyrore me bollëk të kafshëve të egra dhe bimësi.[39]

3.5.3. Klima

Tiparet klimatike të Rajonit Zhvillimor Jug dominohen nga ato që janë karakteristike për klimën mesatare kontinentale (me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë), ka gjithashtu një ndikim të rëndësishëm të klimës më të butë mesdhetare. Temperaturat maksimale gjatë stinës së verës arrijnë mesatarisht 24,6 °C ndërsa temperaturat më të ulëta në janar mesatarisht -10 °C. Reshjet totale variojnë nga 511 mm deri në 1.108 mm në vit. Kushtet klimatike në kombinim me tokat relativisht të mira përbëjnë bazë të mirë për zhvillimin e bujqësisë. Kodrat rrotulluese me ekspozim optimal ndaj diellit bëjnë të mundur ngritjen e vreshtave cilësore.[40]

3.5.4. Ujerat

Rajoni konsiderohet të ketë furnizim adekuat me ujë. Asnjë nga lumenjtë nuk është mjaft i madh për të organizuar lundrim, d.m.th transport lumor për përdorim komercial, por ato mund të përdoren për qëllime turistike ose peshkim. Shumica e lumenjve dhe përrenjve më të vegjël bashkohen me lumin Drini i Bardhë, i cili ka një gjatësi prej 122 km dhe ndodhet në pjesën perëndimore të rajonit. Kjo bën të mundur ujitjen e një pjese të mirë të tokës së punueshme. Për rrjedhojë, një pjesë e konsiderueshme e tokës bujqësore në rajon, mbi 12.500 hektarë, mbulohet nga sistemet e ujitjes. Kjo krahasohet me një total prej rreth 55.000 hektarësh nën ujitje në tërë Kosovën (rreth 23%). Kosova ka një kapacitet nominal të projektuar për ujitje prej 72.440 ha. Një pjesë e konsiderueshme e këtij potenciali të pashfrytëzuar besohet të jetë në Rajonin Ekonomik Jug.[41]

3.5.5. Tokat dhe Vegjetacioni

Rajoni Zhvillimor Jug ka një sipërfaqe të shfrytëzuar të tokës bujqësore prej 95,108.77 hektarë, nga kjo sipërfaqe komuna e Dragashit ka sipërfaqen më të madhe në rajonin jug me 27,662.24 hektarë, pastaj është komuna e Prizrenit me 21,777.01 hektarë dhe komuna e Suharekës 15,069.96 hektarë. Tokë e punueshme ara në rajonin jug në total janë 31,396.26 hektarë nga kjo sipërfaqe më së shumti tokë të punueshme ara ka komuna e Rahovecit me 9,186.14 hektarë,

[39] Qendra për Zhvillim Rajonal Jug, *Strategjia Zhvillimore Jug 2010-2013.*
[40] Po aty.
[41] Po aty.

pastaj është komuna e Malishevës me 8,939.2 hektarë dhe komuna e Suharekës me 6,246.18 hektarë. Sa i përket sipërfaqes me livadhe dhe kullosa, rajoni zhvillimor jug ka një sipërfaqe prej 59,748.79, nga kjo sipërfaqe komuna e Dragashit ka livadhe dhe kullosa nje sipërfaqe prej 27,221.10 hektarë, pastaj komuna e Prizrenit 15,677.14 hektarë dhe komuna e Suharekës me 8,010.23 hektarë.[42]

3.5.6. Arsimi

Sipas statistikave të arsimit publik 2020-2021 numri i shkollave në Rajonin Zhvillimor Jug në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 209, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë është 27. Numri i nxënësve në Rajonin Zhvillimor Jug në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 46244 ndërsa në atë të mesëm të lartë 13171. Numri i nxënësve ne arsimin e mesëm të lartë është 13171 nga ta 6719 ose 51.01 % janë në shkollat profesionale.

Tabela 36: Statistikat e arsimit parauniversitar. Burimi: Statistikat e arsimit në Kosove 2020/2021

	Numri i Institucioneve	Nxënës			Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli ndimës
	Publik			Privat	Publik		
Parashkollor/ qerdhe	6	0<5 vjec	315	357	17	307	662
		5<6 vjec	4215	279			
Fillor dhe i mesëm i ulët	209	46244		1139	4756		
I mesëm i Lartë	27	13171		579	1049		

Një nga faktorët me rëndësi në përcaktimin e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar rajonal është edhe analiza e të dhënave për nivelin e shkollimit të popullatës. Struktura arsimore paraqet një bazë të rëndësishme të resurseve humane me ndikim në zhvillimin socio-ekonomik.[43]

Tabela 37: Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Jug. Regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës

Niveli i shkollimit në Rajonin Zhvillimor Jug	Numri i popullatës sipas nivelit të shkollimit	% popullatës sipas nivelit të shkollimit
Diplomë pasuniversitare	1222	0.4
Te diplomuar	17167	4.9
Arsimi i mesëm i lartë	65629	18.9
Arsimi i mesëm i ulët	142731	41.3
Shkollë fillore	60952	17.6
Pa përfunduar shkollimin fillor	29297	8.5
Dine shkrim lexim	18993	5.5
Nuk dinë shkrim lexim	103304	2.9

[42] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Profilet e Rajoneve në Kosovë*, Prishtinë 2019.

[43] Në këtë pjesë është analizuar numri i popullsisë mbi 10 vjeç sipas nivelit të shkollimit. Të dhënat e ofruara në tabelen 37 si më poshtë janë të dhëna janë marrë nga regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Poashtu këto të dhëna mund edhe të rifreskohen me regjistrimin e ri të popullsisë që pritet të realizohet gjatë këtij viti (2021).

3.5.7. Infrastruktura

Rajoni Zhvillimor Jug karakterizohet si rajoni me një nga rrjetet më të zhvilluara të rrugëve lokale, rajonale dhe magjistrale. Në rajonin jug kalon autostrada Prishtinë-Tiranë e cila është një autostradë me standarde evropiane. Autostrada lidh Kosovën dhe shtetet e rajonit me portin e Durrësit. Është një linjë strategjike për zhvillimin e transportit detar me atë rrugor, një segment mjaft i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Në rajonin jug ekziston vetëm një linjë hekurudhore në rrjetin hekurudhor të Kosovës. Kjo është linja që kalon nga Prizreni nëpër Xërxë dhe Klinë për në Fushë Kosovë. Infra-struktura lokale është zhvilluar dukshëm në rajonin jug viteve të fundit. Informatat për rrugët lokale, pasisja me ndriqim e tyre, përfshirja në sistemin e ujit te pijshëm dhe kalanizimit informatat e hollësioshme janë të ofmruara në Tabelen nr. 38 në vijim.

Tabela 38: Infrastruktura në Rajonin Jug sipas komunave. Burimi: Sistemi i Menaxhimit të Përformacës së Komunave. Vlerësimi për vitin 2019

Komuna	Rruget lokale të shtruara ne komuna ne %	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Ekonomitë familjare, instuticionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit në %	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik %
Prizren	60,00	100,00	100,00	36,51
Suharekë	22,56	93,71	99,36	52,08
Rahovec	81,05	97,34	85,81	40,67
Malishevë	91,21	67,91	64,66	22,56
Dragash	/	/	/	//
Mamushë	/	/	/	//

3.5.8. Ekonomia dhe bizneset

Rajoni Zhvillimor Jug ka një infrastrukturë të pëlqyeshme për zhvillimin e kushteve për biznes. Në rajonin zhvillimor jug, janë themeluar disa zona industriale të cilat synojnë të tërheqin investitor dhe biznese në fushën e prodhimit dhe përpunimit. Zonat Ekonomike në rajonin zhvillimor jug janë; Zona industriale në Suharekë gjendet në Shirokë të Suharekës, e cila në lindje është e kufizuar me rrugën ekzistuese Suharekë - Prizren, në jug me rrugën ekzistuese të zonës së vjetër industriale, në perëndim me vreshtat ekzistuese dhe në veri me brezin e gjelbërimit. Veprimtaritë që parashihen të vendosen në zonën industriale janë: Përpunimi i produkteve ushqimore, Përpunimi i prodhimeve nga tekstili dhe lëkura, përpunimi i elementeve nga materiali i aluminit, plastikes dhe drurit, Përpunimi nga qelqi, guri, mermerin dhe hekuri elemente nga betoni, përpunimi i elementeve/teknikes nga elektrikë dhe elektroteknika, etj. Zone tjetër në këtë komunë është Zona Agro - Industriale në Suharekë, është krijuar në vitin 2015 me sipërfaqe prej 28 ha. Zona Agro-industriale gjendet në fshatin Samadraxhë – Suharekë. Kane filluar investimet në këtë zonë ekonomike, fillimisht në energji elektrike dhe ujësjellës. Në zonën ekonomike respektivisht " Zona Agro - Industriale " aktualisht janë nënshkruar tri (3) kontrata si dhe me pesë (5) përfitues të tjerë janë në fazën e nënshkrimit të kontratave. Edhe gjatë këtij viti është duke u vazhduar me investime në infrastrukturë fizike. Komuna e Suharekës pronën që e jep në shfrytëzim afatgjatë në Zona Agro - Industriale në Samadarxhë për bizneset ka planifikuar lehtësira. Komuna e Dragashit edhe pse një komunë e

vogël posedon një zonë ekonomike në Mejdan të fshatit Shajmë. Në rajonin jug janë të regjistruara 23710 biznese, ndërsa llojet e bizneseve përfshijnë nga më të ndryshmet; Biznese Individuale, kompani të huaja, kooperativa bujqësore, ndërmarrje publike, shoqërore, ortakëri, ortakëri te përgjithshme , shoqëri aksionare dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Bizneset individuale kanë numrin më të madh në rajonin jug me një numër prej 20,500 biznese duke vijuar me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara prej 2076 biznese dhe ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 390 biznese.[44]

Në Komunën e Prizrenit, sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 11,788 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 1,603 pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 276 biznese. Komuna e Prizrenit ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 13,731 biznese. Në Komunën e Rahovecit sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 2,870 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 356, pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 47 biznese. Komuna e Rahovecit ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 3,289 biznese. Në Komunën e Suharekës sipas tabelës së mëposhtme, sektori me numrin më të madh të bizneseve është sektori i bizneseve individuale me një numër prej 2,532 biznese duke vijuar me sektorin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara me një numër prej 464 pastaj vijojnë ortakëritë e përgjithshme me një numër prej 31 biznese. Komuna e Suharekës ka një numër të përgjithshëm të bizneseve prej 3,040 biznese. Ndërsa komuna me numrin më të vogël të bizneseve në rajonin jug e ka komuna e Dragashit me një numër të përgjithshëm të bizneseve 1,255, biznese individuale 1,187, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara 49 ortakëri të përgjithshme 11, shoqëri aksionare 1 dhe ndërmarrje shoqërore 1.[45]

Tabela 39: Profilet e aktiviteteve ekonomike dhe numri i tyre, Rajoni zhvillimor Jug.[46]

Komunat	Biznes individual	Kompani e huaj	Kooperativa bujqësore	Ndërrmarje publike	Ndërrmarje shoqërore	Ndërrmarje tjera nën juridiksion të AKM-së	Ortakëri	Ortakëri e përgjithshme	Shoqëri aksionare	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	Totali
Dragash	1,187		6		1			11	1	49	**1,255**
Rahovec	2,870	5	6				2	47	3	356	**3,289**
Prizren	11,788	35	10	1	6		3	276	9	1,603	**13,731**
Malishevë	2,123	6	4					25	3	234	**2,395**
Mamushë	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	**/**
Suharekë	2,532	4	2					31	7	464	**3,040**
Gjithsej	**20,500**	**50**	**28**	**1**	**7**		**5**	**390**	**23**	**2,706**	**23,710**

3.5.9. Bujqësia

[44] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020-2030*, Prishtinë 2020.
[45] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Profilet e Rajoneve në Kosovë*, Prishtinë 2019.
[46] Burimi i satistikave ARBK, viti 2018.

Rajoni Zhvillimor Jug është prodhues kryesor i produkteve bujqësore të cilësisë së lartë në Kosovë. Perimet e kultivuara në këtë pjesë të Kosovës eksportohen edhe në vendet e rajonit, si specat nga rrethi i Krushës, domatet nga Mamusha etj. Gjithashtu perimet tjera, si lakra, trangulli dhe karrota kultivohen me sukses në këtë rajon. Rrethi i Krushës është i njohur edhe për kultivimin e shalqirit. Komuna e Dragashit është e pasur me bimë medicinale dhe aromatike, si dhe me shumëllojshmëri të produkteve pyjore. Më shumë se 90% e këtyre bimëve eksportohen në vendet perëndimore. Gjithashtu në Komunën Dragash është i njohur djathi i Sharrit si brend rajonal përfaqësues i këtij rajoni. Vreshtaria është tipike për këtë rajon dhe meriton kujdes të veçantë. Ky sektor dominon në Rahovec, por gjithashtu shtrihet në komunat e Suharekës dhe Prizrenit. Kushtet e përshtatshme agroklimatike krijojnë potencial të konsiderueshëm për zhvillim të mëtejmë të kultivimit të rrushit dhe prodhimit të verës.

Rajoni Zhvillimor Jug ka një sipërfaqe të shfrytëzuar të tokës bujqësore prej 95,108.77 hektarë, nga kjo sipërfaqe komuna e Dragashit ka sipërfaqen më të madhe në rajonin jug me 27,662.24 hektarë, pastaj është komuna e Prizrenit me 21,777.01 hektarë dhe komuna e Suharekës 15,069.96 hektarë.

Tokë e punueshme ara në rajonin jug në total janë 31,396.26 hektarë nga kjo sipërfaqe më së shumti tokë të punueshme ara ka komuna e Rahovecit me 9,186.14 hektarë, pastaj është komuna e Malishevës me 8,939.2 hektarë dhe komuna e Suharekës me 6,246.18 hektarë. Sa i përket sipërfaqes me livadhe dhe kullosa, rajoni zhvillimor jug ka një sipërfaqe prej 59,748.79, nga kjo sipërfaqe komuna e Dragashit ka livadhe dhe kullosa nje sipërfaqe prej 27,221.10 hektarë, pastaj komuna e Prizrenit 15,677.14 hektarë dhe komuna e Suharekës me 8,010.23 hektarë.[47]

Tabela 40: Numri i ekonomive familjare dhe sipërfaqet bujqësore në Rajonin Zhvillimor Jug

KOMUNAT	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore/ Sipërfaqja ha	Tokë e punueshme-Arat/Sipërfaqja ha	Kopshte	Livadhet dhe kullotat/Sipërfaqja ha	Tokë bujqësore e papërdorur Sipërfaqja ha	Toka pyjore/Sipërfaqja ha	Toka jobujqësore/Sipërfaqja ha
Prizren	21,777.01	5,704.71	46.28	15,677.14	671.11	2,194.89	538.38
Dragash	27,662.24	386.80	17.03	27,221.10	407.89	439.14	199.23
Malishevë	14,908.79	8,939.2	52.3	5,690.23	963.94	4,456.5	957.78
Mamushë	1,229.19	933.23	2.78	269.32	4.38	470	25.55
Rahovec	14,461.58	9,186.14	12.58	2,880.77	1,733.91	1,849.12	576.15
Suharekë	15,069.96	6,246.18	78.10	8,010.23	1,433.11	3,970.74	676.82
GJITHESEJT	**95,108.77**	**31,396.26**	**209.07**	**59,748.79**	**5,214.34**	**13,380.39**	**2,973.91**

Blegtoria si indikator i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik zë vend të veçant në kategorizimin e RZhJ, prandaj fondi prej 56626 krerë gjedhe sa ka gjithësejtë e kategorizon Rajonin si njëri nga më të rendësishmit për zhvillimin e këtij sektori. Nëse e vendosim në raport me numrin e gjedheve në nivel vendi, del se rreth 18% e numrit total të gjedheve janë nga RZhP.

[47] Ministria e Zhvillimit Rajonal, Profilet e rajoneve Zhvillimore në Kosovë, Prishtinë, Tetor 2019

Tabela 41: Fondi blegtoral sipas komunave në Rajonin zhvillimor Jug

Komunat	Gjedhe	Buallica	Dele	Dhi	Derra	Kuaj, gomare dhe mushka	Shpeze	Kafshë të tjera	Koshere bletësh
Prizren	12701	-	22809	1493	912	381	111006	k	4435
Suharekë	10884	-	4609	1253	85	111	104926	k	7574
Rahovec	9854	13	7102	1049	122	51	129413	k	3992
Malishevë	15537	k	7363	3040	-	17	93007	k	4212
Dragash	6572	k	13820	k	-	266	25720	k	3925
Mamushë	1078	-	438	k	-	-	4262	-	88
Gjithsej	56626	13	56141	6835	1119	826	468334	0	24226

3.5.10. Papunësia dhe Punësimi

Rajoni Zhvillimor Jug ka burime të mjaftueshme njerëzore për tregun e punës dhe një fuqi punëtore relativisht në moshë të re dhe të kualifikuar. Sa i përket punësimit në sektorin publik mund të themi se në rajonin jug kryeson Komuna e Prizrenit me numrin më të madh të punësuarve në këtë sektor. Bazuar në raportin e punësimit për vitin 2020, mund të themi se rajoni zhvillimor jug ka një numër prej 35,554 të punëkërkuesve dhe një ofertë prej 2,204 vendeve të lira të punës, ku shihet përsëri një diferencë të madhe mes kërkesës dhe ofertës. Komuna me numrin më të madh të punëkërkuesve është Komuna e Prizrenit me një numër prej 17,809 punëkërkuesve dhe një ofertë pune prej 735 vendeve të lira të punës,vijon Komuna e Suharekës me një numër prej 5,180 punëkërkuesve dhe një ofertë prej 295 vendeve të lira për punë , Komuna e Malishevës me një numër të punëkërkuesve prej 5,177 dhe një ofertë prej 537 vendeve të lira të punës, Komuna e Dragashit me 3,536 punëkërkues dhe Komuna Rahovecit me një numër prej 3,615 punëkërkuesve. Komuna me numrin më të vogël të punëkërkuesve është Komuna Mamushë me një numër prej 237 punëkërkuesve dhe me asnjë ofertë të vendeve të lira të punës.[48]

Tabela 42: Papunësia dhe vendet e lira te punës në Rajonin Zhvillimor Jug për vitin 2020.

Komuna	Papunësia	Vendet e lira të rregulla të punës	Vendet e lira te PATP
Prizren	17,809	196	539
Suharekë	5,180	6	289
Rahovec	3,615	346	99
Malishevë	5,177	75	462
Dragash	3,536	13	179
Mamushë	237	-	-
Gjithsej	35554	636	1568

3.5.11. Burimet natyrore

[48] Agjencioni i Punësimit i Republikës së Kosovës, *Punësimi dhe Aftësimi Profesional për vitin 2020*, Prishtinë 2021

Rajoni zhvillimor jug ka përqindje të madhe të tokës me cilësi të mirë, kushte të favorshme klimatike, të cilat në kombinim me mundësitë e përparimit të mëtejshëm të ujitjes, e bëjnë rajonin të përshtatshëm për zhvillimin e integruar të bujqësisë. Ujërat në rajonin jug duke përfshire lumenjtë dhe liqenet janë burime të çmueshme të këtj rajoni, shumica e lumenjve derdhen në lumin Drini i Bardhë, i cili rrjedh në një gjatësi prej 122 kilometrash në pjesën perëndimore të rajonit. Liqejë të vegjël natyror në këtë rajon janë Liqeni i Livadices, Liqeni i Jazhinces, Liqeni i Dragaqines. Ky rajon është i njohur për gurët gëlqeror, gurët gëlqerore paraqiten në ato të kuq dhe murrmë, gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerorëve mendohet të ketë një volum prej 382.913 m3. Mineralet si Kobalti, Nikeli dhe Bakri gjinden në rrethinën e Gurit te Kuq ku është konstatuar shtresa e xeheroreve të Nikel-Kobaltit. Minerali i Kromit mendohet që gjendet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradisht, lugina e përroit Rimnik. [49]

3.5.12. Turizmi

Turizmi; Rajoni Zhvillimor Jug ka një potencial të madh turistik që ende mbetet relativisht i pashfrytëzuar. Pozita specifike, gjeografike, pasuritë natyrore, shembuj të shumtë të trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe folklori i 24 larmishëm, e bëjnë rajonin jug një vend ideal për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Ekziston një potencial i madh për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit malor dhe kampimit gjatë fundjavave. Zhvillimi i turizmit duke përfshirë turizmin rural mund të bëhet një burim i rëndësishëm i mirëqenies për një pjesë të popullsisë në rritje të rajonit. Ky rajon ka një potencial të madh turistik që ende mbetet relativisht i pashfrytëzuar. Komuna e Prizrenit është një xhevahir i turizmit që përbën edhe njërën nga fushat e zhvillimit të komunës së Prizrenit. Prizreni është një ndër qytetet strategjike turistike për vizitorë të huaj dhe vendor. Malet e Sharrit përmbajnë qindra metra të zonave të cilat nuk shfrytëzohen plotësisht dhe paraqesin potencial të madh për zhvillimin e turizmit dimëror. Malet e Koretnikut dhe të Pashtrikut kanë potenciale të mëdha natyrore për zhvillimin e turizmit malor, si alpinizmi dhe gjuetia, sikurse dhe lumenjtë e shumtë në rajon që ofrojnë mundësinë e zhvillimit të sporteve ujore dhe të peshkimit. Festivalet dhe organizimet e ndryshme kulturore dhe artistike dhe panaire agro-biznesi janë tipike për këtë rajon dhe tërheqin shumë vizitorë vendor dhe të huaj.[50]

5.3.13. Qyteti I Prizrenit qender e Rajonit Zhvillimor Jug

Prizreni shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit me sipërfaqe prej 603 km2. Kufizohet me komunat: Gjakovë, Rahovec, Suharekë, Shtërpcë dhe Dragash, si dhe me shtetin e Shqipërisë dhe Maqedonisë. Rrafshi i Prizrenit gjendet në lartësi mbidetare rreth 400 metra dhe disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë 2000 metra lartësi mbidetare. Klima e qytetit është e llojllojshme. Në viset e ulëta, për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verave shumë të nxehta, të korrat janë ndër të parat në Evropën juglindore me përparësitë e pakrasuheshme për kulturat bujqësore, si: Hardhija e rrushit, pemët dhe perimet. Në viset malore, dominon klima e alpeve, për ç'arsye deri në qershor nëpër gropa mbeten sasitë e borës me ç'rast në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve.

Prizreni është një nga qytetet më të vjetra në Evropën Juglindore që gjendet rrezë Maleve të Sharrit dhe përgjatë Lumit Lumbardhë. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë për ekzistencën e

[49] Ministria e Zhvillimit Rajonal, *Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020-2030*, Prishtinë 2020.
[50] Po aty.

një jete aktive në territorin e Prizrenit të sotëm qysh në antikitet. Në këtë trevë banonin një popullsi e pastër ilire - Dardanët. Në shekullin XIX Prizreni ishte qendra e dytë më e rëndësishme ekonomiko-tregtare e trojeve shqiptare me rreth 1.500 dyqane. Prizreni zë një vend të veçantë në historinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, u bë kryeqendër e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që u themelua me 10 Qershor 1878. Në Prizren, pati selinë e saj edhe Qeveria e Përkohshme Shqiptare (1881) e kryesuar nga Ymer Prizreni. Pas luftës së dytë e deri më 1947, Prizreni ishte qendra e Qarkut Autonom të Kosovës. Në fund të viteve të 50-ta deri në mesin e viteve të 60-ta nga Prizreni u shpërngulën mbi 3.200 familje në Turqi.

Ekonomia e komunës së Prizrenit është kryesisht bazuar në bujqësi, tregti, ndërtim dhe përpunimit të ushqimit - të gjitha ndërmarrje private. Vlerat natyrore me të cilat posedon Kosova, paraqesin burime të turizmit të nivelit të lartë. Sektori bujqësor mbetet një nga burimet kryesore të punësimit dhe të ardhurave. Prizreni ka qenë i njohur për kah pemëtaria, perimtaria dhe verërat.[51]

[51] Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, *Profilet e Komunave të Republikës së Kosovës*, 2017

4. Treguesit e matjes së shkallës së zhvillimit socio-ekonomik rajonal në Kosovë

Qëllimi kryesor i realizimit të këtij studimi është definimi i fushave, treguesve qëllimit të tyre dhe burimeve të informacionit. Trajtimi i tyre gjithashtu është në harmoni me mandatin e MZHR për planifikimin dhe zhvillimin e treguesve për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik të balancuar rajonal, dhe ndërlidhjen e tyre me përgatitjen e analizave lidhur me zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar[52].

Trajtimi dhe definimi i të gjitha fushave dhe treguesve, ndërlidhet edhe qëllimin e MZHR që ka të bëjë me pasqyrimin sa më të drejtë dhe real të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë. Siç e kemi permend edhe në fillim, zhvillimi socio-ekonomik rajonal, tejkalon kometencat e komunave dhe ndërlidhet më shumë me nivelin qendror. Zhvillimi socio – ekonomik rajonal i balancuar, nuk kufizohet në nivelin e zhvillimit ekonomik lokal, por e tejkalon atë duke pasqyruar edhe zhvillimin e sektorëve dhe projekteve të zhvilluara në dy e më shumë komuna. Fushat tematike dhe treguesit që pasqyrojnë situatën sa më reale të zhvillimit socio-ekonomik në rajonet e Kosovës janë të shumtë dhe të ndërlidhur reciprokisht mes veti. Kjo trgon për një varësi reciproke që kanë fushat tematike duke kushtëzuar njëra tjetrën në njërën anë, dhe në anën tjetër, ato përcillen edhe me efekte të ndryshme. Dihet se rajonet e Kosovës kanë karakteristikat e veta që dallojn si në aspektin territorial, demografik, social, ekonomik, mjedisor, të infrastrukturës etj. Këto dallime duhet evidentuar me saktësi përmes treguesve të matshëm. Rëndësia qëndron në faktin se këta tregues sipas fushave të ndryshme japin mundësin e përcjelljës së trendeve zhvillimore në rajonet e Kosovës dhe këtu mund të planifikohen edhe masat dhe nevojat për përmirësimin e gjendjes. Dihet se dallimet mes rajoneve janë edhe në fusha specifike, andaj është me rëndësi të evidentohet dhe përcillet secila fushë për secilin rajon. Kjo mundëson edhe planifikimin e investimeve dhe prioritetet sipas fushave në rajone të ndryshme në Kosovë. Në këtë dokument janë përcaktuar fushat kryesore që pasqyrojnë shkallën e zhvillimit socio-ekonomik në rajonet e Kosovës. Fillimisht është trajtur fusha e demografisë, ku janë paraqit treguesit që përcaktojnë trendet e zhvillimit demografik rajonal. Kjo paraqet një rëndësi të veçantë nga fakti se planifikimi i zhvillimeve duhet të bëhet për njerëzit në rradh të parë, andaj është me rëndësi që të kemi të dhëna të sakta rreth numrit të popullsisë, dendësisë, rritjës, strukturave dhe karakteristikave të tjera demografike në nivel të rajoneve. Bazuar në të dhënat demografike, mund të analizohen edhe nevojat dhe kërkesat bazë. Fusha e zhvillimit social paraqet çështje me rëndësi në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve të Kosovës. Analiza e gjendjes arsimore, shëndetësisë, papunësisë dhe punësimit, shkallës së varfërisë, barazisë gjinore, si dhe nivelit të zhvillimit të kulturës, rinisë e sportit, janë tema kyçe në përcaktimin dhe analizën e zhvillimit të balancuar sociale dhe ekonomik. Niveli i zhvillimit ekonomik rajonal përcakton edhe shkallën e përgjithshme të zhvillimit dhe përcjellja e trendeve të zhvillimit poashtu mundëson evidentimin e dallimeve mes rajoneve të Kosovës. Edhe në fushën e zhvillimit ekonomik janë definuar treguesit e matshëm që përcaktojnë dallimet dhe zhvillimin e balancuar. Infrastruktura paraqet një bazë të rëndësishme në aspektin e zhvillimit socio-ekonomik, andaj trajtimi i trguesve që përcaktojnë dallimet rajonale sa i përket infrastrukturës, mundëson edhe evidentimin e kërkesave dhe nevojave për zhvillim të balancuar rajonal të infrastrukturë.

Për të bërë një përmbledhje gjithpërfshirëse të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar në rajonet e Kosovës, në këtë dokument janë përmbledhë pesë fusha kryesore që do të tajtohen me tregues, rezultate dhe të dhëna konrete si:

1. Demografia
2. Arsimi
3. Shëndetësia
4. Papunësia dhe punësimi

[52] Shtojca 21 e Rregullores Nr. 16/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2011, Rregulloren Nr. 14/2011 dhe Rregulloren Nr. 15/2011, Gazeta Zyrtare Nr. 29, dt. 23 Nëntor 2017, Prishtinë

5. Varfëria dhe asistenca sociale
6. Kultura, rinia dhe sporti
7. Veprimtaritë ekonomike
8. Tregëtia
9. Bujqësia
10. Industia
11. Xehtaria dhe Minierat
12. Infrastruktura
13. Projekte Kapitale
14. Turizmi

Përmes këtyre fushave të veprimit do të paraqitet zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar ndërmjet rajoneve zhvillimore në Kosovë. Për të analizuar në mënyrë sa më detaje secilën fushë në rajonet e Kosovës, janë përcaktur rezultatet, treguesit dhe të dhënat që duhet të sigurohen për një pasqyrim sa më real të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar në rajonet e Kosovës.

Ky dokument trajton 14 fusha për secilin rajon zhvillimor ndërsa përformanca e tyre do të matet përmes 93 treguesve të prezantuar në tablelën si më poshtë.

Në vazhdim po i paraqesim treguesit, rezultatet dhe të dhënat që janë bërë duke marrë parasysh elementet në vijim:

- treguesi: mjetin përmes të cilin do të matet apo vlerësohet gjëndja aktuale në fushën përkatës sipas rajonit Zhvillimor. Përmes treguesve mund të bëhet krahasimi i gjendjes aktuale në fushën e caktuar sipas mes të rajoneve dhe krahasimi i zhvillimit ndër vite.
- Qëllimi i Treguesit: tregon atë qfarë ka synim të vlerësojë apo mat treguesi përkatës.
- të dhënat: të cilat kontribuojnë që treguesin e bëjnë të matshëm.
- Burimi i informacionit: tregon institucionin nga i cili burojnë të dhënat, apo përmes të cilit mund të merren ato.

Treguesit dhe të dhënat që planifikohet të grumbullohen, analizohen dhe paraqiten në nivel rajonal, janë të shumta dhe bazuar në fushat e veprimit, këto të dhëna janë ndër më të ndryshmet. Andaj, për sigurimin e tyre kërkohet një bashkëpunim me institucione qëndrore dhe lokale. Varësisht se për cilën fushë bëhet grumbullimi i të dhënave, bashkëpunimi duhet të orjentohet me Ministrit, Agjencit dhe institucionet tjera të linjave përkatëse.

Në tabelën në vijim paraqiten të definuara dhe ndërlidhura: fushat, treguesit, qellimi të dhënat dhe burimet e informacionit.

1. Treguesit e Demografisë			
Treguesi	**Qellimi i treguesit**	**Të dhënat**	– **Burimi i të dhënave/informacionit**
1.1 Numri i banorëve sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i numrit të përgjithshëm të popullësisë që jetojnë në rajonet e Kosovës që mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik bazuar në resurset humane	– Numri i banorëve në vitin aktual sipas rajoneve	Agjencia e Statistikave të Kosovës Komunat
1.2 Numri i banorëve që jetojnë në fshat dhe qytet sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i numrit të popullësisë që mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik përmes sektorëve që mund të zhvillohen në zona rurale apo urbane	– Numri i banorëve që jetojnë në zona rurale – Numri i banorëve që jetojnë në zona urbane në secilin rajon zhvillimor	Agjencia e Statistikave të Kosovës Komunat
1.3 Numri i vendbanimeve sipas rajoneve zhvillimore	Dallimet në numrin e vendbanimeve sipas rajoneve dhe shkalla e urbanizimit	– Numri i vendbanimeve sipas rajoneve zhvillimore	Agjencia e Statistikave të Kosovës Komunat
1.4 Numri i popullsisë për km2 sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i dendësisë së popullësisë në rajonet zhvillimore	– Numri i banorëve që jetojnë në secilin rajon zhvillimor – numri i kilometrave katrorë në secilin rajon	Agjencia e Statistikave Komunat ë Kosovës Komunat
1.5 Shkalla e natalitetit sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i shkallës së natalitetit sipas rajoneve zhvillimore	– Numri i lindjeve brenda një viti sipas rajonit – Numri i përgjithshëm i banorëve sipas rajoneve	Agjencia e Statistikave të Kosovës Komunat
1.6 Shkalla e mortalitetit sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i shkallës së mortalitetit sipas rajoneve zhvillimore	– Numri i vdekjeve brenda vitit sipas rajoneve – Numri i përgjithshëm i banorëve sipas rajoneve	Agjencia e Statistikave të Kosovës Komunat
1.7 Përqindja e shtimit natyror të popullsisë	Pasqyrimi i shkallës së shtimit natyror sipas rajoneve zhvillimore	– Numri i banorëve në fund të vitit paraprak – Numri i lindjeve gjatë vitit të vlerësimit – Numri i lindjëve gjatë vititi të vlerësimit	Agjencia e Statistikave të Kosovës Komunat
1.8 Numri i popullsisë sipas grupmoshave dhe gjinisë	Sigurimi dhe pasqyrimi i numrit të banorëve sipas moshës dhe gjinisë	– Numri i banorëve sipas seciles grupmoshë – Numri i banorëve sipas seciles gjini	Agjencia e Statistikave të Kosovës Komunat

1.9	Niveli i shkollimit sipas rajoneve	Pasqyrimi i nivelit arsimor të popullsisë sipas rajoneve	– Numri i popullsisë mbi 10 vjeç sipas nivelit të shkollimit sipas rajoneve	Agjencia e Statistikave të Kosovës
1.10	Numri i banorëve sipas grupeve etnike	Pasqyrimi i strukturës etnike të popullsisë nëpër rajone	– Numri I përgjithshëm i banorëve sipas rajoneve – Numri i banorëve sipas grupeve etnike sipas rajoneve	Agjencia e Statistikave të Kosovës
1.11	Numri i popullsisë sipas përkatësisë fetare	Pasqyrimi i strukturës fetare e popullsisë nëpër rajone	– Numri I përgjithshëm i banorëve sipas rajoneve – Numri i popullsisë sipas përkatësisë fetare në rajone	Agjencia e Statistikave të Kosovës
1.12	Numri i popullsisë aktive dhe joaktive	Pasqyrimi i popullsësisë aktive apo asaj që është pjesë e fuqisë punëtore dhe joaktive (qe nuk konsiderohet si pjesë e fuqisë punëtorë) të popullsisë nëpër rajone	– Numri i popullsisë aktive në secilin rajon zhvillimor – Numri i popullsisë joaktive në secilin rajon zhvillimor	Agjencia e Statistikave të Kosovës
1.13	Mesatarja e numrit të anëtarëve në familje sipas rajoneve	Pasqyron madhësinë e familjëve sipas rajoneve	– Numri i përgjithshëm i banorëve sipas rajoneve – Numri i familjheve sipas rajoneve zhvillimore	Agjencia e Statistikave të Kosovës
1.14	Numri i qytetarëve që kanë lëshuar vendin gjatë vitit	Paraqitja e trendit të lëvizjeve të qytetarëve jashtë vendit sipas rajoneve zhvillimore	– Numri i qytetarëve që kanë lëshuar vendin gjatë vitit sipas rajoneve zhvillimore	MPB Komunat Agjencia e Statistikave të Kosovës
2. Treguesit e Arsimit				
2.1	Numri i objekteve shkollore sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i gjendjes aktuale me objekte shkollore në të gjitha nivelet e arsimit para universitar sipas rajoneve	- Numri i objekteve shkollore sipas rejoneve	MASHT
2.2	Numri i nxënësve në arsimin publik – niveli parafillor	Ofrimi i statistikave dhe pasqyrimi i trendit të regjistrimit të fëmijëve në arsimin parafillor sipas rajoneve zhvillimore	- Numri i nxënësve në arsimin publik – niveli parafillor sipas rejoneve	ASK MASHT Komunat
2.3	Numri i nxënësve në arsimin publik fillor të mesëm të ulët	Ofrimi i statistikave dhe pasqyrimi i trendit të regjistrimit të nxënësve në arsimin fillor të mesëm të ulët sipas rajoneve zhvillimore	- Numri i nxënësve në arsimin fillor të mesëm të ulët sipas rejoneve	ASK MASHT Komunat

2.4	Numri i nxënësve në arsimin publik të mesëm të lartë	Ofrimi i statistikave dhe pasqyrimi i trendit të regjistrimit të nxënësve në arsimin fillor të mesëm të lartë sipas rajoneve zhvillimore	- Numri i nxënësve në arsimin fillor të mesëm të lartë sipas rejoneve	ASK MASHT Komunat
2.5	Numri i personelit arsimor në arsimin publik parauniversitar	Pasqyrimi i numrit të personelit arsimor në arsimin parauniversitar sipas rajoneve	- Numri i mësimdhënësve në arsmin parauniversitar në sektorin publik sipas rejoneve	ASK MASHT Komunat
2.6	Numri i personelit adminsitrativ dhe ndihmës arsimor në arsimin parauniversitar	Pasqyrimi i numrit të personelit administrativ dhe ndihmës në arsimin parauniversitar	- Numri i personelit administrativ - Numri I personetol ndihmës në arsmin parauniversitar në sektorin publik	ASK MASHT Komunat
2.7	Numri i nxënësve në arsimin paraunivesitar privat	Pasqyrimi i numrit të nxënësvenë arsimin parauniversitar privat	- Numri i nxënësve në arsimin privat si në nivelin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe fillor të mesëm të lartë	ASK Komunat MASHT
2.8	Numri i studentëve të regjistruar në universitete publike sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i numrit të studentëve në nivelin bachelor dhe master sipas rajoneve zhvillimore	- Numri i studentëve në nivelin bachelor - Numri i studentëve në nivelin master sipas universiteteve publike	MASHT ASK
2.9	Numri i studentëve të diplomuar në universitete publike sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i numrit të studentëve që kanë diplomuar në nivelin bachelor dhe master nga universitetet publike.	- Numri i studentëve të diplomuar në nivelin bachelor sipas rajoneve - Numri i studentëve të diplomuar në nivelin master sipas rajoneve	MASHT ASK
2.10	Numri i studentëve të regjistruar në kolegjet private në Kosovë sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i numrit të studentëve të regjistruar në nivelin bachelor dhe master në kolegjet private sipas rajoneve	- Numri i studentëve te regjistruar në nivelin bachelor - Numri i studentëve te regjistruar në nivelin master në kolegjet private sipas rajoneve	MASHT ASK
2.11	Numri i studentëve të diplomuar në kolegjet private në Kosovë sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i numrit të studentëve të diplomuar në nivelin bachelor dhe master në kolegjet private sipas rajoneve	- Numri i studentëve të diplomuar në nivelin bachelor - Numri i studentëve të diplomuar në nivelin master sipas kolegjeve private sipas rajoneve	MASHT ASK
3. Treguesit e Shendetsisë				
3.1	Numri i objekteve shëndetësore (QKMF, QMF dhe Ambulanta)	Pasqyrimi i numrit të objekteve shëndetësore sipas rajoneve në Kosovë	- Numri i objekteve shëndetësore dhe kategorizimi i tyre sipas llojeve për secilin rajon	MSH Komunat

3.2	Numri i mjekëve dhe infermierëve sipas rajoneve	Pasqyrimi i përsonelit shëndetësor dhe sipas rajoneve zhvillimore	- Numri i mjekeve dhe infermierve janë duke kryer shërbime shëndetësore spas rajoneve zhvillimore	MSH Komunat
3.3	Niveli i kualifikimit të mjekëve dhe infermierëve	Pasqyrimi i nivelit të kualifikimit të të mjekëve dhe infermierëve sipas rajoneve zhvillimore	- Numri i mjekëve me kualifikim universitar - Numri i mjekëve me kualifikim pasuniversitar/me specializime - Numri i mjekëve me kualifikim pasuniversitar/doktorature - Numri i infermiereve me kualifikim	MSH Komunat
3.4	Numri dhe lloji i shërbimëve shëndetësore private sipas rajoneve	Pasqyrimi i volumit të shërbimeve shëndetësore private sipas rajoneve	- Numri i shërbimëve shëndetësore private që ofrohen nga sektori privat shëndetsor	Komunat
3.5	Lloji i shërbimëve shëndetësore private sipas rajoneve	Pasqyrimi i llojëve të shërbimeve shëndetësore private sipas rajoneve	- Lista e shërbimeve shëndetësore qe ofrohen nga sektori privat shëndetsor	Komunat
		4. Treguesit e papunësisë dhe punësimit		
4.1	Shkalla e papunësisë sipas rajoneve	Pasqyrimi i shkallës së papunësisë sipas rajoneve në Kosovë	- Numri i punëkërkuesve sipas rajonëve	APRK Zyrat Rajonale dhe komunale të punësimit
4.2	Shkalla e papunësisë sipas gjinisë (%)	Pasqyrimi i shkallës së papunësisë sipas gjinisë në rajonet Zhvillimore në Kosovë	- Numri i punëkërkuesve sipas gjinisë sipas rajonëve	APRK Zyrat Rajonale dhe komunale të punësimit
4.3	Shkalla e papunësisë sipas moshës (%)	Pasqyrimi i shkallës së papunësisë sipas moshës në rajonet Zhvillimore në Kosovë	- Numri i punëkërkuesve sipas moshës sipas rajonëve	APRK Zyrat Rajonale dhe komunale të punësimit
4.4	Niveli i arsimimit dhe kualifikimit të punëkërkuesve (%)	Pasqyrimi i kualifikimit të punëkërkuesve sipas rajonëve në Kosovë	- Numri i punëkërkuesve sipas kualifikimit të tyre dhe rajoneve	APRK Zyrat Rajonale dhe komunale të punësimit
4.5	Shkalla e punësimit (%)	Pasqyrimi i shkallës së punësimit	- Numri i të punësuarve sipas rajoneve	APRK Zyrat Rajonale dhe komunale të punësimit
4.6	Shkalla e punësimit të femrave në institucione të ndryshme sipas rajonit	Pasqyrimi i punësimit sipas gjinisë dhe institucioneve në rajonet e Kosovës	- Numri i femrave të punësuara sipas institucioneve në rajonet përkatëse	Ministria e Puneve të Brendshme
4.7	Numri i personave te certifikuar në lëmit profesionale përmes trajnimeve ose edukimit jo formal për profesionet	Pasqyrimi i shkallës së përgaditjes profesionale sipas nëvojave të tregut të punës	- Numri i personave te certifikuar në lëmit profesionale përmes trajnimeve ose edukimit jo formal për profesionet që vlerësohen si nevojë e tregut të punës	APRK Zyrat Rajonale dhe komunale të punësimit

	që vlerësohen si nevojë e tregut të punës (nga strategjia).			
4.8	Përqindja e subvencioneve në sektorin privat që kontribuojnë në rritjen e punësimit sipas rajoneve (tregues nga Strategjia per ZHR).	Pasqyrimi i subvencioneve që jepen për sektorin privat i cili kontribuon në rritjen e punësimit.	- Shuma monetare e subvencioneve që jepen për sektorin privat i cili kontribuon punësimit sipas rajoneve - Shuma totale e subvencioneve që ofrohen sipas rajoneve?	MZHR MBPZHR Komunat
4.9	Numri i projekteve të realizuara për ngritjen e kapaciteteve për shfrytëzimin e resurseve (tregues nga Strategjia per ZHR)	Pasqyrimi i projekteve të cilat zbatohen për ngritjen e kapacieteve humane dhe OSHC-ve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve që kontribuojne ne zhvillimin socio-ekonomik rajonal	- Numri i projekteve të realizuara për ngritjen e kapacieteve humane dhe OSHC-ve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve që kontribuojne ne zhvillimin socio-ekonomik rajonal	MZHR Komunat ?
5. Varfëria dhe asistenca sociale				
5.1	Shkalla e varfërisë së përgjithshme sipas rajoneve zhvillimore (%)	Paqyrimi i shkallës së varfërisë së përgjithshme sipas rajoneve në Kosovë	- Numri i banorëve që janë të varfër me atë që konsiderohet të jetë standard i kërkesave minimale (Sipas definimit të ASK-së). - Numri i përgjithshëm i banorëve sipas rajoneve.	Agjencioni Statistikor i Kosovës. Zyrat Rajonale dhe komunale të punës dhe mirëqenies sociale
5.2	Shkalla e varfërfërisë së përgjithshme sipas moshës (%)	Pasqyrimi i shkallës së varfërisë së përgjithshmë sipas moshës dhe rajoneve në Kosovë	- Ndarja e banorëve që janë të varfër me atë që konsiderohet të jetë standard i kërkesave minimale sipas moshës	Agjencioni Statistikor i Kosovës. Zyrat Rajonale dhe komunale të punës dhe mirëqenies sociale
5.3	Shkalla e varfërfërisë së përgjithshme sipas gjinisë (%)	Pasqyrimi i shkallës së varfërisë së përgjithshmë sipas gjinisë dhe rajoneve në Kosovë	- Ndarja e banorëve që janë të varfër me atë që konsiderohet të jetë standard i kërkesave minimale sipas gjinisë	Agjencioni Statistikor i Kosovës. Zyrat Rajonale dhe komunale të punës dhe mirëqenies sociale
5.4	Shkalla e varfërisë ekstreme sipas rajoneve zhvillimore (%)	Paqyrimi i shkallës së varfërisë ekstreme sipas rajoneve në Kosovë	- Numri i banorëve qe janë të varfër, pasi nuk mund t'i përmbushin nevojat themelore në ushqim. (Sipas definimit të ASK-së) - Numri i përgjithshëm i banorëve sipas rajoneve.	Agjencioni Statistikor i Kosovës. Zyrat Rajonale dhe komunale të punës dhe mirëqenies sociale
5.5	Shkalla e varfërfërisë ekstreme sipas moshës (%)	Pasqyrimi i shkallës së varfërisë ekstreme sipas moshës dhe rajoneve në Kosovë	- Numri i banorëve qe janë të varfër, pasi nuk mund t'i përmbushin nevojat themelore në ushqim sipas moshës	Agjencioni Statistikor i Kosovës. Zyrat Rajonale dhe komunale të punës dhe mirëqenies sociale

5.6	Shkalla e varfërfërisë ekstreme sipas gjinisë (%)	Pasqyrimi i shkallës së varfërisë eksptreme sipas gjinisë dhe rajoneve në Kosovë	- Numri i banorëve qe janë të varfër, pasi nuk mund t'i përmbushin nevojat themelore në ushqim sipas gjinisë	Agjencioni Statistikor i Kosovës. Zyrat Rajonale dhe komunale të punës dhe mirëqenies sociale
5.7	Përqindja e familjeve që jane me asistencë sociale sipas rajoneve	Pasqyrimi i shkallës së varfërisë sipas pjesmarrjes në asistencë sociale sipas rajoneve	- Numri i familjeve që jane me asistencë sociale sipas rajoneve zhvillimore - Numri i familjeve sipas rajoneve zhvillimore	Agjencioni Statistikor i Kosovës. Zyrat Rajonale dhe komunale të punës dhe mirëqenies sociale
6. Kultura, Rinia dhe Sporti				
6.1	Numri i klubeve sportive sipas rajoneve	Pasqyrimi i sportit në rajonet e Kosovës	- Numri i klubeve sportive sipas rajoneve - Numri i banorëve sipas rajoneve - (*sqarim: llogaritja për këtë tregues dhe treguesit tjerë të kësaj fushe mund të llogaritën në raport numerin e banorëve të rajonit*)	MKRS, komunat
6.2	Numri i fushave sportive sipas rajoneve	Pasqyrimi i sportit në rajonet e Kosovës	- Numri i fushave sportive sipas rajoneve	MKRS, komunat
6.3	Numri i biblotekave sipas rajoneve	Pasqyrimi i biblotekave dhe mundësive që ju jepet qytetarëve për të shfrytëzuar bibliotekat publike sipas rajoneve	- Numri i biblotekave sipas rajoneve	MKRS, komunat
6.4	Numri i librave në bibliotekat publike sipas rajoneve	Pasqyrimi fondit të librave në biblotekat publike sipas rajoneve	- Numri i librave në bibliotekat publike sipas rajoneve	MKRS, komunat
6.5	Numri i lexuesve në bibiliotekat publike sipas rajoneve	Pasqyrimi shkallës së leximit në bibloteka sipas rajoneve	- Numri i lexuesve në bibiliotekat publike sipas rajoneve	MKRS, komunat
6.6	Numri i muzeumeve dhe objekteve tjera të ngjashme sipas rajoneve	Pasqyrimi i objekteve të trashegimisë kulturore	- Numri i muzeumeve dhe objekteve të ngjashme tjera sipas rajoneve	MKRS, komunat
7. Zhvillimit ekonomik dhe Bizneset				
7.1	Bruto produkti vendor sipas rajoneve	Pasqyrimi i përformancës së ekonomisë sipas rajoneve zhvillimore gjatë vitit të vlerësimit	- Të dhënat e bruto produktit vendor sipas rajoneve merren nga ana e ASK-së	Agjencia e Statistikave të Kosovës
7.2	Norma e rritjes reale te BPV-së sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i përformancës së ekonomisë sipas rajoneve zhvillimore gjatë vitit të vlerësimit	- Të dhënat e bruto produktit vendor sipas rajoneve merren nga ana e ASK-së	Agjencia e Statistikave të Kosovës
7.3	Shkalla e investimeve të huaj direkte sipas rajoneve	Pasqyrimi i informatave për investimet e huaja direkte sipas rajoneve zhvillimore gjatë vitit të vlerësimit	- Shumat totale të investimeve të huaja direkte sipas rajoneve	Agjencia e Statistikave të Kosovës

7.4	Numri i bizneseve aktive sipas rajoneve	Pasqyrimi i numrit dhe shprendarjes së bizneseve në nivel të rajoneve	- Numri i bizneseve aktive sipas rajoneve	ARBK ASK
7.5	Numri i të punësuarve në biznese private sipas veprimtarive sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i numrit të punësuarve sipas veprimtarive të cilat ato operojnë	- Numri i të punësuarve në biznese sipas rajoneve - Kërkohet gjithashtu ndarja e bizneseve sipas veprimtarive dhe numri i të punësuarve të tyre.	ARBK ASK
7.6	Vlera e investimeve sipas veprimtarive sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i investimeve kapitale nga ana e bizneseve në nivel rajonal	- Vlera e kapitalit të investuar nga ana e bizneseve - Kërkohet gjithashtu ndarja e bizneseve sipas veprimtarive dhe vlera e investimeve të tyre.	ARBK ATK Komunat
7.7	Numri i bizneseve te përkrahura në zonat ekonomike (nga strategjia)	Pasqyrimi numrit të bizneseve të cilat mbeshteten në zonat ekonomike sipas rajoneve zhvillimore	- Numri i bizneseve të cilat janë përkrahur dhe të cilat janë të shtrira në zonat ekonomike	ARBK ATK Komunat
8. Tregtia				
8.1	Numri i aktiviteteve tregtare	Pasqyrimi i aktiviteteve tregtare në nivel rajonal	- Numri i aktiviteteve tregtare sipas rajoneve	MTI ASK
8.2	Llojet e aktiviteteve tregtare	Pasqyrimi i aktiviteteve tregtare sipas lloijt në nivel rajonal	- Lista e llojeve të aktiviteteve tregtare sipas rajoneve	MTI ASK
8.3	Numri i aktiviteteve tregtare të prodhuara nga procesi i diversifikimit, si dhe ndikimi i tyre në shrirjen e aktiviteteve tregëtare	Pasqyrimi i divesifikimit të aktiviteteve tregëtare në nivel rajonal	- Numri i investimeve në aktiviteteve tregtare të gjeneruara përmes procesit të diversifikimit	MTI ASK Komunat
9. Bujqësia				
9.1	Numri i aktiviteteve bujqësore sipas rajoneve zhvillimore	Pasqyrimi i llojllojshmërisë së aktiviteteve bujqësore sipas rajoneve zhvillimore	- Numri i aktiviteteve bujqësore sipas rajoneve - Lista e aktivitetevë sipas veprimtarive sipas rajoneve	MBPZHR Komunat
9.2	Numri i fermave dhe ekonomive familjare që merren me bujqësi	Pasqyrimi i numrit dhe shprendarjes së fermave dhe ekonomikve familjare qe merren me bujqësi në nivel të rajoneve	- Numri i fermave në nivel të rajoneve - Numri i ekonomive familjare qe merren me bujqësi në nivel të rajoneve	MBPZHR Komunat
9.3	Numri i fermave blegtorale dhe kapaciteti i tyre sipas rajoneve	Pasqyrimi i zhvillimit të blegtorisë nivel rajonal	- Numri i fermave blegtorale dhe kapaciteti i tyre	MBZHRD ASK Komunat
9.4	Sipërfaqet e tokave bujqësore sipas karakterit të shfrytëzimit sipas rajoneve	Paraqitja e informacioneve për llojin e tokave dhe sipërfaqeve bujqësore sipas rajoneve	- Sipërfaqet e tokave bujqësore (në ha) sipas karakterit të shfrytëzimit të tyre	MBZHRD ASK Komunat

9.5	Siperfaqet e pyjeve sipas karakterit të shfrytëzimit	Pasqyrimi i sipërfaqeve pyjore në nivel rajonal	- Sipërfaqet e Pyjeve sipas karakterit të shfrytëzimit	MBZHRD ASK Komunat
10. Industria				
10.1	Numri i aktiviteteve Insutriale	Pasqyrimi i aktiviteteve industriale në nivel rajonal	- Numri i aktiviteteve industriale në nivel të rajoneve	MTI, ASK, Komunat
10.2	Numri i korporatave/bizneseve që merren me Industri	Pasqyrimi i numrit dhe shprendarjes së korporatave dhe bizneseve që merren me industri në nivel të rajoneve	- Numri i korporatave/bizneseve që merren me Industri	MTI, ASK, Komunat
10.3	Vlera e investimeve sipas llojit të industrisë	Pasqyrimi i investimeve kapitale në industri sipas rajoneve	- Vlera e kapitalit të investuar nga ana e bizneseve që merren me Industri - Kërkohet gjithashtu ndarja e bizneseve që merren me industri sipas veprimtarive dhe vlera e investimeve të tyre.	MTI, ASK, Komunat
10.4	Numri dhe madhësia e parcelave kadastrale, si dhe klasifikimi i tyre sipas bonitetit të tokave	Pasqyrimi i sipërfaqës së tokave që shfrytëzohen për nevojat e Industrisë në nivel rajonal	- Numri dhe madhësia e parcelave kadastrale, si dhe klasifikimi i tyre sipas bonitetit të tokave	AKK, MTI, ASK MBZHRD
11. Xhehtaria dhe minierat				
11.1	Numri i minierave dhe xehroreve aktive	Pasqyrimi i shtrirjes së zonave të pasura me xehe, sipas lloit të tyre sipas rajoneve	- Numri i lokacioneve me rezerva minerale sipas rajoneve - Lista e llojeve të xeheve sipas rajoneve	Komisioni për Minjera dhe Minerale Ministria e Zhvillimit Ekonomik
11.2	Sasia e rezervave minerare sipas llojit të mineralit sipas rajoneve	Pasqyrimi shtrirjes së rezervave të mineraleve, sipas lloit të tyre sipas rajoneve	- Sasia e rezervave minerare sipas llojit të mineralit sipas rajoneve	Komisioni për Minjera dhe Minerale. Ministria e Zhvillimit Ekonomik
11.3	Kostja se investimeve për sektrin minerar sipas rajoneve	Pasqyrimi i shpenradjes së investimeve ne sektorin minerar sipas rajoneve zhvillimore.	- Shumat e investimeve për sektrin minerar sipas rajoneve	Komisioni për Minjera dhe Minerale. Ministria e Zhvillimit Ekonomik
12. Infrastruktura				
12.1	Rruget lokale të asfaltuara sipas rajoneve (në %)	Pasqyrimi i cilësisë së infrastrukturës rrugore në nivel lokal sipas rajoneve	- Kilometra rrugë në territorin e rajonit përkatës - Kilometra rrugë të shtruara (gjithsej) në rajonin përkatës - Kilometra rrugë të shtruara për herë të parë gjatë vitit	MAPL (SMPK)

12.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare në zona urbane dhe vendbanime në fshatra	Pasqyrimi i cilësisë së infrastrukturës rrugore në nivel lokal sipas rajoneve	- Kilometra rrugë gjatësi të shtruara - Kilometra rrugë të pajisura me trotuare në zona urbane dhe vendbanime në fshatra	MAPL (SMPK)
12.3	Gjatësia e rrugëve rajonale të asfaltuara dhe pajisura me trotuare	Pasqyrimi i cilësisë së infrastrukturës rrugore rajonale sipas rajoneve	- Gjatësia e rrugeve rajonale siaps rajoneve - Gjatësia e rrugëve rajonale të pajisura me trotuare	MT MAPL
12.4	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm në %	Pasqyrimi i përfshirjes së ekonomive familjare, institucioneve dhe njësive biznesore në sistemin e ujit të pijshëm.	- Numri i ekonomive familjare sipas rajonit zhvillimor - Numri i familjare të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm sipas rajonit zhvillimor - Numri i institucioneve publike sipas rajonit zhvillimor - Numri i institucioneve publike të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm sipas rajonit zhvillimor - Numri i ekonomive biznesore e të ngjashme sipas rajonit zhvillimor - 6. Numri i ekonomive biznesore (e të ngjashme) të përfshirë në sistemin e ujit të pijshëm sipas rajonit zhvillimor	MAPL (SMPK)
12.5	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit	Pasqyrimi i përfshirjes së ekonomive familjare, institucioneve dhe njësive biznesore në në sistemin e kanalizimit	- Numri i ekonomive familjare sipas rajoneve zhvillimore - Numri i familjare të përfshira në sistemin e kanalizimit - Numri i institucioneve publike sipas rajoneve zhvillimore - Numri i institucioneve publike të përfshira në sistemin e kanalizimit - Numri i ekonomive biznesore e të ngjashme sipas rajoneve zhvillimore - Numri i ekonomive biznesore (e të ngjashme) të përfshirë në sistemin e kanalizimit	MAPL (SMPK)
12.6	% e hapësirave publike të mbuluara me ndriçim	Pasqyrimi i mbulueshmërisë së sipërfaqeve publike me ndriçim publik	- Metra katrorë (m2) hapësira publike sipas rajoneve zhvillimore - Metra katrorë (m2) hapësira publike të pajisura me ndriçim publik	MAPL (SMPK)

12.7	Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin për grumbullimin e mbeturinave	Pasqyrimi i përfshirjes së ekonomive familjare, institucioneve dhe njësive biznesore në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	- Numri i ekonomive familjare sipas rajoneve zhvillimore - Numri i ekonomive familjare të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave - Numri i përgjithshëm i institucioneve publike sipas rajoneve zhvillimore - Numri i përgjithshëm i institucioneve publike të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave - Numri i ekonomive komerciale dhe industriale sipas rajoneve zhvillimore - Numri i ekonomive komerciale të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	MAPL (SMPK)
12.8	Numri i projekteve të përbashkëta të komunave të realizuara me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm	Pasqyrimi i shkallës së bashkëpunimi ndërkomunal në rajonet përkatëse	- Numri i projekteve dhe vlera financiare e tyre të realizuara nga komunat në partneritet, në fushën e infrastrukturës, turizmit, ambientit, etj.	Ministritë e linjës Komunat
12.9	Numri dhe vlera e projekteve kapitale të financuara nga secila ministri në sipas rajoneve	Investimet kapitale të ministrive të linjës në rajonet zhvillimore në Kosovë	- Numri i projekteve dhe vlera financiare e tyre si dhe në cilin sektor ka investuar secila ministri në komuna sipas rajoneve zhvillimore	Ministritë e linjës Komunat
13. Projektet kapitale				
13.1	Numri i projekteve kapitale të realizuara sipas rajoneve	Pasqyrimi i projekteve kapitale nivel rajonal	- Numri i projekteve kapitale sipas rajoneve	Komunat Ministritë e linjës Donatorët
13.2	Vlera financiare e Projekteve	Pasqyrimi i shkallës së investimeve kapitale në nivel rajonal	- Vlera financiare e Projekteve	Komunat Ministritë e linjës Donatorët
13.3	Numri i projekteve të infrastrukturës në zonat ekonomike (nga Strategjia për ZHR)	Pasqyrimi i shkallës së investimeve në infrastrukturë në zonat ekonomike sipas rajonale	- Numri i projekteve kapitale në infrastrukturë në zonat ekonomike sipas rajonale	Komunat Ministritë e linjës Donatorët
14. Turizmi				
14.1	Llojet e turizmit rural që mund të zhvillohen sipas rajoneve	Pasqyrimi i aktiviteteve të turizmit në nivel rajonal	- Lista e llojeve të turizmit rural sipas rajoneve	Komunat, MTI

14.2	Numri i zonave turistike sipas rajoneve	Pasqyrimi i Guidës Turistike Digjitale sipas veprimtarive turistike në nivel rajonal	- Numri i zonave turistike sipas rajoneve	MTI Komunat
14.3	Numri i hoteleve sipas rajoneve	Pasqyrimi i kapaciteve hoteliere sipas rajoneve	- Numri i hoteleve sipas rajoneve *(sqarim: edhe llogaritja për këa tregues mund të llogaritën në raport numerin e banorëve të rajonit*)	MTI Komunat
14.4	Numri i restauranteve sipas rajoneve	Pasqyrimi i kapaciteve hoteliere sipas rajoneve	- Numri i restoranteve sipas rajoneve	MTI Komunat
14.5	Numri i vizitorëve sipas prejardhjes në zonat turistike	Pasqyrimi i numrit të vizitorëve dhe prejardhjes së tyre, vendor apo te jashëm në rajone.	- Numri i vizitorëve sipas rajoneve	Komunat
14.6	Numri i zonave të trashegimisë kulturore dhe natyrore turistike	Pasqyrimi i potencialeve turistike turistike të trashigimisë kulturore dhe natyrore në nivel rajonal	- Numri i zonave të trashegimisë kulturore dhe natyrore turistike	Komunat MKRS
14.7	Numri i produkteve bujqësore që prodhohen në zonat turistike	Pasqyrimi i potencialeve agro-turistike në vendbanimet e zonave turistike në nivel rajonal	- Numri i produkteve bujqësore që prodhohen në zonat turistike	Komunat MBPZHR

5. SHTOJCA 1

SHEMBULL i ANALIZËS SË TREGUESVE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE

Demografia dhe Arsimi

5.1. DEMOGRAFIA

Karakteristikat e zhvillimit demografik të një rajoni janë tregues të rëndësishëm për përcaktimin dhe pasqyrimin e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik. Popullsia ka një ndërlidhje reciproke edhe me karakteristikat e zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik. Zhvillimi demografik është paraqitur përmes treguesve mjaft specifik që mund të pasqyrojn në mënyrë konkrete zhvillimin socio-ekonomik të një rajoni. Në këtë fushë janë përcaktuar të dhënat rreth numrit të popullsisë dhe dendësisë. Numri dhe dendësia e popullsisë janë element mjaft i rëndësishëm për përcaktimin e shkallës së zhvillimit të një rajoni. Zakonisht hapësirat më të populluara dhe me dendësi më të madhe të popullsisë janë më atraktive për të jetuar dhe në anën tjetër do të kemi edhe një trend më të lartë të zhvillimit. Krahas zhvillimit socio-ekonomik dhe demografik kemi edhe dallimet dhe specifikat e shtimit natyror. Njëherit, shkalla e shtimit natyror paraqet element me rëndësi në zhvillimin socio-ekonomik. Kjo nga fakti se nga riprodhimi rrjedhin edhe kontigjente të caktuara të popullsisë. Popullsia aktive paraqet një potencial të rëndësishëm të fuqisë punëtore por nga ana tjetër popullsia e re dhe ajo e moshuar paraqesin shtresën e mbajtur të popullsisë dhe këto elemente reflektojnë drejtëpërdrejtë në trendët e zhvillimit socio-ekonomik. Element mjaft i rëndësishëm që është trajtuar te zhvillimi demografik janë edhe strukturat e popullsisë. Strukturat e popullsisë janë të kushtëzuara nga një sërë faktorësh ekonomik, social e demogrfik dhe kanë poashtu ndikim në shkallën e zhvillimit socio-ekonomik të rajonit. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, struktura arsimore, etnike, fetare, ekonomike etj, janë elemente me rëndësi në pasqyrimin e zhvillimit socio-ekonomik. Poashtu edhe madhësia e familjeve ka një ndërlidhje reciproke shkak-pasoj me faktorët ekonomik, social e demografik të një rajoni. Edhe migrimi i njerëzve është i ndërlidhur ngusht me nivelin e zhvillimit socio-ekonomik dhe kushtet më të mira për jetesë.

Popullsia është gjithashtu një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e rritjes së fuqisë punëtore, e cila nga ana tjetër, është një përcaktues kyç për rritjen e ardhshme ekonomike. Zhvillimi i pabarabartë rajonal reflektohet në modelet e popullsisë. Kapitali njerëzor është një pasuri që i përket një rajoni, është motor i dijes dhe ekonomisë krijuese dhe ka një ndikim kritik në ekonominë e një vendi apo rajoni. Shpërndarja e popullsisë (fshat dhe qytet) tregon për resurset humane që mund të gjinden për zhvillim të ekonomisë rurale apo të prodhimit dhe shërbimeve që mund të kryhen edhe në zona urbane.

Të dhënat mbi popullsinë janë paqyrurar përmes disa treguesve dhe të dhënave që janë me rëndësi për trendet e zhvillimit të një rajoni si në aspektin demografik ashtu edhe në aspektin socio-ekonomik.

5.1.1. Analiza e treguesve demografik

Treguesit e demografisë

Të dhënat për treguesit demografik kryesisht merren nga Agjencia e Statistikeve të Kosovës. Kjo Agjenci, të dhënat demografike i siguron nga regjistrimet e popullsisë, vlerësimet, anketimet dhe raportimet e institucioneve të tjera dhe si të tilla i ka të publikuara në ëeb faqen zyrtare të ASK-së. Numri i popullsisë është i publikuar si në nivel të komunave ashtu edhe në nivel të vendbanimeve. Këto të dhëna mund të shfrytëzohen për ta analizuar numrin e popullsisë, pastaj popullsinë urbane dhe rurale dhe dendësinë e popullsisë sipas rajoneve të Kosovës. Sa i përket të dhënave rreth natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror, të dhënat raportohen çdo vit nga ASK rreth numrit të lindjeve dhe të vdekjeve në nivel komunal. Kjo e

dhënë na mundëson të analizojm shkallët e shtimit natyror si në përqindje ashtu edhe në promila në nivel rajonal për të përcjell trendet e shtimit natyror. Struktura e popullsisë sipas gjinisë, moshës, nivelit të shkollimit, etnitetit, konfesionit, strukturën ekonomike të popullsisë, madhësinë e familjeve dhe migrimin e popullsisë, mund të sigurohen të dhënat nga ASK në nivel komunal. Të gjitha këto të dhëna prezantohen me shifra zyrtare dhe mund të analizohen më pas edhe në përqindje sipas rajoneve të ndryshme në Kosovë.

1. Numri i popullsisë[53] - Rajonet e ndryshme në Kosovë kanë dallime edhe në aspektin demografik. Këto dallime do të pasqyrohen më së mirë kur i analizojmë të dhënat demografike sipas rajoneve. Kur e analizojmë numrin e popullsisë, mund të konstatojmë dallime të theksuara mes këtyre rajoneve. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të realizuar nga ASK, koncentrimi më i madh i popullsisë është në Rajonin Zhvillimor Qendër.

Figura 4: Numri i popullsisë sipas rajoneve zhvillimore. Analiza e statistikave të ASK-së sipas vlerësimit të vitit 2020.



Sipas të dhënave mund të konstatojmë se rajoni zhvillimor Qendër është rajoni me numrin më të madh të popullsisë. Në këtë rajon jetojnë më shumë se gjysmë milioni banorë dhe pas tij rradhitet rajoni zhvillimor jug. Rajoni me numër më të vogël të popullsisë është rajoni Veri dhe ka më pak se gjysmën e popullsisë krahasuar me rajonin Qendror. Në fakt kjo ndërlidhet edhe me zhvillimin e disa qendrave të mëdha urbane të Kosovës e sidomos me zhvillimin e Prishtinës si kryeqendër. Bazuar në zhvillimin e qyteteve, kemi edhe dallimet mes popullsisë urbane dhe rurale (Figura 4).

2. Popullsia urbane dhe rurale – Karakteristikat e popullsisë urbane dhe rurale janë një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e shkallës së zhvillimit ekonomik të rajoneve të ndryshme në Kosovë. Rajonet me përqindje më të lartë të popullsisë urbane kryesisht kanë një zhvillim më të lart socio-ekonomik ku dominojnë aktivitet shërbyese dhe aktivitete të tjera jo bujqësore. Në aspektin social, janë më të zhvilluara si në aspektin arsimor, shëndetësor, barazisë gjinore etj.

53 Agjencioni I Statistikave të Kosovës, *Vjetari **S**tatistikor 2021*, Vlerësimet e popullsisë për 2020

Figura 5: Popullsia urbane dhe rurale sipas rajoneve



Siç shihet edhe nga të dhënat në Figurën 5, Rajoni Zhvillimor Qendër ka një përqindje më të lartë të popullsisë urbane (42.4%). Përqindje më të ulët të popullsisë urbane ka rajoni Veri me 29.2%.

3. Vendbanimet – Në të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës dominojnë vendbanimet rurale. Secila komunë e Kosovës ka qendrën komunale dhe ato konsiderohen edhe si vendbanime urbane, ndërsa të gjitha vendbanimet tjera janë fshatra. Se cili është numri i vendbanimeve sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë do të prezantohet në vazhdim për të analizuar nëse kemi një shpërndarje të barabart rajonale të vendbanimeve. Kjo është me rëndësi nga fakti se vendbanimet kërkojnë ofrim të shërbimeve dhe gjithashtu edhe mundësi zhvillimi anadaj shtrirja e tyre hapësinore në rajone zhvillimor mundëson edhe planifikimin e zhvillmeve dhe shërbimeve për të ardhmen.

Figura 6: Numri i vendbanimeve sipas rajoneve zhvillimore



Me numrin më të madh të vendbanime është rajoni zhvillimor Veri me gjithësej 361 vendbanime[54]. Derisa ky rajon kishte numrin dhe dendësinë më të vogël të popullsisë, paraqitet si rajoni me më shumë vendbanime. Kjo tregon se në vendbanimet e rajonit verior janë të vogla

54 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/ - Numri i vendbanimeve sipas komunave e më pas janë bashkuar në nivel rajonal janë marrë nga regjistrimi zyrtarë i popullsisë.

dhe me numër të vogël të popullsisë. Gjithashtu, kemi edhe qendrat urbane që nuk janë edhe aq të mëdha. Rajoni Zhvillimor Qendër është rajoni i dytë për nga numri i vendbanimeve por ky rajon edhe ka numër më të madh të popullsisë. Poashtu edhe Rajoni Zhvillimor Lindje ka afërsisht numër të njejtë të vendbanimeve (293), ndërësa rajoni me numër më të vogël të vendbanimeve renditet rajoni zhvillimor jug me 231 vendbanime.

4. Dendësia e popullsisë[55] – Bazuar në të dhënat mbi numrin e popullsisë dhe sipërfaqëve, është llogaritur edhe dendësia e popullsisë. Krahas numrit të popullsisë rritet edhe dendësia e popullsisë. Rajonet me numër më të madh të popullsisë kanë edhe dendësinë të madhe.

Figura 7: Dendësia e popullsisë sipas rajoneve zhvillimore. Analiza e statistikave të ASK-së sipas vlerësimit të vitit 2020.



Në Rajonin Zhvillimor Qendër kemi mesatarisht 224 banorë për km². Ky është rajoni me dendësi më të madhe të popullsisë nga fakti se gjendet edhe vet qyteti i Prishtinës që ka numrin më të madh të popullsisë si dhe disa qendra tjera. Rajoni zhvillimor jug me 192 banorë për km², renditet si rajoni i dytë për nga dndësia e populsisë, ndërsa rajoni me dendësi më të vogël të popullsisë është ai verior me 113 banorë për km² (Figura 7).

5. Shtimi natyror i popullsisë – Të dhënat për numrin e lindjeve dhe numrin e vdekjeve gjatë një viti në nivel të komunës raportohen vazhdimisht nga ASK dhe duke i shfrytëzuar këto të dhëna, mund të kalkulohet dhe shkalla e shtimit natyror. Nataliteti, mortaliteti dhe shtimi natyror janë elemente me rëndësi që trgojnë trendet e zhvillimit demografik si për gjendjen aktuale ashtu për tendencat për të ardhmen. Duke e përcjell shkallën e shtimit natyror, mund të konstatojmë se a ekzistojnë dallime të theksuara mes rajoneve zhvillimore në Kosovë dhe në çfar shkalle janë ato dallime. Kjo poashtu do të ndikoj edhe në përcaktimin e zhvillimeve socio-ekonomike në të ardhmën për rajonin përkatës (Tabela 43).

55 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/ - të dhënat për numrin e popullsisë sipas komunave dhe më pas edhe sipas rajoneve janë kalkuluar për sipërfaqen e komunave e rajoneve dhe është paraqit dendësia e popullsisë. Popullsia dhe sipërfaqet janë marrë nga regjistrimi zyrtarë i popullsisë 2011.

Tabela 43: Rajonet e Kosovës-Nataliteti, mortaliteti dhe shtimi natyror. Analiza e statistikave të ASK-së sipas vlerësimit të vitit 2020

Nr.	Rajonet	Lindjet			Vdekjet			Shtimi natyror		
		Numri	**‰**	**%**	**Numri**	**‰**	**%**	**Numri**	**‰**	**%**
1	**Rajoni zhvillimor Qendër**	**9772**	18,8	1,8	4379	8,4	0.8	5393	10,4	1.0
2	**Rajoni zhvillimor Lindje**	**3271**	10	1.0	1660	5,0	0.5	1611	4,9	0.4
3	**Rajoni zhvillimor Veri**	**2058**	9,1	0.9	1036	4,6	0.4	1022	4,5	0.4
4	**Rajoni zhvillimor Perëndim**	**3598**	11,1	1.1	1633	5,0	0.5	1965	6,0	0.6
5	**Rajoni zhvillimor Jug**	**3200**	7,8	0.7	1622	3,9	0.3	1578	3,8	0.3
	Gjithsej	**21899**	12,1	1.2	10330	5.7	0.5	11569	6.4	0.6

Shkalla e natalitetit është më e lartë në rajonin qendër 18.8 promila dhe më pas kemi rajonin perëndim me 11.1 promila. Në anën tjetër kemi shkallën më të lartë të mortalitetit në rajonin qender me 8.4 promila. Shtimi natyror më i larti paraqitet në rajonin qendër me 10.4 promil dhe më pas kemi rajonin zhvillimor perëndim me 6 promil. Shkalla më e ulët e natalitetit dhe njëherit edhe e shtimit natyror paraqitet në Rajonin Zhvillimor Jug (Figura 8).

Figura 8: Nataliteti dhe mortaliteti Analiza e statistikave të ASK-së sipas vlerësimit të vitit 2020.



6. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë – Përmes këtij treguesi është analizuar struktura e moshës dhe e gjinisë sipas rajoneve zhvillimore të Kosovës. Mosha dhe gjinia janë elemente mjaft të rëndësishme që ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik, andaj

dallimet mes rajoneve të ndryshme do të paraqesin edhe nevojat dhe kërkesat për të ardhmën. Nga kjo strukturë rrjedhin edhe kontigjentet e punës si dhe shtresat e caktuara të shoqërisë që ndikojnë në shumë fusha të jetës. Të dhënat për strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë mund të sigurohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Krahas rënieve të shkallëve të natalitetit si dhe faktorëve të tjerë, kemi ndryshime edhe në strukturën e popullsisë sipas moshës. Struktura e moshës më së miri prezantohet me anë të piramidës së popullsië dhe në vazhdim janë dhënë piramidat e popullsisë sipas rajoneve.

Figura 9: Piramida e popullsisë sipas rajoneve zhvillimore



Piramida e popullsisë për rajonin Qendër



Piramida e popullsisë për rajonin lindje



Piramida e popullsisë për rajonin Veri



Piramida e popullsisë për rajonin Perëndim



Piramida e popullsisë për rajonin Jug

Sipas të dhënave nga piramidat e popullsisë për rajonet e Kosovës (Figura 9), mund të konstatojmë se në të gjitha rajonet e Kosovës kemi një ngushtim të bazës së piramidës në përjashtim të rajonit qendrorë. Duhet patur parasysh se këto të dhëna janë marr nga regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 dhe inkorporohen të dhënat më të reja nga regjistrimi i ri që pritet të realizohet nga ASK, atëherë mund të kemi ngushtim edhe më të madh të bazës së piramidës. Ngushtimi i bazës së piramidës është një faktor me rëndësi që tregon se shkallët e

natalitetit kanë pësur një rënje të ndieshme dhe gjithashtu këti fakti i ka ndihmuar edhe emigrimi. Grup-moshat e reja (0-9 vjeç) janë në numër më të vogël në krahasim me grup-moshat mbi 10 vjeç. Gjatë gjithë periudhë së shekullit të kaluar, Kosova kishtë bazë të zgjeruar të pramides me dominimin e grup-moshave të reja dhe kjo tregon se vazhdimisht kishte një tip progresiv të popullsisë. Ndryshimet që kanë ndodhë këto periudhat e fundit vërehen çart edhe në piramidat e popullsisë sipas rajoneve. Përjashtimisht, rajoni qendror ka dallim nga të gjitha rajonet tjera nga fakti se baza e piramidës është e zgjeruar dhe kjo tregon për dominimin e grup-moshave të reja. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se rajoni qendreor ka një urbanizim më të zhvilluar dhe gjithashtu është përball me imigrime të brendshme ku shumë familje janë vendos në qytetet e rajonit qendror dhe si rrjedhoj edhe struktura e popullsisë sipas moshës përbën bazën më të zgjeruar të piramidës. Numri i popullsisë sipas moshës paraqet një bazë të mirë për ta analizuar kërkesën aktuale por edhe nevojat për të ardhmen si në arsim, shëndetësi, shërbime dhe infrastrukturë, fuqi punëtore, aktivitete sportive, kulturore, rinore etj.

Struktura gjinore në të gjitha rajonet e Kosovës është gati plotësisht e balancuar me disa dallime të vogla sipas rajoneve.

Tabela 44: Popullsia sipas gjinisë në rajonet e Kosovës

Nr.	Rajonet	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj %	Femra%
1	**Rajoni zhvillimor Qendër**	227560	220480	448040	50.79	49.20989
2	**Rajoni zhvillimor Lindje**	171568	162171	333739	51.408	48.59216
3	**Rajoni zhvillimor Veri**	102902	100799	203701	50.516	49.4838
4	**Rajoni zhvillimor Perëndim**	153913	155835	309748	49.69	50.31025
5	**Rajoni zhvillimor Jug**	194226	190623	384849	50.468	49.53189

Siç shihet edhe nga Tabela 44, të gjitha rajonet e Kosovë kanë një bilanss gjinor që sillet mes 49 dhe 51 përqind. Një dallim më të theksuar gjinor mund ta vërejm te rajoni zhvillimor lindje ku kemi 48.6% femra dhe 51.4% meshkuj.

7. Struktura Nacionale e popullsisë sipas rajoneve – Të dhënat për strukturën nacionale të popullsisë në rajonet zhvillimore të Kosovë janë marrë nga regjistrimi zyrtarë i popullsisë i realizuar në vitin 2011. Këto të dhëna paraqesin dallimet mes rajoneve sa i përketë strukturës nacionale. Të dhënat për strukturën nacionale gjithashtu nga janë të plota për rajonin zhvillimor veri për faktin se në komunat veriore të këtij rajoni nuk është realizuar regjistrimi i popullsisë. Kur analizojm strukturën nacionale të popullsisë mund të konstatojmë se në të gjitha rajonet e Kosovës dominon popullsia shqiptare me rreth 90 % e më tepër. Etnitetet tjera kanë pjesëmarrje të vogël.

Tabela 45: Struktura nacionale e popullsisë sipas rajoneve të Kosovës e shperhur në Përqindje[56]

Nacionaliteti	Rajoni zhvillimor Qendër	Rajoni zhvillimor Lindje	Rajoni zhvillimor Veri	Rajoni zhvillimor Perëndim	Rajoni zhvillimor Jug

56 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__Census%20population__Census%202011__3%20By%20Municipali

Shqiptar	95.3	93.7	98.3	93.7	86.6
Serb	1.8	4.4	0.2	0.2	0.1
Turq	0.4	0.3	0.4	0	3.7
Boshnjak	0.1	0.1	0.3	1.6	5.4
Rom	0.5	0.3	0.3	0.6	0.8
Ashkali	1.5	1.1	0.4	0.3	0.6
Egjiptian	0.1	0	0	3.4	0.1
Goran	0.1	0	0.1	0.1	2.5
Të tjerë	0.2	0.1	0	0.1	0.2
Gjithsej	**100**	**100**	**100**	**100**	**100**

Në të gjitha rajonet zhvillimore kemi mbi 90% të popullsisë shqiptare në përjashtim të rajonit jugor që ka rreth 88 %. Në rajonin jugor kemi disa rajone gjeografike që kanë popullsi boshnjake, gorane dhe turke siç janë rajoni i Zhupës dhe Gorës që kanë ndikuar të kemi një përqindje relativisht të vogël të popullsisë jo shqiptare. Ajo që bie në sy nga tabela është përqindja më e lartë e popullsisë shqiptare në rajonin zhvillimor veri. Në fakt ky rajon ka edhe një përqindje të popullsisë serbe, por ky etnitet në Kosovë ka refuzuar të marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë dhe kështu nga statistikat janë vendos të dhënat zyrtare nga regjistrimi ku janë regjistruar vetëm pjesa e popullsisë shqiptare (Tabela 45).

8. Struktura fetare – Kjo struktur poashtu paraqet një faktor me rëndësi në aspektin e zhvillimit social dhe kulturor. Gjatë analizimit të strukturës fetare mund të vërejmë se në të gjitha rajonet e Kosovës kemi besime të ndryshme fetar por kryesisht dominon feja islame.

Tabela 46: Struktura fetare e popullsisë sipas rajoneve zhvillimore[57]

Rajonet e Kosovës	Islam	Ortodoks	Katolik	Të tjerë	Pa religjion	Preferon të mos përgjigjet
Rajoni zhvillimor Qendër	481584	9005	1946	445	722	3450
Rajoni zhvillimor Lindje	326533	15283	2898	149	120	1062
Rajoni zhvillimor Veri	191485	449	64	44	19	263
Rajoni zhvillimor Perëndim	284912	699	27080	289	226	1202
Rajoni zhvillimor Jug	378898	401	6450	261	155	1236
Gjithsej	1663412	25837	38438	1188	1242	7213

Siç shihet edhe nga të dhënat për strukturën fetare të popullsisë, në të gjitha rajonet e Kosovës dominon popullsia islame me mbi 90%. Përqindje më të lartë të popullsisë islame ka rajoni jugor i Kosovës me rreth 97.7 %, ndërsa përqindjen më të vogël të popullsisë islame e ka rajoni

ties/tab%205%204.px/?rxid=cc8c80dd-61b1-4582-a1a0-475062b609bd - Popullsia sipas përkatësisë etnike dhe komunës 2011

57 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__Census%20population__Census%202011__3%20By%20Municipalities/tab%205%205.px/?rxid=cc8c80dd-61b1-4582-a1a0-475062b609bd - Popullsia sipas religjionit komunës 2011

perëndimor me rreth 90%. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se edhe në strukturën fetare nuk janë të përfshira të dhënat për komunat veriore të Kosovës (Tabela 46).

9. Struktura ekonomike e popullsisë – Struktura ekonomike epoullsisë paraqe një bazë të rëndësishme të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve zhvillimore. Në këtë pjesë është paraqit aktiviteti ekonomik i popullsisë sipas rajone dhe gjithashtu edhe veprimtarit ekonomike të popullsisë sipas rajoneve të Kosovës.

Tabela 47: Aktiviteti ekonomik i popullsisë sipas rajoneve të Kosovës[58]

Rajonet Zhvillimore	Ekonomikisht aktive	Të punësuar	Ekonomikisht jo aktiv
Rajoni zhvillimor Qendër	160396	98464	197151
Rajoni zhvillimor Lindje	103072	54920	147951
Rajoni zhvillimor Veri	55405	25421	82216
Rajoni zhvillimor Perëndim	87989	45050	142253
Rajoni zhvillimor Jug	101238	56599	174577
Gjithsej	508100	280454	744148

Pothuaj se në të gjitha rajonet e Kosovës kemi numër më të madh të popullsisë ekonomikisht jo aktive në krahasim me popullsinë ekonomikisht aktive. Poashtu kemi edhe numrin e të punësuarve gati përgjysmë më të ulët në krahasim me numrin e popullsisë ekonomikisht aktive. Kjo njëherit tregon edhe për përqindjen e papunësisë. Sipas këtyre të dhënave kemi papunësinë nërajonet zhvillimore që sillet nga 45 deri rreth 55 % (Tabela 47).

Tabela 48: Veprimtarit ekonomike të popullsisë sipas rajoneve[59]

Veprimtarit ekonomike	Rajoni zhvillimor Qendër	Rajoni zhvillimor Lindje	Rajoni zhvillimor Veri	Rajoni zhvillimor Perëndim	Rajoni zhvillimor Jug
Bujqësia,gjuetia dhe pylltaria	1326	2877	510	2935	4715
Peshkimi	5	2	2	6	5
Industria nxjerrëse	1060	362	672	261	302
Prodhimi	7188	6470	2034	4722	9619
Energjia elektrike, gazi dhe uji	6028	790	1677	997	762
Ndërtimtari	5971	5265	1451	3194	7703
Tregtia me shumicë dhe pakicë,riparimi Iautomjeteve motorike, motoçikletave dhe	18114	10493	4221	8817	9928

58 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__Census%20population__Census%202011__3%20By%20Municipalities/tab%205%2010.px/?rxid=cc8c80dd-61b1-4582-a1a0-475062b609bd - Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual dhe komunës 2011

59 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__Census%20population__Census%202011__3%20By%20Municipalities/tab%205%2012.px/?rxid=cc8c80dd-61b1-4582-a1a0-475062b609bd - Të punësuarit sipas veprimtarisë kryesore, gjinisë dhe komunës 2011

artikujve personale dhe shtëpiake					
Hotelet dhe restoranet	5229	2869	1111	2619	3094
Transporti,magazinimi dhe komunikacioni	6256	2756	1400	1997	2107
Ndërmjetësimi financiar	2769	969	533	1142	890
Pasuritë e patundshme, dhënia me qira dhe shërbimet për ndërmarjet	5334	1589	1067	1396	1351
Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyruar	12202	6083	4229	5402	4235
Arsimimi	10823	6851	3520	5633	6334
Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	6767	2923	1408	3111	2290
Aktivitete tjera, të shërbimeve sociale dhe personale	5886	2249	1039	2054	2036
Shërbime shtëpiake	446	278	115	152	492
Aktivitetet e organizmave ndërkomtare	3060	2094	432	612	736

Bazuar në të dhënat e popullsisë rreth veprimtarive ekonomike mund të konstatojmë se në të gjitha rajonet e Kosovës dominon tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve motorike, motoçikletave dhe artikujve personal dhe shtëpiak. Sektori tjetër që dominon është edhe arsimi, ndërtimtaria, prodhimi, shëdetësia etj. Veprimtaritë primare ekonomike bujqësia, gjuetia dhe pylltaria kryesisht janë më të shperhura në rajonin zhvillimor jug dhe më pas në dy rajonet tjera, atë perëndimor dhe lindor. Kjo veprimtari është më pak e shprehur në rajonin zhvillimor veri dhe qendër (Tabela 48).

10. Migrimi – Një nga faktorët me rëndësi sa i përket zhvillimit të balancuar socio-ekonomik të rajoneve zhvillimore në Kosovë është edhe migrimi. Migrimi si fenomen është i kushtëzuar nga shumë faktor social dhe ekonomik dhe në anën tjeter kemi edhe efekte në aspektin e zhvillimit. Të dhënat për migrimet janë marr nga vlerësimi i ASK-së për vitin 2019. Të dhënat janë analizuar si për migrimin ndërkombëtar ashtu edhe për atë kombëtar. Sipas këtyre të dhënave kemi një intensitet dukshëm më të theksuar të migrimit ndërkombëtar në të gjitha rajonet e Kosovës. Në vazhdim janë paraqit të dhënat për migrimin ndërkombëtar për vitin 2019 (imigrimi, emigrimi dhe bilanci i migrimit ndërkombëtar, si dhe të dhënat për migrimin kombëtar (imigrimi, emigrimi dhe bilanci i migrimit kombëtar) [60].

60 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__09%20Population__Population%20estimate/tab02.px/?rxid=08d54e1f-dc29-473e-b00a-4a7338dd046a

Figura 10: Migrimi ndërkombëtar dhe kombëtar sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë në vitin 2019[61]



Siç shihet edhe nga Figura 12, të gjitha rajonet e Kosovës kanë bilance negativ sa i përket migrimit ndërkombëtar. Emigrimi është dukshëm më i shprehur se imigrimi dhe kështu kemi një bilanc migrues mjaft negativ. Emigrimi më i theksuar është te Rajoni Zhvillimor Jug, pastaj kemi Rajonin Zhvillimor Qendër dhe më pas atë të lindjes. Rajonet zhvillimore veri dhe perëndim kanë emigrim më të ulët ndërkombëtar. Sa i përket migrimit kombëtar, pos rajonit qendër, të gjitha rajonet tjera kanë bilanc negativ. Në rajonin Zhvillimor Të Qendër gjendet edhe vet kryeqyteti i Kosovës në të cilin gravitojnë banorë të viseve të ndryshme të të Kosovës dhe si rezultat kemi imigrim më të madh se emigrim.

11. Numri i familjeve[62] – Bazuar edhe në numrin e popullsisë, kemi edhe dallimet në numrin dhe madhësin e familjeve sipas rajoneve zhvillimore. Sipas të dhënave të marra nga regjistrimi i popullsis, numrin më të madh të familjeve e ka rajoni zhvillimor qendër. Pas tij renditen rajoni zhvillimor lindje, jug, perëndim dhe veri (Figura 13).

Figure 11: Numri i familjeve sipas rajoneve.



61 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__09%20Population__Population%20estimate/tab02.px/?rxid=08d54e1f-dc29-473e-b00a-4a7338dd046a

62 https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata__Census%20population__Census%202011__3%20By%20Municipalities/Pop%20by%20household%20status%20sex%20and%20municipality.px/?rxid=cc8c80dd-61b1-4582-a1a0-475062b609bd

5.2. ARSIMI

Arsimi është njëra ndër fushat mjaft me rëndësi në aspektin e zhvillimit social dhe trajtimi i saj ka rëndësi të veçantë. Në këtë dokument, arsimi është trajtuar në atë mënyrë që të pasqyrohet gjendja sa më reale në nivel të rajoneve të Kosovës. Kjo do të mundësoj evidentimin e progresit dhe avancimin e zhvillimit të arsimit fillor dhe të mesëm. Treguesit arsimor janë të dhëna që përshkruajnë aspektet kryesore të arsimit të cilat lejojnë monitorimin e infrastrukturës shkollore, Numrit të nxënësve sipas niveleve të shkollimit, kuadrin arsimor, programeve dhe studentëve. Grumbullimi i këtyre të dhënave ka rëndësi edhe në aspektin ekonomik të zhvillimit, kjo nga fakti se pasqyrohet kualifikimi i të rinjve që do të jenë të gatshëm për punë, si: nxënësit e shkollimit të mesëm dhe të atyre që e përfundojnë shkollimin universitar.
Përshkrimi i treguesve të arsimit dhe analiza e tyre janë të listuar më poshtë.

5.2.1. Analiza e treguesve të arsimit

Analiza e gjendjes së rajoneve zhvillimore në raport me treguesit e arsimit paraqitet sin ë vijim:

1. Struktura arsimore e popullsisë – Një nga faktorët me rëndësi në përcaktimin e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të balancuar rajonal është edhe analiza e të dhënave për nivelin e shkollimit të popullatës. Struktura arsimore paraqet një bazë të rëndësishme të resurseve humane me ndikim në zhvillimin socio-ekonomik. Në këtë pjesë është analizuar numri i popullsisë mbi 10 vjeç sipas nivelit të shkollimit. Këto të dhëna janë marrë nga regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Poashtu këto të dhëna mund edhe të rifreskohen me regjistrimin e ri të popullsisë që pritet të realizohet gjatë këtij viti (2021). Ajo që mund të konsiderohet si mangësi në analizën e të dhënave jo vetëm për strukturën arsimore por edhe për fushat tjera, është mungesa e të dhënave për komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Zubin Potok. Kjo nga fakti se në këto tri komuna nuk është realizuar regjistrimi i popullsisë.

Në këtë pjesë është analizuar niveli i shkollimit për popullsinë mbi 10 vjeç për Rajoneve Zhvillimore të Kosovës. Niveli i shkollimit është analizuar duke marr numrin dhe përqindjen e popullsisë për secilin rajon dhe duke analizuar se sa janë: Ata që nuk dinë shkrim lexim, ata që dinë shkrim lexim, që nuk kanë përfunduar shkollimin fillor, me shkollë fillore, me shkollim të mesëm të ulët, me shkollim të mesëm të lartë, të diplomuar dhe ata me diplomë pas universitare. Në bazë analizës së të dhënave për strukturën arsimore të popullsisë mund të konstatojmë se ekzistojnë dallime mes rajoneve zhvillimore në Kosovë.

Figura 12: Popullsia sipas nivelit të shkollimit dhe rajoneve zhvillimore



Rajoni Zhvillimor Qendër dominon pothuaj në të gjitha nivelet e shkollimit por kjo është e ndërlidhur edhe me numrin e përgjithshëm të popullsisë. Siç shihet edhe nga grafikoni, numri i atyre që kanë diplomë pas universitare në rajonin qendër është 5385 përsona dhe të gjitha rajonet tjera zhvillimor kanë më pak përsona me diplomë pas universitare se rajoni qendër. Numri i atyre që kanë diplomë pasuniversitare në nivel të Kosovës është 10131 dhe vetëm në Rajonin Qndër janë 5385 apo mbi 53%. Katër rajonet tjera zhvillomore kanë 4746 persona apo 46.7%. Ajo që mund të konsiderohet shqetësuese në aspektin e shkollimit është numër relativisht i madh i atyre që nuk dinë shkrim dhe lexim. Numri i tyre në nivel të Kosovës është 50121. Me numrin më të madh të atyre që nuk dinë shkrim lexim dominon poashtu rajoni qendër dhe më pas renditet rajoni zhvillimor lindje dhe rajoni zhvillimor perëndim. Shqetësim tjetër mbetet edhe numri i atyre që nuk kanë të ërfunduar as shkollimin fillor. Në nivel të Kosovës kemi mbi 111 mij përsona. Edhe në numrin e atyre që nuk kanë të përfunduar shkollimin fillor dominon rajoni qendër, pastaj rajoni jug dhe rajoni lindje (Figura 10).

Për ta analizuar më mirë dallimin mes rajoneve sa i përket nivelit të shkollimit, do të paraqesim dallimet në nivel të rajoneve në përqindje (Figura 11).

Figura 13: Popullsia sipas nivelit të shkollimit dhe rajoneve zhvillimore në %



Sipas këtyre të dhënave mund të konstatohet se Rajoni Zhvillimor Qendër ka përqindje më të lartë të popullsisë me shkollim pas universitar, me shkollim të lartë dhe me shkollim të mesëm të lartë në krahasim me të gjitha rajonet tjera zhvillimore në Ksovë. Edhe në këtë grafikon vërehet se popullsia që nuk ka të përfunduar shkollimin fillor është mjaft e lartë. Kjo popullsi sillet rreth 8 dhe 9 përqind e popullsisë por përjashtim bën rajoni zhvillimor perëndim që ka vetëm 1 përqin të atyre që nuk kanë të kryer shkollimin fillor.

2. Numri i objekteve shkollore– Në vazhdim janë analizuar numri i objekteve shkollore sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë si dhe sipas nivelit të shkollimit. Këto të dhëna sigurohen nga MASHT-i bazuar në raportet për arsimin në Kosovë. Të dhënat e prezantuara janë marr nga raporti i statistikave të arsimit në Kosovë për vitin 2020/2021. Sipas këtyre të dhënave, në Kosovë gjithësej ekzistojnë 1058 objekte shkollore. Prej tyre, 44 janë objekte Parashkollore/çerdhe, 892 objekte të shkollimit fillor dhe i mesëm i ulët, si dhe 122 objekte të shkollimit të mesëm të lartë.

Figura 14: Objektet Shkollore sipas Rajoneve. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021



Nëse analizohet numri i objekteve shkollore sipas rajoneve, kemi dominim të rajonit qendër që ka numër më të madh të objekteve shkollore për tri nivelet e shkollimit. Gjithsej në rajonin qendror ekzistojnë 278 objekte shkollore për tri nivelet e shkollimit. Pastaj kemi rajonin jug me gjithsej 242 objekte shkollore, rajoni lindje me 207 objekte, rajoni perëndim me 169 objekte dhe rajoni veri me 134 objekte shkollore (Figura14).

3. Numri i nxënësve

Nivelet e arsimit në Kosovë janë të përcaktuara sipas SNKA (Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit). Sipas këtij klasifikimi, në Kosovë kemi këto nivele të arsimit:

- **Arsimi parafillor** - Niveli i arsimit parashkollor/parafillor paraqet nivelin 01 dhe 02 sipas përshtatjes në përkufizimet e SNKA-së (Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit). Nivelin 01: Paraqet zhvillimin e hershëm dhe edukimin e fëmijës nga mosha 0 deri në 3 vjeç. Niveli 02: Arsimi parafillor mosha 4 vjeç deri në 6 vjeç.
- **Arsimi i detyruar** - Arsimi i detyruar paraqet nivelet një dhe dy sipas SNKA-së (Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit). Arsimi fillor klasifikohet si niveli 1 (klasat 1-5) dhe niveli 2 është arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9). Arsimi i detyruar në nivel vendi funksionon në shkolla publike dhe jopublike (të licencuara).
    - **Niveli i arsimit fillor** - Niveli i arsimit fillor zgjat 5 vjet, duke filluar nga klasa e parë deri në klasën e pestë (1-5). Në këtë nivel regjistrohen fëmijët që mbushin moshën 6 vjeçare. Grupmosha e nxënësve në këtë nivel është nga 6 deri në 10 vjeç.
    - **Niveli i arsimit të mesëm të ulët** - Niveli i i arsimit mesëm i ulët shtrihet nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë (6-9). Grupmosha e nxënësve në këtë nivel është nga 11 deri në 14 vjeç, duke mos llogaritur ata që përsërisin klasën dhe nxënësit me aftësi të kufizuara.
- **Niveli i arsimi të mesëm të lartë** - Niveli i arsimit të mesëm të lartë paraqet nivelin tre (3) sipas SNKA-së (Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit) dhe funksionon në shkolla të mesme publike dhe jopublike (të licencuara). Në bazë të synimeve dhe përmbajtjes këto shkolla janë të organizuara në gjimnaze dhe në shkolla profesionale. Shkollat e mesme të larta (gjimnazet dhe shkollat profesionale) janë shkolla të profilizuara. Gjimnazet ndahen sipas drejtimeve në: shoqërore, të përgjithshme, të shkencave natyrore, matematikëinformatikë dhe të gjuhëve. Ndërsa shkollat e mesme

profesionale ndahen sipas drejtimeve në: teknike, bujqësore, ekonomike, të mjekësisë, të muzikës, të tregtisë, teologjike, të artit dhe në qendra të kompetencës.

4. Arsimi parafillor

Nxënësit në arsimin publik – Në këtë pjesë janë paraqit të dhënat për numrin e nxënësve në arsimin parafillor sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë. Këta janë fëmijë të moshës 0 deri 6 vjeç dhe vijojnë arsimin në institucione publike të arsimit. Të dhënat janë siguruara nga statistikat e arsimit në Kosovë për vitin 2020/2021 të grumbulluara nga Ministria e Arsimit, shkencës dhe teknologjisë në bashkëpunim me Agjencinë e statistikave të Kosovës. Sipas këtyre të dhënave, numri i përgjithshëm i fëmijëve që kanë vijuar arsimin para fillor në arsimin publik në Kosovë gjatë vitit 2020/2021 ka qenë gjithsej 24,196. Prej tyre, fëmijë të moshës 0 deri 5 vjeç janë 4183, ndërësa fëmijë të moshës 5 deri 6 vjeç janë 20,013. Në vazhdim është paraqit shpërndarja e fëmijëve në arsmin parafillor sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë (Figura 15).

Figura 15: Numri i fëmijëve në arsimin parafillor sipas rajoneve. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021



Nga të dhënat mund të konstatojmë se numri më i madh i fëmijëve që ndjekin arsimin parafillor gjendet në rajonin qendër. Kjo nderlidhet me numrin më të madh të koncentrimit të popullsisë në këtë rajon. Ajo që mund të vërehet nga të dhënat e grafikonit, është numri më i madh i fëmijëve të moshës 5 dhe 6 vjeç që vijojn arsmin në rajonin jugor të Kosovës pas rajonit qendër. Por në anën tjetër në rajonin jugor kemi numrin më të vogël të fëmijëve të moshës 0 der 5 vjeç. Kjo nga fakti se në këtë rajon ka munges të theksuar të vijueshmeris së fëmijëve në institucionet parashkollore der në 5 vjeç.

Nxënësit në arsimin fillor-mesëm të ulët- Niveli i arsimit fillor dhe i mesëm i ulët përfshin arsimin e obliguar 9-të vjeçar. Në vazhdim janë prezantuar të dhënat për numrin e nxënësve në këtë nivel të shkollimit sipas rajoneve.

Figura 16: Numri i nxënësve në arsimin fillorë të mesëm të ulët. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021



Numri i përgjithshë i nxënësve që kanë ndjekur shkollimin në nivelin e arsimit fillor të mesëm të ulët në nivel të Kosovës për vitin 2020/2021 është 223,908. Me numrin më të madh të nxënësve në këtë nivel të shkollimit dominon rajoni qendër, pastaj rajoni jugor, ai i lindjes, më pas kemi rajonin perëndimor dhe në fund me numrin më të vogël është rajoni verior.

Nxënësit në arsimin e mesëm të lartë - Niveli i arsimit të mesëm të lartë përfshin nivelin tre (3) sipas SNKA-së (Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit) dhe organizohet në gjimnaze dhe shkolla profesionale. Numri i përgjithshëm i nxënësve të këtij niveli arsimor në nivel të Kosovës për vitin 2020/2021 është 70,742. Edhe në këtë nivel të arsimit dominin rajoni qendër me numër më të madh të nxënësve me gjithsej 22338. Më pas kemi rajonin lindje me 15105 nxënës dhe rajonin jug me 13171 nxënës (Figura 17).

Figura 17: Numri i nxënësve në arsimin mesëm të lartë Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021



Personeli arsimor - Në kuadër të përsonelit arsimor përfshihen mësimdhënësit, personeli administrativ dhe personeli ndihmës.

Mësimdhënësit- Në vazhdim janë analizuar të dhënat rreth numrit të mësimdhënësve sipas nivelit të shkollimit dhe sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë. Të dhënat kryesisht sigurohen nga raportet e Ministrisë së Arsimit, shkencës dhe Teknologjisë. Bazuar në raportin e statistikave të arsimit në Kosovë për vitin 2020/2021 të publikuar nga MASHT, numri i përgjithshëm i mësimdhënësve në Kosovë në të gjitha nivelet e shkollimit është 23746 (Figura 18).

Figura 18: Numri i mësimdhënësve sipas rajoneve. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021



Dominon rajoni qendror me numrin më të madh të mësimdhënësve me 6485 dhe më pas kemi rajonin jugor me gjithsej 5822. Më pas renditen rajoni lindje dhe perëndim dhe në fund me numër më të vogël të mësimdhënësve kemi rajonin veri.

Në vazhdim janë dhënë të dhënat për numrin e mësimdhënësve sipas niveli të shkollimit dhe rajoneve.

Numri më i madh i mësimdhënësve është në nivelin e shkollimit të mesëm të ulët me 18053. Më pas kemi shkollimin e mesëm të lartë me gjithsej 5105 mësimdhënës në nivel të Kosovës dhe në fund kemi nivelin parashkollor me 588 mësimdhënës. Në shkollimin e mesëm të ulët dominon rajoni qendror me gjithsej 4732 mësimdhënës dhe më pas kemi rajonin jugor me 4756 mësimdhënës. Më pas rënditen rajoni lindje, perëndim dhe veri. Në shkollimin e mesëm të lartë poashtu dominon rajoni qendër me gjithsej 1458 mësimdhënës, pastaj kemi rajonin lindje me 1044 mësimdhënës dhe rajonin jug me 1049. Më pas renditen rajoni perëndim me 972 mësimdhënës dhe në fund rajoni veri me 582 mësimdhënës. Ajo që dallohet sipas rajoneve është numri më i vogël i mësimdhënësve për nivelin parashkollor në rajonin jugor të Kosovës. Pos numrit të mësimdhënësve, në këtë dokument janë analizuar edhe numri i personelit administrativ dhe atij ndihmës që janë të angazhuar në tri nivelet e shkollimit sipas rajoneve të Kosovës.

Tabela 49: Numri i personelit administrativ dhe atij ndihmës. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021

Rajonet zhvillimore në Kosovë	**Personeli administrativ**	**Personeli ndihmës**	**Gjithësejt**

Rajoni qendër	479	1004	**1483**
Rajoni lindje	334	441	**775**
Rajoni Veri	254	434	**688**
Rajoni perëndim	269	552	**821**
Rajoni jug	307	662	**969**
Gjithsej	**1643**	**3093**	**4736**

Kemi gjithësej 4736 përsonel administrativ dhe ndihmës të angazhuar në gjith Kosovën në tri nivelet e shkollimit. Prej tyre kemi 3093 përsonel ndihmës dhe 1643 përsonle administrativ. Sa i përket rajoneve zhvillimore, kemi rajonin qendër që ka më së shumti personel ndihmës dhe administrativ me gjithsej 1483. Pastaj kemi rajonin jugor me 969, rajonin lindje me 775, rajonin perëndim me 8821 dhe rajonin veri me 688 (Tabela 49).

5. Arsimi privat[63]

Të dhënat e paraqitura në këtë publikim i përkasin institucioneve arsimore private të licencuara nga MASHT dhe raportojnë në sistemin SMIA.

Nxënësit (fëmijët) në arsimimin parashkollor dhe parafillor – Në institucionet e arsimit privat kemi numër më të vogël të nxënësve. Gjithsej në nivel të Kosovës kemi 6983 nxënës që janë në arsimin privat parashkollor dhe parafillor. Në nivelin parashkollor (0-5 vjeç) kemi 4855 fëmijë dhe në nivelin parafillor (5-6 vjeç) kemi 2128 fëmijë. Sa i përket numrit të nxënësve në arsimin parashkollor dhe parafillor sipas rajoneve zhvillimore kemi dallime të theksuara.

Figura 19: Numri i fëmijëve moshes deri 6 vjeç në arsimin privat. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021



Pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve janë në rajonin qendër me 4443 nxënës. Rreth 63% e gjithë fëmijëve të Kosovës që ndjekin këtë nivel arsimimi në sektorin privat janë në rajonin qendër. Në të gjitha rajonet tjera kemi 2563 nxënës ose rreth 37% të nxënësve në arsimin parafillor (Figura 19).

[63] Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021,

Arsimi privat - Nxënësit në arsimimin fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë[64]
Numri i përgjithëm i nxënësve që vijojn mësimin në arsimin privat në Kosovë, në nivelin fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë është 9441. Vetëm në nivelin e arsimit të mesëm të ulët kemi 5796 nxënës, ndërësa në nivelin e arsimit të mesëm të lartë kemi 3645 nxënës.

Arsimi privat është zhvilluar në të gjitha rajonet e Kosovës, mirëpo kemi dallime të theksuara sidomos me dominim të rajonit qendror.

Figura 20: Numri i nxënësve në arsimin privat sipas rajoneve. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/2021



Vetëm në rajonin qendror kemi 5170 nxënës apo rreth 62% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në këtë nivel të shkollimit në arsimin privat. Në të gjitha rajonet tjera zhvillimore kemi 3450 nxënës apo rreth 38% (Figura 20).

[64] Po aty.

6. SHTOJCA 2:

TERMAT E REFERENCËS PËR DISAJNIMIN E SISTEMIT TË PËRFORMANCËS RAJONALE



Kodi i regjionit	Kodi i Komunës	Indikatori	Përshkrimi 1	Përshkrimi 2	Përshkrimi 3
01Pr.	019	Ref 013/1	Nr. nxënësve	Nr. banorëve	Investime